RAPORT PËRFUNDIMTAR RIAUDITIMI

"AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE"

NË

DREJTORINË E TATIMPAGUESVE TË MËDHENJ

TIRANË

Tiranë, janar 2022

Nr. Përmbatja FAQE

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....3-5
1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....3
2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....3-5
3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....5-7

II. HYRJA
1.Objekti i auditimit.....7
2.Qëllimi i auditimit. 7
3.Identifikimi i çështjes.....7
4.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 7
5.Përgjegjësitë e audituesve.....8
6.Kriteret e vlerësimit..... 8
7.Standardet e auditimit.....8
8.Metodat e auditimit.....9
9.Dokumentimi i auditimit.....10

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....10
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit:
2.1 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimi financiar dhe kontrollit, në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar sipas komponentëve.....11-16
2.2 Përputhshmëria me kriteret ligjore, lidhur me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave tatimore, duke ndaluar në fushat kryesore të të ardhurave (tatim fitimi, tatimi mbi të ardhurat, tatimi mbi vlerën e shtuar, etj.) Testimi i zonave me risk lidhur me mbledhjen e këtyre të ardhurave, sektorët dhe kontribuesit më të mëdhenj.....16-26
2.3 Përputhshmërialigjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor:
2.3.1 Sektori i Kontrollit nga zyra dhe monitorimi.....26-39
2.3.2 Sektori i Kontrollit në vend.....39-64
2.4 Përputhshmëria ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara: Niveli i borxhit për çdo vit ushtrimor nën auditim, masat shtrënguese të zbatuara për mbledhjen e borxhit. Ecuria e proceseve gjyqësore lidhur me detyrimet tatimore të vlerësuara.....64-80
2.5 Përputhshmërialigjore në veprimtarinë e Shërbimeve ndaj tatimpaguesve dhe individëve të realizuara nga strukturat e administratës së DTM-së nëpërmjet platformës elektronike e-Albania ose jo, në arritjen e objektivave për lehtësimin dhe modernizimin e shërbimeve publike.....80-85

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....86-92
V. ANEKSE.....93-103

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Raporti i riauditimit të ushtruar në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë (*këtu e më poshtë DTM*) prezanton çështjet kryesore të rezultuara në përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit me kuadrin ligjor dhe rregullator si: vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, lidhur me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave tatimore, në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në funksion të verifikimit të përmbushjes vullnetare të detyrimeve tatimore të tatimpaguesve kontrollin ndaj evazionit fiskal apo shmangieve tatimore që mund të jenë kryer nga tatimpaguesit, vperimtarinë e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara dhe Drejtorisë së Shërbimit ndaj Tatimpaguesit etj. Disa nga gjetjet kryesore të evidentuara, si dhe rekomandimet përkatëse në mënyrë të përmbledhur jepen më poshtë.

1.2 Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi.

NR.	PËRMBLEDHJE EGJETJES	REF. ME RPA	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit në vend u konstatua se në Raportin e kontrollit të ushtruar për subjektin ñA.ò SHA në vitin 2017, në zërin blerje të përjashtuara peshën më të madhe të blerjeve e zë ñBlerje nga individëò në vlerën 301,129,110 lekë. Zëri ñBlerje nga individëò ka të bëjë me blerjet e realizuar nga subjekti për artikullin skrap. Mungesa e një analizë ndaj individëve me numrin e identifikimit të tyre, sjell si pasojë që shitjet në subjektin e sipërcituar të tejkalojnë shumën 2,000,000 lekë, vlerë për të cilën sipas Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar, neni 13/2 janë të detyruar të bëjnë deklaratën mbi të ardhurat personale. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.2 faqe 41të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*	fq.41	I larte	1. Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, pasi të ketë analizuar situatën e kontrollit të kryer në subjektin ñA.ò SHA referuar gjetjeve nga auditimi i KLSH-së, të marrë masa që në bashkëpunim me Administratën Tatimore (Hetimi Tatimor), të identifikojë shitjet e realizuara nga individë privatë për llogari të subjektit ñA.ò SHA, regjistrimin e tyre me numër identifikimi dhe deklarimin e tatimit mbi të ardhurat vjetore për shumën mbi 2 milionë lekë.
2	Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit në vend u konstatua se në Raportin e kontrollit të ushtruar për subjektin ñP.ò SHPK nga analiza e zërave të pasqyrës financiare për ñDetyrime afatgjataò, në pasiv të bilancit paraqiten në shumën 242,287,076 lekë e cila përbëhet nga ñHuatë afatgjataò që përfaqëson hua të marrë në BKT bankë. Grupi i pasivit ñKapitaliò i paraqitur në bilancin e këtij viti ushtrimor është në shumën prej 586,603,131 lekë. Subjekti ka realizuar likuidime duke ulur zërin ñDetyrimeve ndaj institucioneve të kredisëò përkatësisht për: - vitin 2015 në vlerën 610,327,778 lekë - vitin 2016 në vlerën 443,913,409 lekë - vitin 2017 në vlerën 205.596.169 lekë. Nga inspektori i kontrollit tatimor në raport kontrolli nuk është bërë një analizë e detajuar se nga është marrë ky burim të ardhurash për likuidimin e këtij zëri në vite. Nga auditimi i Pasqyrës së të Ardhurave dhe Shpenzimeve (PASH), rezulton se subjekti nuk i justifikon këto likuidime. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.2 faqe 38-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*	Fq 38-68	I larte	2. Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë mbi mangësitë dhe parregullsitë e konstatuar në procedurën e kontrollit tatimor referuar gjetjeve nga auditimi i KLSH, dhe të propozojë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve rikontroll tatimor ndaj subjektit, duke nxjerrë vlerësim tatimor me qëllim arkëtimin e vlerave.
3	Nga auditimi i raport kontrolleve të plota dhe tematike, për vitet 2018, 2019 dhe 2020		I larte	3.Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj,Tiranë, të analizoje dhe tw

	më 9 subjekte u konstatua nuk kanë kryer rakordimin e blerjeve në FDP me ato të deklaruara në pasqyrat financiare, nuk kanë kryer analizat e kosto- përfitim të mallarave të shitur, ku konstatohet shitje nën kosto e prudukteve gazoil, nuk kanë verifikuar diferencën tatime/dogana, Konstatohen diferenca në bilancin material, si dhe mungesë analize të kostos së mallit gjendje të deklaruara nga subjekti në fund të periudhëës ushtrimore, mungesë analize të shpenzimeve të cilat i shërbejnë aktivitetit, kreditim të padrejtë të TVSH-së. Konstatohen diferenca mes shitjeve të deklaruara nga subjekti në Sistemin C@ts dhe shitjeve të deklaruara në Nexus (shitjet me kasë), duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën totale 955,427,558 lekë**			nxjerrë përgjegjësitë mbi mangësi dhe parregullsitë e konstatuara nga auditimi në procedurën e kontrollit tatimor për 9 subjektet e paraqitur në tabelën më sipër, si dhe tí kërkojë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë rikontroll tatimor dhe nxjerrjen e vlerësimit tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit llogaritur në vlerën 955,427,558 lekë.
4	4.1 Nga auditimi i të dhënave në lidhje me deklarimin nga tatimpaguesit për Tatimin mbi Burim (TMB), për rubrikën {9-1} ñNdarje e fitimitò dhe rubrikën {8-1} TMB ñDividendò u konstatua se dy tatimpagues në shumën 4,011,000 lekë kanë vijuar me aplikimin e normës tatimore mbi Dividendin në shkallën 8% për fitimet e pashpërndara të vitit 2017 e më parë edhe pas afatit të fundit të aplikimit që është data 30 shtator 2019, në kundërshtim me nenin 38 ñDispozita kalimtareò, pika 9 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ñ*Për tatimin mbi të ardhurat*ò, i ndryshuar. pika 9, duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën** 6,016,500 lekë. 4.2 Për rubrikën {15-1} ñTMB Pagesat për qeratëò u konstatua se, për 4 tatimpagues në shumën 1,096,579 lekë nga DTM nuk është vepruar për të mbledhur detyrimet e TMB nga qeratë për llogari të organeve tatimore që gjatë vitit 2018, 2019 dhe 2020, të cilat kanë ushtruar veprimtari ekonomike në objekte apo terrene të kontraktuara me qera, në kundërshtim me kërkesat e nenit 35 ñMbajtja e tatimit në burim, regjistrimi, deklarimi dhe pagesaò të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 i ndryshuar; të nenit 60 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008; të Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 ñPër tatimin mbi të ardhuratò i ndryshuar, pika 2.3.6, duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën** 1,644,869 lekë.		I larte	4.1.Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë/Sektori i Kontrollit nga Zyra, pasi të analizojë rastet e konstatuara nga KLSH duke nxjerrë përgjegjësitë konkrete, të marrë masa për kryerjen e vlerësimeve dhe rivlerësimeve përkatëse të diferencave të konstatuara në shumën 1,644,869 lekë, për 4 tatimpaguesit, për të cilët nuk është vepruar për të mbledhur detyrimet e TMB nga qiratë për llogari të organeve tatimore që gjatë vitit 2018, 2019 dhe 2020, si dhe të nxjerrë aktet e ñNjoftim vlerësimit për detyrimet tatimoreò ndaj tatimpaguesve . 2.Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë/Sektori i Kontrollit nga Zyra, të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë mbi shkeljet e konstatuara, për kryerjen e vlerësimeve dhe rivlerësimeve përkatëse të diferencave të konstatuara në shumën 6,016,500 lekë,për 2 tatimpaguesit të cilët kanë vijuar me aplikimin e normës tatimore mbi Dividendin në shkallën 8% për fitimet e pashpërndara të vitit 2017 e më parë edhe pas afatit të fundit të aplikimit që ishte data 30 shtator 2019, si dhe të nxjerrë aktet e ñNjoftim vlerësimit për detyrimet tatimoreò ndaj tatimpaguesve.
5	Nga auditimi u konstatua se tatimpaguesi ñI. E.ò ka kryer zbritjen e TVSH-së (*referuar Aneksit 2/1 bashkëlidhur RPA*) për blerjet e kryera, për periudhën para së të miratohej leja e ndërtimit për këtë subjekt, në vlerë 24,757,624 lekë për importe të mallrave/ investimeve më shkallë 20%, në vlerën 194,102,412 lekë për blerje nga furnitorët vendas me shkallë 20%, në vlerën 2,270,082 lekë për blerje të investimeve nga furnitorët vendas me shkallë 20%, si dhe në vlerën 258,438,611 lekë për Autongarkesë TVSH në blerje, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 6, datë 30.01.2015 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 20, pika 8, gërma d, duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën** 48,427,496 lekë.	fq	I larte	Drejtoria Tatimpaguesve të Mëdhenj të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë mbi shkeljet e konstatuara në raport kontrollin e kryer në subjektin ñI. E.ò, SHPK si dhe tí propozojë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë rikontroll tatimor, duke nxjerrë vlerësim tatimor me qëllim llogaritjen dhe arkëtimin e vlerës së penaliteteve për furnizimet e furnitorëve vendas dhe investimeve e importeve të shumës prej **177,646,802 lekë.**

I.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Bazuar në riauditimin e kryer kemi konstatuar se Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM), për periudhën nga 01.01.2018 deri më 31.12.2020, nuk ka vepruar në përputhshmëri në të gjitha aspektet materiale me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, përmendur më poshtë tek ñBaza për opinion të kundërtò.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e DTM, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur **janë materiale por jo të përhapura** që justifikojnë dhënien e një opinioni **të kualifikuar /cilësuar**[1].

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese. Besojmë se evidencat e auditimit (informacioni dhe të dhënat) që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Konkluzionet dhe opinioni ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga DTM Tiranë, e cila konsiderohet nga ana e jonë e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme. Ne kemi përdorur gjykimin profesional dhe kemi ushtruar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinioni me siguri të arsyeshme.

Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit, niveli 3 (ISSAI 100-999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, të detajuara më pas në ISSAI-t e nivelit 4. Procedura e auditimit është bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 ñParimet themelore të auditimit të Përputhshmërisëò, ISSAI 4000 ñStandardet e Auditimit të Përputhshmërisëò; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë; praktikat e mira që lidhen me pavarësinë dhe ISSAI 130 Kodin e Etikës së INTOSAI dhe Kodin e Etikës së KLSH-së, si dhe dokumentimi i auditimit ka shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinioni në këtë auditim përputhshmërie.

Baza për opinion të kualifikuar/cilësuar.

Kuadri ligjor dhe rregullator i legjislacionit tatimor kërkon që DTM Tiranë të realizojë kontrollin tatimor në përputhje me aktet përkatëse. Nga auditimi rezultoi se veprimtaria mbi objektin dhe çështjen e audituar nuk është në përputhje me legjislacionin e procedurave tatimore.

Nga rezultatet e këtij auditimi, mbi dokumentacionin e kontrolleve të ushtruar në subjektet tatimpagues u konstatua se hartimi raporteve të kontrollit nga inspektorët tatimorë nuk është bërë në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve duke veçuar problematikat kryesore si më poshtë:

-Në kontrollet e ushtruara në 9 subjektet tatimpagues për vitet 2018, 2019 dhe 2020 inspektorët e kontrollit në vend nuk kanë zbatuar plotësisht drejtimet e programit të kontrollit, manualit të kontrollit tatimor si dhe legjislacionit tatimor, pasi nuk kanë kryer rakordimin e blerjeve në FDP me ato të deklaruara në pasqyrat financiare, nuk kanë kryer analizat e

[1]Opinion i kualifikuar/i cilësuar jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, por janë evidentuar raste të mos përputhshmërisë me kriteret e aplikuara, të cilat janë materiale, por jo të përhapura, ose kur audituesi nuk është në gjendje të mbledhë prova të mjaftueshme dhe tëpërshtatshme të auditimit dhe efektet e mundshme janë materiale, por jo të përhapura.

shitjeve ku konstatohet shitje nën kosto e produkteve gazoil, nuk kanë verifikuar diferencën tatime/dogana. Konstatohen diferenca në bilancin material, mungesë analize të kostos së mallit gjendje të deklaruara nga subjekti në fund të periudhës ushtrimore, mungesë analize të shpenzimeve të cilat i shërbejnë aktivitetit, kreditim të padrejtë të TVSH-së. Diferenca mes shitjeve të deklaruara nga subjekti në Sistemin C@TS dhe shitjeve të deklaruara në Nexus (shitjet me kasë), duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën totale 955,427,558 lekë**.

- Nga auditimi i të dhënave në lidhje me deklarimin nga tatimpaguesit për Tatimin mbi Burim (TMB): **-**Për rubrikën {15-1} ñTMB Pagesat për qiratëò u konstatua se, për 4 tatimpagues në shumën 1,096,579 lekë nga DTM nuk është vepruar për të mbledhur detyrimet e TMB nga qiratë për llogari të organeve tatimore që gjatë vitit 2018, 2019 dhe 2020, të cilat kanë ushtruar veprimtari ekonomike në objekte apo terrene të kontraktuara me qira, në kundërshtim me kërkesat e nenit 35 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 *"Për tatimin mbi të ardhurat"* i ndryshuar; të nenit 60 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò; të Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 ñPër tatimin mbi të ardhuratò i ndryshuar, pika 2.3.6.Në këto kushte tatimpaguesit penalizohen me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, sipas përcaktimit të kërkesave të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar neni 117, duke sjellë si pasojë që detyrimi në total për tu paguar të jetë në vlerën **1,644,869 lekë.**

-Nga auditimi mbi realizimin e planit të të ardhurave tatimore dhe shpërndarjes së miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për vitin 2019, të ardhurat të ñTatimit mbi Vlerën e Shtuarò janë programuar në masën *28,290,000 mijë lekë* dhe rishikuar me ulje në *28,528,000 mijë lekë*. Pavarësisht rishikimit, të ardhurave nga TVSH-ja rezultojnë të jenë arkëtuar në masën *23,995,919 mijë* lekë ose *me mosrealizim prej 15.9% ose -4,532,081 mijë lekë* më pak se plani. Për vitin 2020, të ardhurat të ñTatimit mbi Vlerën e Shtuarò janë programuar në masën *32,000,000 mijë lekë* dhe rishikuar me ulje në *27,500,000 mijë lekë*. Pavarësisht rishikimit, të ardhurave nga TVSH-ja rezultojnë të jenë arkëtuar në masën *23,782,177 mijë* lekë ose *me mosrealizim prej 13.5% ose 3,717,823 mijë lekë* më pak se plani.Për vitin 2020, të ardhurat tatimore mbi Tatim fitimin janë programuar në masën *23,000,000 mijë lekë* dhe rishikuar me ulje në *18,400,000 mijë lekë*. Pavarësisht rishikimit, të ardhurat nga Tatim fitimi rezultojnë të jenë arkëtuar në masën *17,399,062 mijë* lekë, duke përfshirë dhe parapagimet nga subjektet tatimpaguese ose *me mosrealizim prej 5.4% ose 1,000,938 mijë lekë* më pak se plani.

Përgjegjësitë e drejtuesve të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj

Stafi drejtues është përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve dhe funksioneve të strukturës në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si: Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimoreò, i ndryshuar, Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme dhe dhënien e opinionit nëse aktiviteti i Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, është kryer në përputhshmëri me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar.

Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu kemi aplikuar gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu kemi identifikuar dhe përpunuar riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, kemi planifikuar dhe kemi kryer procedura auditimi sipas risqeve të identifikuara, kemi grumbulluar evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Risku që vjen nga mos identifikimi i këtyre anomalive për shkak të mashtrimeve, është më i lartë se ai i gabimeve, sepse mashtrimi mund të përfshijë falsifikime, fshirje të qëllimshme, keqinterpretime, apo edhe mungesë të qëllimshme të kontrollit të brendshëm nëse ne arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri e arsyeshme, ne duhet të kushtojmë më tepër rëndësi këtyre çështjeve gjatë auditimit tonë, dhe të modifikojmë opinionin. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.
Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave kemi kryer punën tonë audituese dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.
Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e KLSHò, në zbatim të Programit të Riauditimit nr.544/1 prot., datë 27.05.2021, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 24.05.2021 deri më datë 15.10.2021, në subjektin Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj u krye riauditimi ñMbi auditimin e përputhshmërisëò për periudhën e aktivitetit të subjektit nga data 01.01.2018 deri më datë 31.12.2020 nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. M. H. (Përgjegjës Grupi)
2. T.A. Auditues
3. A. B. Auditues
4. J. G. Auditues

Riauditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, përputhshmëria me kriteret ligjore lidhur me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave tatimore, përputhshmëria ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit, Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara dhe Drejtorisë së Shërbimit ndaj Tatimpaguesit etj.
Në përfundim të punës audituese në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur akt konstatimet si dhe është organizuar takimi përmbyllës në (DTM) datë 15.10.2021 midis përfaqësuesve të DTM dhe grupit të auditimit, për të cilin është mbajtur protokolli përkatës. Mbi bazën e akteve të mbajtura nga KLSH është hartuar projektraporti i cili i është dërguar subjektit. Nga subjekti nuk është kërkuar takim ballafaques në KLSH sipas shkresës përcjellëse të projektraportit. Subjekti ka bërë observacionet përkatëse ndaj Pprojektraportit, të cilat pasi u shqyrtuan u reflektuan në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti i auditimit

Në objektivat dhe qëllimet e riauditimit, përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit

rregullator duke përfshirë këtu, dhënien e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së tij, nëse në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacionijanënëpërputhjeosejomedispozitat ligjore dherregulloretpërkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Auditimi synon në vlerësimin nëse procedurat dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi në sektorin publik, si dhe vlerësimi dhe evidentimi mbi shkeljen e legjislacionit fiskal dhe akteve ligjore në zbatim të tij.
Auditimi synon gjithashtu në përcaktimin nga ana e audituesve:
-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me legjislacionin për Buxhetin e Shtetit, me aktet të tjera nënligjore dhe me parimet e legjislacionit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;
- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;
- dhënien e Opinionit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së DTM, Tiranë.

3. Identifikimi i çështjes.

Raporti Përfundimtar mbi riauditimin e përputhshmërisë në veprimtarinë e DTMTiranë, për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2020, ka identifikuar sipas kritereve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:
- Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimi financiar dhe kontrollit, në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar sipas komponentëve.
- Përputhshmëria me kriteret ligjore, lidhur me të ardhurat, duke ndaluar në fushat kryesore të të ardhurave tatimore (tatim fitimi, tatimi mbi të ardhurat, tatimi mbi vlerën e shtuar, etj.) dhe jo tatimore në mbështetje të kuadrit fiskal në fuqi.
- Përputhshmërialigjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtorisë së Mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara dhe Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim.

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.
Ato janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator.
Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i njësisë/DTM dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e përcaktuara, i cili shprehet nëpërmjet dhënies së opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), si dhe Kodin e Etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinioni. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojë kërkesat etike si dhe të planifikojë e kryejë

auditimin, me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-^{së}) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

-Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit;

- Nëse të ardhurat janë realizuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin për procedurat tatimore dhe aktet në zbatim të tij, etj.;

- Nëse janë zbatuar dispozitat e akteve ligjore e nënligjore në planifikimin dhe arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji për procedurat tatimore në RSH;

- Nëse janë identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre etj.

6. Kriteret e vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë riauditim e kanë burimin në legjislacionin përkatës që rregullon çështjet si drejtime të auditimit:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò; Ligji nr.9920, datë 19.5.2008 ñPër procedurat tatimore në RSHò i ndryshuar, Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò; Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 ñKodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisëò etj.
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar;
- Akte të tjera ligjore/nënligjore.

7. Standardet e auditimit.

Standardet e zbatuara nga grupi gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit:

- ISSAI 100 (*Parime parimet themelore të auditimit të sektorit publik*), që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 400 (*Parime parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë),* që përcakton parimet themelore të ISSAI 100 dhe i zhvillon më tej ato, duke i përshtatur me konteksin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "*Prezantimi i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë";*
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) që zbatohen nga anëtarët e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve/IFAC;
- Manuali i Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve/ECA; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI ñ*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë";* etj.;
- Praktikat më të mira të fushës.

8. **Metodat e auditimit.**

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve tëkryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar, DTM, funksion në zbatim të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar e cila ushtron kontroll tatimor në subjektet tatimpagues, në mënyrë që të verifikojë përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi nga ana e tatimpaguesve, kontrollin ndaj evazionit fiskal apo shmangieve tatimore që mund të jenë kryer nga tatimpaguesi. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:
b. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimet e auditimit;
c. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit përmes pyetësorëve të dërguar me e-mail dhe plotësuar nga subjekti e shoqëruar me shkresat përkatëse, të cilat bëhen pjesë e dosjes së auditimit;
d. *Verifikimi në sistem* me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
e. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.
Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

9. Dokumentimi i auditimit.
Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me nëpunësit e DTM-së, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit, natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, e-mail-ve, të finalizuar këto në akt konstatimet e mbajtura në subjekt dhe më pas me shqyrtimin e observacioneve të subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij raporti.

I. PËRSHKRIMI AUDITIMIT.

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

DTM, është krijuar dhe funksionon në zbatim të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 , i ndryshuar dhe është strukturë e Administratës Tatimore Qendrore që merret direkt me mbledhjen e detyrimeve tatimore, me ofrimin e shërbimeve dhe asistencës për tatimpaguesit, kontrollin e deklaratave dhe pagesave, kontrollin e tatimpaguesve, si dhe mbledhjen e borxhit tatimor.
Bazuar në Urdhrin e Ministrit të Financave nr.13, datë 22.02.2017 ñ*Për miratimin e Rregullores së brendshme*ò, objekti kryesor i veprimtarisë së DTM është të verifikojë përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi nga ana e tatimpaguesve, kontrollin ndaj evazionit fiskal apo shmangieve tatimore që mund të jenë kryer nga tatimpaguesi. DTM-ja përbëhet nga Drejtori funksionale si: Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Drejtoria e Shërbimit ndaj Tatimpaguesit etj., nga Sektor dhe Zyra. Çdo strukturë organizative brenda DTM-së mbulon një funksion të caktuar.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

2.1.Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2020 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar sipas komponentëve.

Drejtuesit e DTM-së si njësi publike, sipas legjislacionit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, kanë detyrimin të zbatojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar dhe legjitimitetin në administrimin e fondeve publike dhe çdo aktivitet tjetër të lidhur me to.
Në zbatim të nenit 19 dhe 20 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëmò i ndryshuar, Titullari i njësisë të sektorit publik/DTM-së e cila është njësi shpenzuese në kuptim të ligjit, zbaton menaxhimin financiar dhe kontrollin përmes komponentëve të mëposhtëm të ndërlidhur me njëri-tjetrin:
1. ñ**Mjedisi i Kontrollit**ò komponent që përmban:
a) integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike;
b) politikat menaxheriale dhe stilin e punës;
c) strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;
ç) politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;
d) aftësitë profesionale të punonjësve.

Nga auditimi u konstatua:
a) Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.
DTM funksionon bazuar në rregulloren e miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr.19, datë 22.02.2017 e cila ka qenë në fuqi deri në gusht 2020. Me Urdhrin nr. 193, datë 12.08.2020, të ministrit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), është miratuar ñRregullorja e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendroreò. Në rregulloren e brendshme sanksionohen funksionet e punës për të gjithë strukturën përbërëse të administratës tatimore, organizimi i strukturave, emërtimi, përbërja, detyrat e tyre. Rregullorja parashikon rregulla për saktësimin e detyrave funksionale të çdo strukture të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore**.**
Bazuar në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 20, pika 2, germa (a), DTM disponon një ñKod Etike të administratës Tatimoreò përgatitur me mbështetjen e ekspertëve të projektit IPA 2007, financuar nga Bashkimi Evropian (BE) i cili është publikuar në vitin 2011 dhe ka qenë në fuqi deri në vitin 2020 i cili e shfuqizoi atë dhe miratoi me vendimin nr. 22, datë 17.12.2020, në mbledhjen e Komitetit të Reformave**.**
b) Politikat menaxheriale dhe stilin e punës.
Marrëdhëniet e punëdhënësit me punëmarrësin në DTM, rregullohen në bazë të ligjit 152/2013 ñPër nëpunësin civilò; i ndryshuar, Kodin e Punës në RSH, si dhe dispozitat e tjera ligjore parashikuar nga Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar.
c) Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.
Për periudhën objekt auditimi DTM ka funksionuar dhe është organizuar mbi bazën e strukturës dhe organikës të miratuar me Urdhrin nr.126 datë 02.08.2016 *"Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore",* Urdhrin nr.86, datë 03.05.2019, të Kryeministrit ñPër disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016 *"Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore" dhe* Urdhrit nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit ñPër disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, *"Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore",* Struktura dhe organika e institucionit ka të përcaktuar

numrin e punonjësve gjithsej, pozicionin e vendit të punës, si dhe kategorinë për çdo pozicion.

Titulli i gjetjes:	Procedura e ngritjes në detyrë për pozicionin ñDrejtor i DTM-sëò jo në përputhje me legjislacionin për nëpunësin civil dhe procedurat tatimore.
Situata:	**1**.Nga auditimi i komponentit ñMjedisi i kontrollitò i cili përmban ndër të tjera ñstrukturën organizative etj.ò, nga DTM për vitin 2020, nuk ishin menaxhuar me kujdes, persa i takon vendeve të lira dhe konkretisht për pozicionin Drejtor i DTM-së. Për këtë pozicion është bërë ñngritja në detyrëò, përmes urdhrit të titullarit të DPT-së i cili nuk është në përputhje me legjislacionin për nëpunësin civil dhe aktet në zbatim të tij cituar më poshtë, pasi procesi nuk i është nënshtruar konkurimit për vendin e lirë (i cili publikohet) përmes lëvizjes paralele dhe në kushtet e mosplotësimit të kësaj procedure të jetë shpallur ngritja në detyrë duke bashkëpunuar me DAP-in. Konkretisht me Urdhrin nr.56, datë 10.08.2020 të ish Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është caktuar znj. I. A. ñ*aktualisht me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të ushtrojë detyrat funksionale të Drejtorit të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj*ò. Procedura e ngritjes në detyrë nuk është bërë në përputhje me kërkesat dhe detyrimet ligjore që parashikon legjislacioni për nëpunësin civil dhe legjislacioni i procedurave tatimore, pasi procesi nuk i është nënshtruar konkurrimit për vendin e lirë të publikuar përmes lëvizjes paralele dhe në kushtet e mosplotësimit të kësaj procedure të jetë shpallur ngritja në detyrë duke bashkëpunuar me DAP-in. Procedura e ngritjes në detyrë në rastin konkret nuk i është referuar akteve ligjore të mëposhtme: - Ligjit nr.152/2013 ñPër nëpunësin Civilò i ndryshuar, neni 26, pika1: ñ*Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët ose të mesme drejtuese bëhet, **së pari**, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, **në rast të mosplotësimit** të vendit të lirë, me procedurën e ngritjes në detyrë*ò. - Ligjit nr. 9920, datë 18.05.2008 ñPër procedurat tatimoreò i ndryshuar neni 19, pika 1: ñ*Marrëdhëniet e punës së **nëpunësve të administratës tatimore** rregullohen sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil, përveç rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe*ò. Neni 20, pika 2: ñ*Për kategorinë e punonjësve, sipas pikës 1, të nenit 19, të këtij ligji, **procedurat** e punësimit**, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë** të tyre kryhen në përputhje me dispozitat e ligjit për nëpunësin civil".* - VKM-së nr. 242, datë 18.3.2015 ñ*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*ò Kreu II, pika 5: ñ*Për institucionet e administratës shtetërore, **shpallja e procedurës së konkurrimit** për secilin pozicion publikohet, në faqen zyrtare të DAP-it e portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe qëndron e publikuar, të paktën, deri në përfundimin e procedurës*ò. - Kreu III, pika 1: ñ*Në rastet kur **një vend vakant** në kategorinë e nivelit të ulët apo të mesëm drejtues **nuk plotësohet** nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, njësia përgjegjëse shpall procedurën e ngritjes në detyrë*ò. 2.Gjithashtu, figuron 1(një) vend i lirë në pozicionin Drejtor Drejtorie

	në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, i cili nuk është plotësuar në përputhje me strukturën e miratuar. Mos plotësimi i vendit të lirë kaq të rëndësishëm sjell funksionimin me kapacitet jo të plotë të drejtorisë, gjë e cila nuk është në përputhje me strukturën e miratuar nga Kryeministri me Urdhrin Nr. 86, datë 3.5.2019 dhe nr.33, datë 12.2.2020. *Veprimet e mësipërme janë kompetencë e titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike*.
Kriteri:	Ligji nr.152/2013 ñPër nëpunësin Civilò i ndryshuar, neni 26, pika1, Ligji nr. 9920, datë 18.05.2008 ñPër procedurat tatimoreò i ndryshuar neni 19, pika 1 VKM nr. 242, datë 18.3.2015 ñ*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*ò Kreu II, pika 5 dhe Kreu III, pika 1.
Ndikimi/Efekti:	Procedura e ngritjes në detyrë për pozicionin ñDrejtor i DTM-sëò është bërë pa konkurrim.
Shkaku:	Mos zbatimi i legjislacionit ñPër nëpunësn cvilò.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi	Të merren masa nga DTM që të kërkojë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në bashkëpunim më DAP-in, plotësimin e vendeve të lira në pozicionin ñDrejtor Drejtorie në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, si dhe rastet e lëvizjes paralele/ngritjes në detyrë, tôi nënshtrohen procedurës së konkurrimit publik konform kritereve të legjislacionit për nëpunësin civil.

Në zbatim të legjislacionit për MFK neni 9, pika 4/ç si dhe Manualit, Kapitulli II, pika 2.2.7 ku citohet ñ*NA të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e MFK-së kanë përgjegjësi …: caktimin dhe shkarkimin e Nëpunësit Zbatues*ò, për përmbushjen e këtij detyrimi ligjor për vitin buxhetor 2018-2019, nga NA i njësisë/ish Drejtorët Rajonal respektivë: znj. E. P. për periudhën 2018-05.07.2019 dhe z. Gj.S., për periudhën 08.07.2019 deri 21.01.2020, nuk është nxjerrë akti për emërimin në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), veprim jo në përputhje me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 indryshuar, neni 9, pika 4/ç. Për periudhën nga 21.01.2020 e në vijim, me shkresën nr.05/1 datë 21.01.2020 titullari i njësisë/DTM në cilësinë e NA z. Gj.S. ka kërkuar nga DPT ñ*njohjen e specimenit në cilësinë e NZ të z. A. N.*ò.

ç)<u>Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.</u>

Në rregulloren e brendshme të Institucionit janë përcaktuar rregullat dhe detyrat e organizimit, funksionimit dhe marrëdhënieve, ndërmjet njësive të brendshme administrative dhe nëpunësve që ushtrojnë aktivitetin në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj. Institucioni i ka përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, etikën, komunikimin e paraqitjen, shkeljet disiplinore, orarin dhe qëndrimin gjatë orarit të punës, etj.

d)<u>Aftësitë profesionale të punonjësve.</u>

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale,DPTnë bashkëpunim dhe nën drejtimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), bën trajnimin e personelit të administratës tatimore. Me vendimin nr.1, datë 20.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT, është miratuar programi vjetor i trajnimeve. Programi pas miratimit, së bashku me kalendarin e trajnimeve nga Bordi i Akademisë Fiskale pranë MFE, zbatohet në bashkëpunim me QTATD dhe ASPA. Drejtoria e Burimeve Njerëzore përcakton programe trajnimi siç

kërkohet edhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli III,pika 3.1. Mjedisi i kontrollit të brendshëm, në pjesët ñPolitikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzoreò dhe ñProfesionalizmi i stafitò.
Për vitin 2020, DMT me shkresën nr. 8397/1 datë 12.11.2020 drejtuar DPT-së ka kërkuar që në temat e trainimit për vitin 2021, të miratohet tema për MFK, kërkesë kjo e Sektorit të Financës në bashkëpunim me NA dhe NZ. Në përgjigje, DPT me shkresën nr.420/1 prot., datë 24.02.2021 nuk ka marrë në konsideratë këtë kërkesë.

2.ñMenaxhimi i Riskutò.

Nga auditimi i këtij komponenti u konstatua:

Titulli i gjetjes:	Mungesa e Regjistrit të Riskut dhe Grupit për menaxhimin strategjik.
Situata:	Nga DTM nuk është përmbushur përgjegjshmëria menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të Risqeve, monitorimin e kontrolleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, si dhe nuk është ngritur grupi i menaxhimit strategjik (GMS),veprime këto jo në përputhje me kërkesat e neneve 10, pika 1 dhe 2, nenit 11, pika 2, nenit 12, pika 3, 9 të Ligjit nr.10296/ 2010 i ndryshuar si dhe përcaktimet e nenit 30 të Rregullores për Funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore, miratuar me Urdhrin nr.19, datë 22.02.2017 të ministrit të Financave: Neni 12 ñNëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për:..identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnëé ò Neni 30: ñDrejtori i Funksioneve Mbështetëse harton regjistrin e riskut, vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave të Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse dhe realizon përmbledhjen në një regjistër të informacionit nga drejtoritë e tjera në DRTò, tagër dhe kompetencë e NZ z.A. N., me detyrë drejtor i Drejtorisë së funksioneve mbështetëse, bazuar në nenin 12, pika 3, germa ñdò e ligjit.
Kriteri:	Ligji nr.10296/ 2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar, Rregullore për Funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore, miratuar me Urdhrin nr.19, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e Regjistrit të Riskut dhe mungesa e Grupit për menaxhimin strategjik.
Shkaku:	Mos zbatimi i Ligjit nr.10296/ 2010 i ndryshuar dhe akteve në zbatim të tij.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi	Të merren masa nga DTM/Nëpunësi Zbatues për hartimin e Regjistrit të Riskut dhe ngritjen e GMS-së në të ardhmen.

3. "Veprimtaritë e kontrollit".

Struktura përcakton përgjegjësitë dhe kalimin e informacionit, që lejon monitorimin e veprimtarisë së institucionit nga Drejtori Njësisë deri te specialistët dhe e ndihmon drejtuesin në vendimmarrje. Drejtori i DTM është njëkohësisht dhe Nëpunësi Autorizues, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 3 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinòndryshuar, cakton si dhe Manualit ñPër menaxhimin financiar dhe

kontrollinò miratuarme Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, Kapitulli II, pika 2.2.7 sipas të cilit ñ*NA i njësisë shpenzuese është titullari i kësaj njësie*ò.
Delegimet e detyrave në DTM, bëhen me urdhër të Titullarit të Institucionit. Lidhur me delegimin e kompetencave, NA dhe NZ, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre, siç parashikohet nga Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 15, si dhe Kapitulli III ñDelegimi i detyraveò, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, njësia, ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.
Në drejtim të funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar konstatohet se **nuk janë hartuar** pyetësorët e Vetëvlerësimit, Deklarata dhe Raporti Vjetor për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm jo në përputhje me Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 18, pika 1 si dhe Manualit kapitulli III, pika 3.5, ku citohet:
ñ*Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 3 të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual*é ò.

3.“Informacioni dhe komunikimi”. Në DTM ka sisteme raportimi të ndryshme duke filluar nga eprori direkt deri tek titullari i institucionit në lidhje me realizimet parregullsitë apo dhe problematikat e hasura përmes komunikimit me shkrim apo në mënyrë verbale, mbledhjeve Brenda institucionit etj. Komunikimi përmes shkresave i referohet përgatitjes dhe formatimit të komunikuar nga DPT si dhe ndjek rregullat e protokollimit dhe arkivimit.

Konkluzion:
Për periudhën objekt auditimi (2018-2020) në lidhje me funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm u konstatua:
1. *Procedura e ngritjes në detyrë për pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj nuk është bërë në përputhje me Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, neni 26/1, Ligjit nr. 9920, datë 18.05.2008“Për procedurat tatimore“ i ndryshuar neni 19, pika 1 dhe neni 20, pika 2, VKM-së nr. 242, datë 18.3.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” Kreu II, pika 5 dhe Kreu III, pika 1, pasi është anashkaluar procedura e konkurrimit publik dhe jo në bashkëpunim me DAP-in.*
2.*Mos plotësimi i 1(një) vendi të lirë/vakant në pozicionin Drejtor Drejtorie në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, jo në përputhje me strukturën e miratuar nga Kryeministri meUrdhrin Nr. 86, datë 3.5.2019 dhe nr.33, datë 12.2.2020.*
3. Mungesa e ***Regjistrit të Risqeve*** *dhe* ***grupit për menaxhimin strategjik*** *është mos përmbushje e përgjegjshmërisë menaxheriale dhe nuk është në përputhje me kërkesat e neneve 10, pika 1 dhe 2, nenit 11, pika 2, nenit 12, pika 3, 9 të Ligjit nr.10296/ 2010 i ndryshuar si dhe përcaktimet e nenit 30 të Rregullores për Funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore, miratuar me Urdhrin nr.19, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave.*
4. *Mos hartimi i pyetësorëve të Vetëvlerësimit, Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm jo në përputhje me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” ndryshuar, neni 18, pika 1 si dhe Manualit kapitulli III, pika 3.5.*
5. *Mos miratimi në planin e trainimeve për vitin 2021, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve,i temës së trainimit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, sipas kërkesës së DTM-së, kufizon mundësinë për ngritjen profesionale të punonjësve.*

2.2.Përputhshmëria me kriteret ligjore, lidhur me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave tatimore, duke u ndalur në fushat kryesore të të ardhurave (tatim fitimi, tatimi mbi të ardhuat, tatimi mbi vlerën e shtuar etj.). Testimi i zonave me risk lidhur me mbledhjen e këtyre të ardhurave, sektorët dhe kontribuesit më të mëdhenj.

Në zbatim të pikës 2 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Shkresat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) për miratimin e planit të të ardhurave dhe ndryshimet e tij, për periudhën objekt auditimi;
- Të dhëna elektronike dhe fizike mbi realizimin e të ardhurave, për periudhën objekt auditimi;
- Të dhënat elektronike dhe fizike mbi listën e tatimpaguesve nën juridiksionin e DTM etj.

Nga auditimi u evidentua që të ardhurat tatimore në bazë deklarate, arkëtohen në një llogari të vetme në DPT. Ndërsa DRT-të e konkretisht DTM, nëpërmjet Sektorit të Analizës dhe të Kontabilitetit të të Ardhura kryen ndjekjen e realizimit të arkëtimit të ardhurave nga subjektet tatimpaguese nga sistemi informatik E-Tax duke përgatitur raporte me qëllim monitorimin e tyre. Pas procesit automatik të kontabilizimit të pagesave në sistemin E-tax, në llogarinë e çdo Tatimpaguesi raportimi i të dhënave lidhur me arkëtimet për llogari të DRT-ve (ku përfshihet dhe DTM) në SIQF bëhet çdo ditë në mënyrë automatike. Në fund të çdo periudhe raportuese (mujore dhe progresive) DPT, bën kontroll të raportimeve lidhur me arkëtimet e kontabilizuara në sistemin E-Tax në nivel të DRT. Raportimi mujor dhe progresiv finalizohet në fund viti duke nënshkruar evidencën përfundimtare nëpërmjet përfaqësuesit të Degës së Thesarit Tiranë dhe DPT.
Plani i miratuar për të ardhurat tatimore detajohet dhe miratohet nga **Komiteti i Përmbushjes në DPT**. Nga auditimi konstatohet se për shpërndarjen e planit të të ardhurave në nivel drejtorie është zbatuar metodologjia, mbështetur në të ardhurat faktike të viteve të mëparshme për secilën DRT dhe peshën specifike të secilës drejtori në totalin e të ardhurave tatimore.
Plani i ardhur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë shpërndahet bazuar në Metodologjinë e shpërndarjes së planit në nivel DRT vënë në dispozicion nga Drejtoria e Analizës dhe Statistikës, bazuar në përqindjet historike që zënë të ardhurat e realizuara në raport me totalin e arkëtimeve të tre viteve të fundit, për secilin zë të të ardhurave.
Më pas projektplani dërgohet për shqyrtim, ndryshim dhe miratim në mbledhjen e Komitetit të Përmbushjes dhe më tej për miratim tek Drejtori i Përgjithshëm, e cila e dërgon planin në secilën nga DRT-të, procedurë kjo e ndjekur ndër vite nga DPT.
Referuar metodologjisë së shpërndarjes së planit sipas drejtorive rajonale, grupi i auditimit kërkoi parashikimet e arkëtimeve nga DMT dërguar në DPT, por nuk rezultoi të kishte një parashikim të tillë bërë nga Drejtoria e Analizës dhe të Kontabilitetit të të Ardhurave.

Drejtoria tatimpaguesve të Mëdhenj realizon monitorimin e të ardhurave tatimore e përqendruar në një llogari të qendërzuar në DPT dhe të ardhurave dytësore nga subjektet Tatimpagues në DTM dhe përgatit në fund të çdo muaji dhe tremujori raporte dhe evidenca për DPT dhe titullarin e institucionit për realizimin e treguesve të ardhurave tatimore, si dhe evidencat të detyrimeve debitorë që mbahen jashtë sistemit informatik C@TS.
Në lidhje me realizimin e të ardhurave tatimore, në krahasim me planifikimin e tyre, gjendja paraqitet si më poshtë vijon:

Viti 2018

Tabela nr. 1: *Treguesit e të ardhurave tatimore për vitin 2018*

Lekë

Nr.	Përshkrimi	Ndryshimet e planit të të ardhurave			Fakti 2018	Diferenca Fakt/Plan	Realizimi në përqindje Fakt/Plan
		Shkresa nr. 2921/1, datë 16.02.2018	Shkresa nr. 15125/1, datë 27.07.2018	Shkresa nr. 20537/1, datë 08.10.2018			
	D.R. Tatimpaguesit e Mëdhenj (bruto)	94,265,000	94,610,000	93,960,000	94,359,636	399,636	100.40%
A	Të Ardhurat Tatimore gjithsej (arkëtim)	76,080,000	76,425,000	74,969,000	74,639,695	-329,305	99.60%
1	Tatimi Vlerës se Shtuar (bruto)	28,150,000	28,150,000	26,822,000	27,722,887	900,887	103.40%
	- Tatimi Vlerës se Shtuar (neto)	20,850,000	20,850,000	19,522,000	19,646,586	124,586	100.60%
	- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	7,300,000	7,300,000	7,300,000	8,076,301	776,301	110.60%
2	Tatim mbi Fitimin	19,670,000	19,670,000	19,407,000	20,690,837	1,283,837	106.60%
3	Ardhura Personale	16,250,000	16,250,000	16,040,000	14,859,720	-1,180,280	92.60%
4	Taksat Kombëtare	6,927,000	7,272,000	7,617,000	7,171,304	-445,696	94.10%
5	Taksa Qarkullimit dhe Karburantit	0	0	0	0	0	
6	Lojërat e Fatit	5,083,000	5,083,000	5,083,000	4,141,262	-941,738	81.50%
7	Te tjera pa identifikuar	0	0	0	0	0	
8	Dënimet Administrative	0	0	0	53,685	53,685	
B	Të Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	68,780,000	69,125,000	67,669,000	66,563,394	-1,105,606	98.40%
C	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	18,185,000	18,185,000	18,991,000	19,719,940	728,940	103.80%
D	D.R.Tatimpaguesit e Mëdhenj (neto)	86,965,000	87,310,000	86,660,000	86,283,335	-376,665	99.60%
	Tarifa jo tatimore				3,150,972		

Burimi: DTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Në korrik 2018, plani është rritur me 345,000 mijë lekë nga rritja e të ardhurave nga taksa kombëtare, ndërsa në muajin tetor plani është zvogëluar nga plani i rishikuar me 1,328,000 mijë lekë për të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), zvogëlim me 263,000 mijë lekë për të ardhurat nga Tatim Fitimi (TF), zvogëlim me 210,000 mijë lekë për të ardhurat personale, si dhe rritje me 345,000 mijë lekë nga rritja e të ardhurave nga taksa kombëtare.

Sipas përcaktimeve të Rregullores për Funksionimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore miratuar me Urdhrin e MFE nr.19 datë 22.02. 2017, nenet 11 deri 13 drejtoria e cila ndjek treguesit në mbledhjen e të ardhurave është Drejtoria e Analizës, Kontabilitetit dhe Teknologjisë së Informacionit. Sipas strukturës organike kjo drejtori përbëhet nga 2 sektorë dhe me një staf të parashikuar prej 7 punonjësish nga të cilët, më date 31.12.2018 rezultojnë në fakt 6 prej tyre, pasi pozicioni i Drejtorit figuron vakant në këtë datë. Megjithëse detyrat e asistimit dhe përditësimit të evidencave të realizimit sipas rregullores janë detyrë e sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit konstatohet që këto evidenca hartohen dhe përpunohen prej Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetit.

Të ardhurat e mbledhura nga administrata tatimore për vitin 2018 krahasuar me planifikimin janë realizuar në masën 100.4% ose 399,636 mijë lekë më tepër në terma bruto. Trajtimi sipas të ardhurave bruto kryhet pasi efekti i rimbursimit të TVSH-së efektivisht realizohet prej DPT ndërsa DTM kryen rimbursime të TVSH-së, pasojë e vendimeve të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, apo vendimeve të gjykatës të formës së prerë, por edhe rimbursime tatimesh të tjera të parashikuara në ligj.

- Për vitin 2018 TVSH (Bruto) u pakësua me shpenzimet e rimbursimit të kryera nga DPT për llogari të tatimpaguesve në administrim të DTM, për shumën 8,076,301 mijë lekë, të cilat kundrejt planifikimin vjetor në shumën 7,300,000 mijë lekë, kanë rezultuar me rritje të shpenzimeve për rimbursim për më tepër në shumën 776,301 mijë lekë ose 10.6% më shumë se plani rishikuar për rimbursim.

Për periudhën 2018 konstatohet se kanë bërë kërkesë për rimbursim 150 subjekte dhe vlera totale e kërkuar për rimbursimi është 12,563,004 mijë lekë, ndërkohë që vlera e miratuar për rimbursimin e TVSH për subjektet është 11,635,131 mijë lekë.
Për vitin 2018, të ardhurat personale me peshë specifike 21,4% të të ardhurave tatimore gjithsej (arkëtime) janë programuar në masën 16,250,000 mijë lekë dhe rishikuar me ulje në shumën 16,040,000 mijë lekë ose krahasuar me vitin e mëparshëm 424,185 mijë lekë më shumë, me një rritje 2.72%. Të ardhurat personale përbëjnë 19,9 % të të ardhurave tatimore gjithsej(arkëtime). Të Ardhurat personale paraqiten me mosrealizim në masën 7,4% ose 1,180,280 mijë lekë.
Ndër treguesit me performancë pozitive krahasuar me planifikimin për vitin 2018 paraqiten:
- Tatimi i vlerës së shtuar neto me realizim në masën 100.6% ose 124,586 mijë lekë më ~~tepër~~ shumë se planfikimi;
- Tatimi mbi fitimi, me realizim në masën 106.6% ose 1,283,837 mijë lekë mbi planin.
Ndikim në mosrealizim nga plani janë të ardhurat nga Lojërat e fatit në masën 81.5% ose 941,738 mijë lekë më pak.
Duhet plotësuar me analizën e mosrealizimit të të ardhurave dhe nga taksat kombëtare duke evidentuar dhe përgjegjësitë për mosrerealizmet

Viti 2019

Tabela nr. 2: *Treguesit e të ardhurave tatimore për vitin 2019*

Lekë

Nr.	Përshkrimi	Ndryshimet e planit të të ardhurave			Fakti 2019	Diferenca Fakt/Plan	Realizimi në përqindje Fakt/Plan
		Shkresa nr. 2259/1, datë 01.03.2019	Shkresa nr. *Nr.9355/1* datë 03.06.2019	Shkresa nr. 12100/1, datë 02.10.2019			
	D.R. Tatimpaguesit e Mëdhenj (bruto)	96,680,500	97,114,000	96,904,000	95,265,237	-1,638,763	98.30%
A	Të Ardhurat Tatimore gjithsej (arkëtim)	75,970,500	77,158,000	76,948,000	74,358,878	-2,589,122	96.60%
1	Tatimi Vlerës se Shtuar (bruto)	28,290,000	28,738,000	28,528,000	23,995,919	-4,532,081	84.10%
	- Tatimi Vlerës se Shtuar (neto)	15,990,000	16,438,000	16,228,000	8,384,615	-7,843,385	51.70%
	- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	12,300,000	12,300,000	12,300,000	15,611,305	3,311,305	126.90%
2	Tatim mbi Fitimin	18,559,000	18,665,000	18,665,000	22,051,193	3,386,193	118.10%
3	Ardhura Personale	17,030,000	17,345,000	17,345,000	18,915,374	1,570,374	109.10%
4	Taksat Kombëtare	8,810,000	8,810,000	8,810,000	7,480,469	-1,329,531	84.90%
5	Taksa Qarkullimit dhe Karburantit	3,000,000	3,000,000	3,000,000	996,993	-2,003,007	33.20%
6	Lojërat e Fatit	281,500	600,000	600,000	874,612	274,612	145.80%
7	Te tjera pa identifikuar	0	0	0	0	0	
8	Dënimet Administrative	0	0	0	44,318	44,318	
B	Të Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	63,670,500	64,858,000	64,648,000	58,747,574	-5,900,426	90.90%
C	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	20,710,000	19,956,000	19,956,000	20,906,359	950,359	104.80%
D	D.R. Tatimpaguesit e Mëdhenj (neto)	84,380,500	84,814,000	84,604,000	79,653,933	-4,950,067	94.10%
	Tarifa jo tatimore				3,370,792		

Burimi: DTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Në korrik 2019, plani është rritur me 433,500 mijë lekë nga rritja e tëTVSH bruto, rritja e tatim fitimit në vlerën 106,000 mijë lekë, rritja e të ardhurave personale në vlerën 315,000 mijë lekë, rritja e të ardhurave nga lojërat e fatit në vlerën 318,500 mijë lekë dhe rënie të

vlerës së Kontributet e Sigurimeve në vlerën 754,000 mijë lekë, ndërsa në muajin tetor plani është zvogëluar nga plani i rishikuar me 1,328,000 mijë lekë për të ardhurat nga TVSH, zvogëlim me 210,000 mijë lekë, për të ardhurat Tatimi Vlerës se Shtuar (bruto).
Të ardhurat e mbledhura nga administrata tatimore për vitin 2019 krahasuar me planifikimin janë realizuar në masën 98.3% ose 1,638,763 mijë lekë më pak në terma bruto.
- Për vitin 2019 TVSH (Bruto) u pakësua me shpenzimet e rimbursimit të kryera nga DPT për llogari të tatimpaguesve në administrim të DTM, për shumën 15,611,305 mijë lekë, të cilat kundrejt planifikimin vjetor në shumën 12,300,000 mijë lekë, kanë rezultuar me rritje të shpenzimeve për rimbursim për më tepër në shumën 3,311,305 mijë lekë ose 26.9% më shumë se plani rishikuar për rimbursim.
Për vitin 2019 konstatohet se kanë bërë kërkese për rimbursim 163 subjekte dhe vlera totale e kërkuar për rimbursimit është 20,403,184 mijë lekë, ndërkohë që vlera e miratuar për rimbursimin e TVSH për subjektet është 20,083,393 mijë lekë.
- Të ardhurat personale me peshë specifike 22.4% të të ardhurave tatimore janë programuar në masën 17,030,000 mijë lekë dhe janë rishikuar me rritje prej 315 mijë lekë, duke marrë në konsideratë rritjen e pragut të taksimit të pagave me tarifën 23%, uljen e normës së tatimit mbi dividendin nga 15% në 8%, duke përfshirë efektet pozitive nga shpërndarja e fitimeve të mbartura nga vitet e kaluara.
Të ardhurat personale përbëjnë 25,4 % të të ardhurave tatimore të arkëtuara gjithsej. Të ardhurat personale paraqiten me tejkalim në masën 9,1% ose 1,570,374 mijë lekë. Ky tejkalim vjen kryesisht nga zëri dividend si pasojë e një lehtësimi fiskal bërë në ligjin e të ardhurave në vitin 2019 dhe konkretisht në këtë vit tatimpaguesit kanë bërë pagesë tatimi në burim për dividend 3 herë më shumë se viti 2018.
Ndër treguesit me performancë pozitive krahasuar me planifikimin për vitin 2019 do të rendisim, të ardhurat nga tatim fitimi me realizim në masën 118.1% ose 3,386,193 mijë lekë më tepër, të ardhurat personale me realizim në masën 109.1% ose 1,570,374 mijë lekë më tepër dhe të ardhurat mbi lojërat e fatit me realizim në masën 145.8% ose 274,612 mijë lekë më tepër.
Treguesit kryesorë me performancë negative rezultojnë:
- TVSH-ja, zë i cili krahasuar me planin është realizuar në masën 84,1% ose 4,532,081 mijë lekë më pak se plani përfundimtar i vitit 2019. Nga evidenca e grumbulluar rezulton se viti 2019, është viti në mbledhjen e të ardhurave nga TVSH në masë shumë të vogël, vit në të cilin DPT me plan të rishikuar ka planifikuar që DTM duhet të mbledhë TVSH në shumën 28,528,000 mijë lekë. Realizimi i këtij objektivi nga kjo administratë nuk është përmbushur, pasi arkëtimi është realizuar në shumën 23,995,920 mijë lekë, ose 15.9 % më pak se plani.
Megjithëse të ardhurat kanë rënie të konsiderueshme, shpenzimet e rimbursimit tejkalojnë planin e rimbursimit në vlerën 3,311,305 mijë lekë ose 26.9% më shumë se plani rimbursimit.
Realizimi të ardhurave nga TVSH, është i rëndësishëm për të ardhurat tatimore nga ky lloj tatimi, pasi Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në nivel kombëtar për vitin 2018 zë 54.46%, për vitin 2019 zë 48.52% të të ardhurave vjetore nga TVSH. Mosrealizimi i planit vjetor ose raporti i zhdrejte TVSH (neto)/Rimbursim ndikon në realizimin e të ardhurave në vitin buxhetor sipas planifikimit nga MFE.
- Taksat nacionale nuk ka përformuar pozitivisht gjatë kësaj periudhe krahasuar me planin me realizim në masën 84,9% ose 1,329,531 mijë lekë më pak se plani përfundimtar i vitit 2019.
- Taksa Qarkullimit dhe Karburantit nuk ka përformuar pozitivisht gjatë kësaj periudhe krahasuar me planin me realizim në masën 33.2% ose 2,003,007 mijë lekë më pak se plani përfundimtar i vitit 2019.

Viti 2020
Tabela nr. 3: *Treguesit e të ardhurave tatimore për vitin 2020*

Lekë

Nr.	Përshkrimi	Ndryshimet e planit të të ardhurave		Fakti 2020	Realizimi në vlerë	Realizimi në përqindje
		Shkresa nr. 1727/1, datë 14.02.2020 (vjetor)	Shkresa nr. 15093, datë 06.08.2020			
	D.R. Tatimpaguesit e Mëdhenj (bruto)	112,003,000	96,740,000	88,708,521	-8,031,479	91.7%
A	Të Ardhurat Tatimore gjithsej (arkëtim)	88,403,000	75,170,000	66,526,400	-8,643,600	88.5%
1	Tatimi Vlerës se Shtuar (bruto)	32,000,000	27,500,000	23,782,177	-3,717,823	86.5%
	- Tatimi Vlerës se Shtuar (neto)	18,600,000	14,100,000	13,366,904	-733,096	94.8%
	- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	13,400,000	13,400,000	10,415,273	-2,984,727	77.7%
2	Tatim mbi Fitimin	23,000,000	18,400,000	17,399,062	-1,000,938	94.6%
3	Ardhura Personale	22,500,000	19,500,000	17,936,359	-1,563,641	92.0%
4	Taksat Kombëtare	8,493,000	7,780,000	6,703,608	-1,076,392	86.2%
5	Taksa Qarkullimit dhe Karburantit	1,550,000	1,400,000	0	-1,400,000	0.0%
6	Lojërat e Fatit	860,000	590,000	694,242	104,242	117.7%
7	Te tjera pa identifikuar	0	0	0	0	
8	Dënimet Administrative	0	0	10,591	10,591	
B	Të Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	75,003,000	61,770,000	56,111,128	-5,658,872	90.8%
C	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	23,600,000	21,570,000	22,182,121	612,121	102.8%
D	D.R.Tatimpaguesit e mëdhenj (neto)	98,603,000	83,340,000	78,293,249	-5,046,751	93.9%

Burimi: DTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Plani vjetor ka ndryshuar 2 herë krahasuar me atë fillestar.

Në gusht 2020, plani është ndryshuar me 15,263,000 mijë lekë në total si rezultat i uljes shumës së pritshme për arkëtimin e TVSH-së bruto në vlerën prej 13,233,000 mijë lekë, ulja e tatim fitimit në vlerën 4,600,000 mijë lekë, ulja e të ardhurave personale në vlerën 3,000,000 mijë lekë, ulja e të ardhurave nga lojërat e fatit në vlerën 270,000 mijë lekë, ulja e të ardhurave nga taksa kombëtare në vlerën 713,000 mijë lekë dhe ulje të vlerës së Kontributit të Sigurimeve në vlerën 2,030,000 mijë lekë,

Të ardhurat e mbledhura nga administrata tatimore për vitin 2020 krahasuar me planifikimin janë realizuar në masën 91,7% ose 8,031,479 mijë lekë më pak në terma bruto.

- Për vitin 2020, TVSH (bruto) u pakësua me shpenzimet e rimbursimit të kryera nga DPT për llogari të tatimpaguesve në administrim të DTM, për shumën 10,415,273 mijë lekë, të cilat kundrejt planifikimin vjetor në shumën 13,400,000 mijë lekë, kanë rezultuar me ulje të shpenzimeve për rimbursim në shumën 2,984,727 mijë lekë ose 22.3% më pak se plani rishikuar për rimbursim.

Për vitin 2020 konstatohet se kanë bërë kërkese për rimbursim 188 subjekte dhe vlera totale e kërkuar për rimbursimit është 7,795,797 mijë lekë, ndërkohë që vlera e miratuar për rimbursimin e TVSH për subjektet është 7,667,561 mijë lekë.

- Të ardhurat personale me peshë specifike 25.9% të të ardhurave tatimore janë programuar

në masën 22,500,000 mijë lekë dhe janë rishikuar me ulje e tyre në vlerën prej 3,000,000 mijë lekë,

Të ardhurat personale paraqiten me mosrealizim në masën 8% ose 1,563,641 mijë lekë më pak.

Ndikim në ulje të arkëtimeve pati pandemia e Covid-19 ku disa sektorë të ekonomisë u prekën duke ulur numrin e të punësuarve e si rrjedhim edhe pagat dhe pagesat për TAP, si dhe efekti në vitin 2019 i ndryshimeve me Ligjin 94/2018 ñPër disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò në lidhje me lehtësimin fiskal të shkallës tatimore për të ardhurat nga dividendi.

Ndër treguesit me performancë pozitive krahasuar me planifikimin për vitin 2020 do të rendisim, të ardhurat nga Lojërat e fatit me realizim në masën 117.7% ose 104,242 mijë lekë

më tepër, dhe të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve me realizim në masën 102,8% ose 612,121 mijë lekë më tepër.
Treguesit kryesorë me performancë negative rezultojnë:
- TVSH-ja, zë i cili nuk ka performuar pozitivisht gjatë kësaj periudhe krahasuar me planin është realizuar në masën 86,5% ose 3,717,823 mijë lekë më pak se plani përfundimtar i vitit 2020.
Megjithëse të ardhurat kanë rënie të konsiderueshme, shpenzimet e rimbursimit tejkalojnë planin e rimbursimit në vlerën 3,311,305 mijë lekë ose 26.9% më shumë se plani rimbursimit.
- Tatimi mbi fitimin është realizuar në masën 94,6% ose 1,000,038 mijë lekë më pak se plani i rishikuar.
- Tatimi mbi të ardhurat personale është realizuar në masën 92% ose 1,563,641 mijë lekë më pak se plani i rishikuar.
- Taksat kombëtar eështë realizuar në masën 86,2% ose 1,076,392 mijë lekë më pak se plani i rishikuar.
- Taksa Qarkullimit dhe Karburanitit është realizuar në masën 0%
Plani i miratuar nga DPT për zërin ñTë Ardhura personaleò nuk detajohet sipas llojit të të ardhurave personale por në mënyrë sintetike i përcillet DTM për zbatim.
Të dhënat e paraqitura nga Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit për vitet 2018, 2019 dhe 2020 janë thjesht evidenca statistikore.
Nga Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit në DTM nuk është bërë një analizë e detajuar e të gjithë zërave të të ardhurave personale, për të gjetur shkaqet e realizimit dhe mosrealizimit të tyre (viti 2018, 2020) pavarësisht se është bërë rishikimi me ulje gjatë vitit nga plani fillestar)dhe për të rritur performancën në mbledhjen e të ardhurave personale, në kundërshtim me Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore me nr.1482 prot., datë 27.02.2017 neni 12 òFunksionet e Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetitò.
-Të Ardhurat personale për vitin 2018 rezultojnë me trend në ulje prej 4,84% ose me diferencë të ardhurash prej 756,096 mijë lekë më pak se viti 2017.
-Të Ardhurat personale për vitin 2019 rezultojnë me trend në rritje prej 27,29% ose me diferencë të ardhurash prej 4,055,654 mijë lekë më shumë se viti 2018.
-Të Ardhurat personale për vitin 2020 rezultojnë me trend në ulje prej 5 % ose me diferencë të ardhurash prej 979,015 mijë lekë më pak se viti 2019.
Për të bërë një analizë të situatës financiare së të ardhurave personale për te tre vitet objekt auditimi sipas zërave të tatimit në burim i jemi referuar të dhënave mbi deklarimet për pagesë të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi nga listëpagesat dhe të tatimit të mbajtur në burim të vënë në dispozicion nga sistemi informatik C@TS për periudhën e auditimit.

Tabela nr. 4: *Treguesit e të ardhurave personale për tre vite*

Lekë

Struk.	Lloji i të Ardhurave	2018	2019	2020
		Deklarimi	Deklarimi	Deklarimi
A.	Tatimi mbi të ardhurat personale	18,403,181,264	24,350,245,542	15,496,306,457
	Nga i cili:			
1	Tatimi mbi page nga listepagesa	9,689,744,247	9,936,013,516	9,450,817,783
2	Tatimi në burim nga deklarata	8,713,437,017	14,414,232,026	6,045,488,674
2.1	Dividendët	1,986,643,712	6,325,030,796	940,775,679
2.2	Ndarjet e fitimit	278,068,521	688,098,120	150,764,856
2.3	Interesat	1,850,313,092	1,932,737,699	1,948,838,951
2.4	Pagesat për të drejtat e autorit dhe për pronësinë intelektuale	180,803,604	209,641,170	137,073,526
2.5	Pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, shërbimet financiare dhe ato të sigurimit	1,200,184,777	1,195,061,322	1,102,390,146
2.6	Pagesat për menaxhimin dhe pjesëmarrjen në këshillat drejtues	74,582,226	89,494,473	78,307,083

2.7	Pagesat për ndërtimin, instalimin, montimin ose për punë mbikëqyrëse që lidhen me to	1,630,940,557	44,437,658	23,168,072
2.8	Pagesat për qiratë	1,380,709,328	1,452,703,387	1,323,986,746
2.9	Pagesat për shfaqjet e aktorëve, të muzikantëve ose sportistëve	111,760,324	75,685,637	53,769,842
2.1	Të ardhurat e Individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë	19,430,876	52,571,418	32,600,273
2.11	Pagesat për kalimin e të drejtës së pronësisë me shitje	-	2,275,964,816	238,249,912
2.12	Pagesat për kalimin e të drejtës së pronësisë me trashëgimi ose dhurim	-	72,805,530	15,563,588
	Arkëtim të raportuara	14,859,720,000	18,915,374,000	17,936,359,000

Burimi: Sistemi informatik C@TS, përpunuar nga grupi i auditimit

Siç vihet re, tatimi mbi pagë nga listëpagesat, zë peshën specifike më të madhe në totalin e të ardhurave personale të deklaruar për pagesë (53%, 41%, 61%), ndërsa nga tatimi i mbajtur në burim zëri ñdividendò zë peshën specifike më të madhe për vitin 2018-2019 (10.7% dhe 25.9%) në totalin e të ardhurave personale të deklaruar për pagesë dhe për vitin 2020 e zë tatimi në burim nga interesat (12.5%) ;

- Tatimi mbi pagë nga listëpagesa, në vitin 2018 rezulton 9,689,744 mijë lekë, në vitin 2019 rezulton 9,936,013 mijë lekë me trend në rritje me 246,269 mijë lekë krahasuar me vitin 2018. Për periudhën vitit 2020 rezulton 9,450,817 mijë lekë me trend në rënie me 485,195 mijë lekë më pak krahasuar me vitin 2019, si pasojë e pandemisë Covid-19 ku disa sektorë të ekonomisë u prekën duke ulur numrin e të punësuarve e si rrjedhim edhe pagat dhe pagesat për TAP.

-Numri i të punësuarve nga tatimpaguesit në administrim të DTM-së për vitin 2018 rezulton 1,503,438 punonjës, për vitin 2019 është 1,539,643 punonjës me trend në rritje me 36,205 punonjës krahasuar me vitin 2018. Për vitin 2020 rezulton 1,500,234 punonjës, me trend në rënie me 39,389 punonjës më pak se viti 2019.

- Në vitin 2018 evidentohen 30 subjekte të cilët deklarojnë tatim mbi të ardhurat nga punësimi 0 lekë; në vitin 2019 evidentohen 15 subjekte të cilat deklarojnë tatim të ardhurat nga punësimi 0 lekë dhe për vitin 2020 evidentohen 16 subjekte që deklarojnë tatim mbi të ardhurat nga punësimi 0 lekë.

Arkëtimet e raportuara nga Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit për tatimin mbi pagë nga listëpagesat rezultojnë:

-për vitin 2018 arkëtimet e regjistruara në total 8,197,336 mijë lekë të klasifikuara sipas kodit buxhetor 7000100 ñnga të punësuarit e sektorit buxhetor dhe publikò në shumën 702,704 mijë lekë dhe në kodin buxhetor 7000200 ñnga të punësuarit e sektorit privatò në shumën 7,494,631 mijë lekë.

-për vitin 2019 arkëtimet e regjistruara në total 8,707,096 mijë lekë të klasifikuara sipas kodit buxhetor 7000100 ñnga të punësuarit e sektorit buxhetor dhe publikò në shumën 742,451 mijë lekë dhe në kodin buxhetor 7000200 ñnga të punësuarit e sektorit privatò në shumën 7,964,644 mijë lekë.

-deri vitin 2020 arkëtimet e regjistruara në total 8,724,649 mijë lekë të klasifikuara sipas kodit buxhetor 7000100 ñnga të punësuarit e sektorit buxhetor dhe publikò në shumën 885,184 mijë lekë dhe në kodin buxhetor 7000200 ñnga të punësuarit e sektorit privatò në shumën 7,839,464 mijë lekë.

Tatimi në burim nga deklarata për dividendin:

<u>Për vitin 2018:</u>

- Nga 733 subjekte që kanë deklaruar për pagesë tatim në burim 188 prej tyre ose rreth 26% e numrit gjithsej kanë deklaruar dividend për Rubrikën 8-1 ñTatimi mbi të ardhurat nga Dividendët dhe Aksionetò në shumën 1,986,643 mijë lekë dhe 40 subjekte ose rreth 5,5% e numrit gjithsej kanë deklaruar për pagesë tatim në burim për Rubrikën 9-1 ñNdarjet e fitimitò në shumën 278,068 mijë lekë. Arkëtimet e raportuara në kodin buxhetor 7009100 ñTatimi mbi të ardhurat nga Dividendët dhe Aksionetò në shumën 2,251,374 mijë lekë.

-Pesha specifike në të ardhurat e raportuara për zërin ñTatim mbi të ardhurat nga Dividendët dhe Aksionetò është 61% e totalit të arkëtimeve për këtë zë ose rreth 2.3 miliard lekë nga 3.7 miliard lekë gjithsej të arkëtuara gjatë vitit 2018 nga të gjitha DRT-të, duke patur parasysh se për këtë vit transferohen nga DRT Tiranë për tek DTM 228 subjekte me qarkullim të deklaruar të = > se 500 milion lekë (2018).
Kontribuesit më të mëdhenj të cilët kanë deklaruar dhe shpërndarë dividend janë rreth 15 subjekte, të cilët përbëjnë rreth 49% të totalit të arkëtimeve (Lista e subjekteve bashkangjitur në Aneksin nr.1/1, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
- Nga auditimi i të dhënave mbi deklarimin dhe arkëtimin për tatimin në burim për dividend, evidentohen se 20 tatimpagues në shumën rreth 80 milionë lekë kanë vijuar me deklarimin dhe pagesën për ñTatimi mbi të ardhurat nga Dividendët dhe Aksionetò për shpërndarjen e fitimit të vitit 2017 jashtë afatit ligjor të përcaktuar që është, jo më vonë se data 20 gusht, e vitit kur bëhet miratimi i rezultateve financiare, pra i vitit 2017, pavarësisht nëse është bërë ose jo shpërndarja e dividendit, pra pas afatit ligjor 20 gusht 2018 siç përcaktohet me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër Tatimin mbi të Ardhuratò i ndryshuar, neni 33/1 pika 3, për të cilat sistemi gjeneron automatikisht gjobë e kamatvonesë.

<u>Për vitin 2019</u>
- Nga 789 subjekte që kanë deklaruar pagesë tatim në burim ose 327 prej tyre ose 41% e numrit gjithsej kanë deklaruar dividend për Rubrikën 8-1 ñTatimi mbi të ardhurat nga Dividendët dhe Aksionetò në shumën 6,325,030 mijë lekë dhe 74 subjekte ose 9,4% e numrit gjithsej kanë deklaruar për Rubrikën 9-1 ñNdarjet e fitimitò në shumën në shumën 688,098 mijë lekë. Arkëtimet e raportuara në kodin buxhetor 7009100 ñTatimi mbi të ardhurat nga Dividendët dhe Aksionetò në shumën 5,725,391 mijë lekë.
Viti 2019 rezulton me rritje të ndjeshme të arkëtimeve për shkak se deri në shtator 2019 subjektet kishin të drejtën të deklaronin fitimet e pashpërndara për periudha të kaluara (për vitin 2017 e më parë) për të përfituar nga shkalla e re tatimore 8%, pavarësisht vonesës në deklarim sipas ndryshimeve ligjore të parashikuara me Ligjin nr.94/2018 ñPër disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar sipas të cilit është bërë ndryshimi në trajtimin fiskal për të ardhurën nga dividendi, sipas përcaktimit në nenin 38 ñDispozita kalimtareò, pika 9.
- Nisur nga ky lehtësim fiskal nga auditimi i deklaratës së pagesave rezulton se 98% e subjekteve kanë deklaruar dhe shpërndarë dividend nga periudha janar-shtator e vitit 2019.
-Pesha specifike në të ardhurat e arkëtuara dhe raportuara për zërin ñTatimi mbi të ardhurat nga Dividendët dhe Aksionetò është 52% e totalit të arkëtimeve nga të gjitha DRT-të ose rreth 5,7 miliard lekë nga 11 miliard lekë gjithsej të arkëtuara gjatë vitit 2019.
Kontribuesit më të mëdhenj, të cilët kanë deklaruar dhe shpërndarë tatim të mbajtur në burim për dividend me vlerë më shumë se 50 milon lekë, janë rreth 15 subjekte, të cilët përbëjnë rreth 64% të totalit të arkëtimeve nga dividend (Lista e subjekteve bashkangjitur në Aneksin nr.1/2, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

<u>Për vitin 2020</u>
- Nga 867 subjekte që kanë deklaruar tatim në burim 181 prej tyre ose rreth 21% e numrit gjithsej kanë deklaruar dividend për Rubrikën 8-1 ñTatimi mbi të ardhurat nga Dividendët dhe Aksionetò në shumën në shumën 940,775 mijë lekë dhe 45 subjekte ose 5% e numrit gjithsej kanë deklaruar për pagesë tatim në burim për Rubrikën 9-1 ñNdarjet e fitimitò në shumën 150,764 mijë lekë. Arkëtimet e raportuara në kodin buxhetor 7009100 ñTatimi mbi të ardhurat nga Dividendët dhe Aksionetò në shumën 1,154,591 mijë lekë.
Kontribuesit më të mëdhenj, të cilët kanë deklaruar dhe shpërndarë tatim të mbajtur në burim për dividend janë rreth 15 subjekte, të cilët përbëjnë rreth 47% të totalit të arkëtimeve nga

dividend (Lista e subjekteve bashkangjitur në Aneksin nr.1/4, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Tatimi i Mbledhshëm në Burim (TMB) për pagesat për qiratë e deklaratës së tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat.

Në vitin 2018: për pagesë në rubrikën {15-1} ñTMB Pagesat për qiratëò kanë deklaruar 598 tatimpagues në shumën 1,380,709 mijë lekë ku arkëtimet sipas Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetit në DTM e raportuara në kodin buxhetor 7000400 ñTatimi mbi të ardhurat nga qiratëò janë në shumën 1,237,359 mijë lekë.

Në vitin 2019: për pagesë në rubrikën {15-1} ñTMB Pagesat për qiratëò kanë deklaruar 613 tatimpagues në shumën 1,452,703 mijë lekë ku arkëtimet sipas Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetit në DTM e raportuara në kodin buxhetor 7000400 ñTatimi mbi të ardhurat nga qiratëò janë në shumën 1,157,768 mijë lekë.

- Krahasuar me vitin e mëparshëm del se kanë deklaruar më shumë si detyrim për pagesë nga qiratë 15 subjekte në vlerën 71,994,059 lekë, ndërsa arkëtuar më pak 79,590 mijëë lekë.

Në vitin 2020: për pagesë në rubrikën {15-1} ñTMB Pagesat për qiratëò kanë deklaruar 600 tatimpagues në shumën 1,323,986 mijë lekë, ku arkëtimet sipas Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetit në DTM e raportuara në kodin buxhetor 7000400 ñTatimi mbi të ardhurat nga qiratëò janë në shumën 1,150,281 mijë lekë.

- Krahasuar me vitin e mëparshëm del se kanë deklaruar më pak si detyrim për pagesë nga qiratë 13 subjekte në vlerën 128,716 mijë lekë, ndërsa arkëtuar më pak 2,740,053 lekë, kjo dhe për shkak të pandemisë Covid -19 ku u dhanë lehtësira fiskale ndaj tatimpaguesve.

Për periudhën e auditimit 2018,2019 dhe 2020 rreth 50% të totalit të TMB mbi të ardhurat nga qiratë për pagesat e zënë përafërsisht 20 tatimpaguesi (Lista e subjekteve bashkangjitur në Aneksin nr.1/5, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Kredia për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar është:

Përshkrimi / Data	31.12.2018	31.12.2019	31.12.2020
Kredia e TVSH	26,485,547,180	21,076,788,583	18,297,920,905

Burimi: DTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Kreditoret më të mëdhenj të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe përqindja e tyre ndaj totalit, paraqitet sipas subjekteve bashkangjitur në Aneksin nr.1/6 për vitin 2018, Aneksin nr.1/7 për vitin 2019 dhe Aneksin nr.1/8 për vitin 20120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Rimbursimi i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar në total gjatë vitit 2018-2019 dhe 2020 sqaruar me të detajuar në secilin vit të realizimit të buxhetit

000/ lekë

Përshkrimi	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Kredi tvsh	26,485,547	21,076,788	18,297,920
Rimbursim i kërkuar	12,563,004	20,403,184	7,795,797
Përqindja (kërkuar/Kredi TVSH)	47%	97%	42%
Rimbursim i miratuar	11,635,131	20,083,393	7,667,561
Përqindja (miratuar/kërkuar)	93%	98%	98%
Rimbursim i kryer	8,076,301	15,611,305	10,415,273
Përqindja (kryer/miratuar)	69%	78%	136%

Burimi: DTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Titulli i Gjetjes:	Mosrealizimi i të ardhurave sipas zërave kryesore të planit të të ardhurave, si dhe mungesa e kryerjes së analizave periodike sipas fushave kryesore të të ardhurave.

Situata	Nga auditimi mbi realizimin e planit të të ardhurave tatimore sipas shpërndarjes së miratuar nga DPT**, u konstatua se:** Të ardhurat e mbledhura nga administrata tatimore për vitin 2018 krahasuar me planifikimin janë realizuar në masën 100.4% ose 399,636 mijë lekë më tepër në terma bruto. Për vitin 2019 janë realizuar në masën 98.3% ose 1,638,763 mijë lekë më pak se plani Për vitin 2020 janë realizuar në masën 91,7% ose 8,031,479 mijë lekë më pak në plani. **Për vitin 2019**, të ardhurat të ñTatimit mbi Vlerën e Shtuarò janë programuar në masën 28,290,000 mijë lekë dhe rishikuar me ulje në 28,528,000 mijë lekë bazuar në shkresën me nr. 15125/1, datë 27.07.2019 dhe shkresën me nr. 20537/1, datë 08.10.2019 të DPT. Pavarësisht rishikimit, të ardhurave nga TVSH-ja rezultojnë të jenë arkëtuar në masën 23,995,919 mijë lekë ose me mosrealizim prej 15.9% ose -4,532,081 mijë lekë më pak se plani. **Për vitin 2020**, të ardhurat të ñTatimit mbi Vlerën e Shtuarò janë programuar në masën 32,000,000 mijë lekë dhe rishikuar me ulje në 27,500,000 mijë lekë bazuar në shkresën me nr. 15093, datë 06.08.2020 të DPT. Pavarësisht rishikimit, të ardhurave nga TVSH-ja rezultojnë të jenë arkëtuar në masën 23,782,177 mijë lekë ose me mosrealizim prej 13.5% ose 3,717,823 mijë lekë më pak se plani. Për vitin 2020, të ardhurat tatimore mbi Tatim fitimin janë programuar në masën 23,000,000 mijë lekë dhe rishikuar me ulje në 18,400,000 mijë lekë bazuar në shkresën me nr. 15093, datë 06.08.2020, duke marrë në konsideratë dhe situatën e shkaktuar nga pandemia Covid-19. Pavarësisht rishikimit, të ardhurat nga Tatim fitimi rezultojnë të jenë arkëtuar në masën 17,399,062 mijë lekë, ose me mosrealizim prej 5.4% ose 1,000,938 mijë lekë më pak se plani.
	Plani i miratuar nga DPT për zërin ñTë Ardhura personaleò nuk detajohet sipas llojit të të ardhurave personale, por në mënyrë sintetike i përcillet DTM për zbatim. Të dhënat e paraqitura nga Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit për vitet 2018, 2019 dhe 2020 janë thjesht evidenca statistikore. Nga Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit në DTM nuk është bërë një analizë e detajuar e të gjithë zërave të të ardhurave personale, për të gjetur arsyet e mosrealizimit të tyre (viti 2018 në masën 92.6% dhe 2020 në masën 92% pavarësisht se është bërë rishikimi me ulje gjatë vitit nga plani fillestar) dhe për të rritur performancën në mbledhjen e të ardhurave personale, në kundërshtim me Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore me nr.1482 prot,datë 27.02.2017 neni 12ò Funksionet e Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetitò.
Kriteri	Shkresa nr. 15125/1, datë 27.07.2019 Shkresa nr. 20537/1, datë 08.10.2019 Shkresa me nr. 15093, datë 06.08.2020 ñRregullorja e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendroreò miratuar me urdhrin nr.19, datë 22.02.2017 të ministrit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE).
Ndikimi/Efekti	Planifikim jo real, si rrjedhoje e mungesës së analizave të realizimit

	të zërave të të ardhurave.
Shkaku	Drejtoria e Analizës dhe të Kontabilitetit të të Ardhurave nuk bën një parashikim në lidhje me të ardhurat, Të dhënat e paraqitura nga kjo drejtori janë thjesht evidenca statistikore.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj të analizojë faktorët që ndikojnë në realizimin e planit të të ardhurave tatimore, sipas zërave dhe burimeve të disponueshme të tatimpaguesve që ajo administron dhe të paraqes ato në mënyrë të dokumentuar në DPT, për marrje në konsideratë nga ana e saj, në funksion të një shpërndarje sa më të drejtë dhe reale të planit të të ardhurave sipas llojit dhe strukturës, me qëllim që veprimtaria për ndjekjen dhe realizimin e të ardhurave për çdo zë të bëhet më efektive dhe eficente.

2.3. **Përputhshmëria ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor**:

2.3.1. Sektori i Kontrollit nga zyra dhe monitorimi.

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Të dhëna elektronike dhe fizike mbi të ardhurat tatimore për periudhën objekt auditimi.
- Dokumentacioni dhe informacioni elektronik i tatimpaguesve në sistemin C@ts.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Sektori i Kontrollit nga Zyra, si pjesë e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, ushtron detyrat e tij në zbatim të Manualit të Kontrollit nga Zyra, të miratuar nga DPT.

Detyrat e këtij sektori përfshijnë, por nuk kufizohen sipas pikës 4 të Manualit:

"4. Objekt i punës të kontrollit tatimor nga zyra:

- Analizon nëpërmjet raporteve të implementuar në sistem, nxjerr konkuzione përkatëse për situata të parregullta të deklaratave të ndryshme tatimore, tatimpaguesit me gjëndje të lartë e të vazhdushme kreditore tvsh, tatim fitimi, mosdeklarues për lloje të ndryshme tatimi, deklarusit pa veprimtari apo tatimpaguest që kanë ndërprerë deklarimin.

- Analizon dhe nxjerr konkluzione nëpërmjet kryqëzimit të librave të shitjes dhe të blerjes për deklarimin e faturave tatimore të shitjes apo bjerjes duke përcaktuar detyra për sistemime e rivlerësime të ndryshme tatimore kur është e nevojshme.

- Në zbatim të ligjit Nr.8438 datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr. 5 datë 30.01.2006 në zbatim të ligjit krijon në ulje apo në rritje, me kërkesë ose jo të tatimpaguesit plan të rishikuar të parapagimeve sipas modulit të krijimit të planeve të parapagimit të implementuar në sistem.

- Zbaton dhe hedh në sistem vendimet e apelimit tatimor dhe vendimet e formës së prerë te gjykatave në lidhje me detyrimet tatimore dhe penalitetet. Për detyrimin tatimor nëpërmjet rivlerësimit të deklaratave tatimorë sipas vendimeve përkatëse (Moduli i kontrollit nga zyra) dhe për anullimin e penaliteteve me modulin e anullimit të gjobave.

- Ndjekin proçedurat e përthithjes, ndarjes së tatimpaguesve, për transferimin e kredive të tatimeve të ndryshme nga një tatimpagues tek tjetri brënda një DRT-je apo në DRT-të të ndryshme.

- Kryen rimbursimin e tatimeve të ndryshme tatimore sipas këkesave të tatimpaguesve përveç TVSH-së.

- Ndjekin në çdo rast kryerjen e proçesit të kompensimit të detyrimeve të papaguara para kryerjes së rimbursimeve qoftë nga DPT-ja për TVSH-në, apo nga DRT-të të tatimeve të tjera, sipas manualeve të përdorimit të implementuara në sistemin informatik.

- Analizojnë dhe pregatisin planet e ndryshuara të parapagimeve sipas kërkesave të tatimpaguesve në zbatim të legjislacionit tatimor në fuqi gjatë gjithë vitit ushtrimor.
- Ndjek arketimin e detyrimeve tatimore të vetedeklaruara por të papaguara deri në kalimin e tyre ne borxh që duhet të mblidhet me force
- Ndjek nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit tatimpaguesit të cilet nuk kane deklaruar në afatin ligjor".
Numri i NIPTE-ve që administrohen nga inspektorët

Nr	Emri Mbiemri	Janar-qershor 2018	Korrik 2018-shkurt 2019	Mars 2019-shkurt 2020	Mars 2020-korrik 2020	Gusht 2020-dhjetor 2020
1	A. B.	145	98	92	174	121
2	A. Dh.	139	98			122
3	A. M.	134	98	93	175	121
4	A. K.	137	97	93	174	122
5	Gj. Sh.	138	98	94	172	121
6	A. N.		97	93		
7	P. M.		96	94		
8	M. G.			94	175	
9	O. B.			52		
10	A. Z.					121
11	A. Gj.					121
12	H. B.					35

Numri i subjekteve për inspektor është shumë i lartë, duke arritur numrin maksimal në mbi 170 subjekte për periudhën mars-korrik 2020, periudhë e cila përkon me kulmin e pandemisë Covid 19 dhe masave kufizuese të vendosura nga Qeveria Shqiptare. Nisur edhe nga madhësia dhe kompleksiteti i tatimpaguesve nën juridiksionin e kësaj DRT, numri kaq i lartë i subjekteve për inspektor, ndikon në mënyrë të pashmangshme edhe në cilësinë e punës së tyre.
Një fakt i tillë pranohet edhe nga vetë institucioni i DTM, i cili në Analizën Vjetore të vitit 2019, ka identifikuar si problematikë ñ*Fuqizimi i kontrollit nga zyra me shtimin e stafit në mënyrë që një inspektor të ketë kohën e duhur për të kryer kontrolle dhe verifikime nga zyra, për të dalë në konkluzione të plota dhe të sakta në lidhje me vlerësimin e riskut për çdo tatimpagues*ò.

Nga dokumentacioni dhe informacioni elektronik i vënë në dispozicion, për subjektet e përzgjedhura për auditim, kanë rezultuar mangësitë si më poshtë vijon:

- Deklarimi dhe realizimi sipas deklaratës së tatimit mbi të ardhurat personale, analiza sipas llojit dhe kontribuesve. Testimi i zonave me risk lidhur me mbledhjen e të ardhurave personale si tatimi mbi; qiratë dhe Dividendin si dhe aksionet.
Përcaktimi dhe detyrimi për llojet e të ardhurave personale të tatueshme bëhen referuar Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò i ndryshuar, Kreu II, Tatimi mbi të Ardhurat Personale, neni 7 ñShtrirja e detyrimitò: ñ1. *Individët rezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për të gjitha burimet e të ardhurave, sipas parashikimeve të këtij kreu. 2. Individët jorezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për burimet e të ardhurave, sipas parashikimeve të këtij kreu, të realizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë*ò dhe Neni 8 ñE ardhura e tatueshmeò, gërma a-h.
Deklarimi i detyrimit për tatimin në burim bëhet referuar Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 i ndryshuar, Kreu IV, Tatimi i Mbajtur në Burimin e të Ardhurave, neni 33 ñMbajtja në burim e tatimit mbi të ardhuratò pika 1 e cila përcakton se: ñ*Të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në*

burim nga shuma bruto e pagesave që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë", sipas shkallëve të përcaktuara pika1.1 me*15 për qind nga gërma a-ë dhe pika 1.2.* me *8 për qind nga gërma a-b.*[2]

- Dividendi është pjesë e fitimit që marrin aksionarët (pronarët e aksioneve) në fund të një viti financiar me vendim të mbledhjes së aksionarëve në një shumë jo më të lartë se ajo e propozuar nga bordi i drejtorëve të kompanisë. Vendimi që Dividendët do të paguhen merret në mbledhjen e përgjithshme të themeluesve. Duke marrë në konsdiderate ndryshimet në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 i ndryshuar me ligjin 94/2018, datë 03.12.2018 ñPër disa ndryshime e shtesa në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, indryshuar, sipas të cilit është bërë ndryshimi në trajtimin fiskal për të ardhurat nga Dividendi, ku ñ*Norma e tatimit mbi Dividendin në shkallën 8 % do të aplikohet edhe për fitimet e pashpërndara të realizuara në vitet 2018 e më parë, përfshirë rezervat dhe fitimet e kapitalizuara, me kusht që tatimi mbi Dividendin, që i përket fitimeve të pashpërndara të viteve 2017 e më parë, të paguhet brenda datës 30 shtator 2019, ndërsa tatimi mbi Dividendin për fitimin e vitit 2018 të paguhet brenda datës 20 gusht 2019*ò konsiderohet zë me risk dhe është analizuar më poshtë. Aksionerët për të paguar Dividend, marrin përsipër një detyrim tatimor për të ardhurat personale që ato sigurojnë me këtë rast, ndërsa për një fitim pas tatimit të pashpërndarë nuk sjell asnjë detyrim për aksionerët dhe në këtë mënyrë, ruajtja e fitimit pas tatimit, ndërkohë që krijon një fitim kapital për aksionerët, nuk krijon asnjë detyrim tatimor deri në momentin që vendoset të shpërndahet fitimi pas tatimit, pra është kjo një nga arsyet që shpjegon prirjen për mospagimin e vërtetë të Dividendëve.

Deklarimi Dividendit bëhet nëpërmjet ñFormulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhuratò, i cili përmban 12 rubrika të dedikuara për deklarimin e të ardhurave sipas llojit i miratuar me Udhëzimin nr.12 *datë 15.3.2019 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.5, datë 30.1.2006 "Për tatimin mbi të ardhura*tò, i ndryshuar. Bashkëlidhur këtij udhëzimi paraqitet ñ*Formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat*ò dhe udhëzuesi për mënyrën e plotësimit të formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat, sipas së cilit:

- Pika 4. Rubrika [8] Dividendët plotësohet me shumat e pagesave për Dividendët që i kryhen aksionerit/ve pas miratimit të rezultatit financiar dhe miratimit të destinimit të fitimit.
- Pika 5. Rubrika [9] Ndarjet e fitimit plotësohen me shumat e pagesave për ndarjet e fitimit që i kryhen ortakut pas miratimit të rezultatit financiar dhe miratimit të destinimit të fitimit.

Gjithashtu në rastet kur përfituesi i të ardhurave është rezident në një nga shtetet me të cilat vendi ynë ka nënshkruar një marrëveshje tatimore (në fuqi), trajtimi fiskal për çdo rast i referohet dispozitave të marrëveshjes tatimore. Rregullat lidhur me zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve tatimore ndërkombëtare përcaktohen në Udhëzimin nr.6 datë 10.02.2004 ñ*Për marrëveshjet bilaterale për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal*ò. Për të përfituar nga dispozitat e marrëveshjeve tatimore ndërkombëtare paguesi i shumës (tatimpaguesi rezident shqiptar) paraqet kërkesën për aplikim në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) në përputhje me pikën 4.3 b) të Udhëzimit të mësipërm, të shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar nga dispozitat e Udhëzimit nr.6, datë 10.02.2004 dhe në pikën 4.4 të Udhëzimit të mësipërm përcaktohet se Drejtoritë Rajonale Tatimore mund të zbatojnë dispozitat e marrëveshjeve tatimore vetëm pas marrjes së një shkrese zyrtare nga DPT, e cila duhet të bazohet në dispozitat konkrete të një marrëveshje që është në fuqisi dhe në pikën 4.5 Në rastet kur dispozitat e Marrëveshjes Tatimore bien në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit të brendshëm, dispozitat e Marrëveshjes kanë përparësi; Neni 15 ñDividendëtò é e drejta për tatimin e Dividendëve nuk i takon ekskluzivisht asnjërit shtet kontraktues, pra as vendit të rezidencës (ku është rezident individi ose personi juridik që i

[2] ligji 8438, datë 28.12.1998, ndryshuar me ligjin 94/2018 datë 21.12.2018.

përfiton Dividendët) as vendit të burimit ku krijohen Dividendët, pra ku është rezidente kompania që bën shpërndarjen e Dividendëve. E drejta tatimore në këtë rast ndahet midis dy shteteve kontraktuese;15.3 Kjo e drejtë kufizohet në një tarifë që bihet dakord midis shteteve kontraktuese (p.sh. 5% ose 10%), të shumës bruto të Dividendit që shpërndahet; Neni 11 ñInteresatò Edhe në këtë rast, e drejta tatimore ndahet midis të dy shteteve[3].

Të gjithë tatimpaguesit, që janë subjekt i tatimit mbi fitimin, pas pagimit të tij, brenda 6 mujorit të parë të çdo viti (brenda datës 30 Qershor), kanë detyrimin ligjor të miratojnë rezultatet financiare të vitit paraardhës. Po kështu këta tatimpagues, duhet të depozitojnë pranë organeve tatimore, deri në datën 31 Korrik, vendimin e organit kompetent vendimmarrës të shoqërisë për përdorimin e fitimit pas tatimit të vitit paraardhës. Në çdo rast të miratimit për shpërndarje të Dividendit, tatimi përkatës, duhet të derdhet nga shoqëria në favor të organit tatimor brenda afateve ligjore në fuqi referuar Ligjit nr.8438, dt.28.12.1998 ñPër Tatimin mbi të Ardhuratò i ndryshuar, nenit 33/1 pika 1 ku citohet: ñDepozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit, *Shoqëritë tregtare, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinojnë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë Dividendi*ò pika 2. *Shoqëritë tregtare, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të depozitojnë pranë organeve tatimore, jo më vonë se data 31 korrik e vitit kalendarik, vendimin e organit përgjegjës. Për paraqitjen me vonesë të këtij vendime zbatohet një gjobë prej 10,000 (dhjetë mijë) lekësh*[4]dhe pika 3. ñ*Personi juridik duhet të deklarojë dhe të paguajë për llogari të administratës tatimore tatimin mbi Dividendin e pagueshëm, sipas pikës 1, të këtij neni, jo më vonë se data 20 gusht e vitit kur bëhet miratimi i rezultateve, pavarësisht nëse është bërë ose jo shpërndarja e Dividendit*[5].

Në lidhje me auditimin për deklarimet periodike mbi llogaritjen dhe pagesën e tatimit në burim për Dividend**,** për të vlerësuar veprimtarinë e DTM-së për periudhën 2018, 2019 dhe vitit 2020 auditohen subjektet që kanë detyrimin ligjor për të paguar tatimin e mbajtur në burimin të të ardhurave për depozitimin e vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimin e fitimit të rezultateve financiare të vitit paraardhës 2017, 2018, 2019 nga shoqëritë tregtare, sipas Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998, neni 33/1 si më lart cituar.

<u>Për vitin 2019</u>

- Për 2 tatimpagues në shumën 4,011 mijë lekë kanë vijuar me aplikimin e normës tatimore mbi Dividendin në shkallën 8% për fitimet e pashpërndara të vitit 2017 e më parë, pas afatit të fundit të aplikimit që është data 30 shtator 2019, në kundërshtim me nenin 38 ñDispozita kalimtareò, pika 9 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 i ndryshuar.

Pas kësaj date çdo subjekt që do të deklarojë dhe paguajë tatim mbi të ardhurat nga Dividendi nga viti 2017 e më parë nuk është më i ñfavorizuarò nga shkalla tatimore 8%, por duhet të aplikojë shkallën tatimore standarde të asaj periudhe 15%. Duke iu referuar deklarimit dhe pagesës së tatimit në burim për Dividend sipas të dhënave në sistemin C@TS u bë identifikimi i të gjitha rasteve të deklaruara dhe paguara gjatë periudhës tetor-dhjetor 2019 dhe për tatimpaguesit që kanë kryer pagesa pas kësaj date është bërë llogaritja e detyrimit për

[3]Buletini i Udhëzimeve Teknike (Gusht 2016 ï Korrik 2017) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
[4] (Ndryshuar me Ligjin nr. 39/2018, dt. 09.07.2018. Botuar në FL.Z. nr. 134, dt. 18 shtator 2018).
[5](Ndryshuar me Ligjin nr. 83/2014, datë 17.07.2014).

diferencën prej 7% të tatimit mbi Dividendin. Në këto kushte tatimpaguesit penalizohen me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, sipas përcaktimit të kërkesave të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, Neni 117, ku përcaktohet se*: "Agjenti i mbajtjes së tatimit, agjenti i taksave apo ai i tarifave detyrohen të paguajnë gjobë, në masën e mëposhtme: b) Gjobë në masën 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës në rast se nuk mban tatimin në burim apo tatimin apo nuk mbledh taksën ose tarifën*ò.

Tabela nr.5*: Subjektet e penalizuara për pagesën e tatimit mbi Dividendin pas datës 30 shtator 2019.*

Lekë

Nr	Nipti	Subjekti	Datë pagesës	Shuma gjithsej që shpërndan si Dividend	Tatimi në burim Dividend i paguar (8 %)	Diferenca Tatim Burim Dividendi që duhet paguar nga llogaritja (7%)	Penaliteti 50%TB	Shuma e plotë e detyrimit për t'u paguar
1	J.	S.	29-Oct-19	50,000,000	2,898,000	3,500,000	1,750,000	5,250,000
1	J.	S.	31-Oct-19		1,102,000			
2	K.	A. C.	1-Oct-19	584,000	584,000	511,000	255,500	766,500
						4,011,000	2,005,500	6,016,500

Burimi: Databasë e TMB nga sistemi C@ts dhe përpunuar nga grupi i auditmit.

Tatimpaguesi A.I. me NIPT K. në vlerën 17,000,000 lekë për vitin 2019 dhe 9,344,073 lekë për vitin 2020 ka vendosur për shpërndarjen e fitimit pa u mbyllur viti financiar për pagesën e tatimit në burim mbi Dividendin e pagueshëm e cila është kryer në formë paradhënie, pra pa u miratuar pasqyrat financiare të vitit ushtrimor, përkatësisht:

- **Për vitin 2019** sipas Vendimit nr. 9, datë 01.08.2019 bazuar në pozicionin financiar të 6 mujorit të parë të vitit 2019 shpërndan një pjesë të Dividendit të vitit ushtrimor për periudhën tatimore ñ19/08ò (gusht 2019) në shumën 5,000 mijë lekë dhe tatim në burim 400 mijë lekë, data e pagesës 20.09.2019.
- Sipas Vendimit nr.10, datë 22.10.2019 bazuar në pozicionin financiar të 9 mujorit të parë të vitit 2019 dhe rritjes së të ardhurave të realizuara shpërndan një pjesë të Dividendit të vitit ushtrimor për periudhën tatimore 19/10 (tetor 2019) në shumën 12,000 mijë lekë dhe tatim në burim 960 mijë lekë, data e pagesës 19.11.2019.
-**Për vitin 2020** sipas Vendimit nr.13, datë 30.08.2020 bazuar në pozicionin financiar të 6 mujorit të parë të vitit 2020 dhe analizën e ecurisë së të ardhurave shpërndan një pjesë të Dividendit të vitit ushtrimor në shumën 9,344 mijë lekë dhe tatim në burim 747,526 lekë, data e pagesës 21.09.2020 (331,407 lekë) dhe datë 20.10.2020 (416,119 lekë).

Në gjykimin e audituesit: Dividendi është shpërndarja e fitimit pas tatimit për pronarët pas miratimit të rezultatit financiar. Pra Dividendi është i lidhur me fitimin, kjo në referencë të nenit 19 të Ligjit ñPër tatimin mbi të ardhuratò ñ*Fitimi i tatueshëm për periudhën tatimore përcaktohet në bazë të bilancit dhe të anekseve të tij, që duhet të jenë në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me dispozitat e këtij ligji, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Financave për këtë qëllim*. Në këtë kontekst Dividendi nuk mund të shkëputet nga momenti i miratimit të rezultatit financiar. Shoqëritë tregtare janë të detyruara sipas ligjit që fitimin e vitit paraardhës ta shpërndajnë brenda 6 mujorit të parë të vitit pasardhës sipas kërkesës dhe përcaktimit në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 i ndryshuar, neni 33/1, pika 1 dhe miratimi i pasqyrave financiare dhe i rezultatit financiar bëhet vetëm një herë në vit.

Këtu duhet vijuar me pasojat që ka sjellë pagesa paradhënie e dividendit, duke krahasuar shumen e paguar me ate sipas vendimit dhe bilancit, si dhe përgjegjësinë e inspektorëve për një vperim të tillë.

- Evidentohen situata të parregullta ku 15 tatimpagues në shumën 2,312,016 mijë lekë kanë deklaruar/paguar herë më shumë, herë më pak duke kompesuar pagesën në muajt e tjerë më pas apo kanë paguar pa patur detyrim për të paguar tatimin në burim për Dividend për atë muaj, gjë e cila tregon se tatimpaguesit nuk kanë deklaruar e paguar korrekt tatimin në burim për Dividend sipas periudhës së cilës të jetë depozituar Vendimi i Asamblesë/Ortakut në organet tatimore siç e përcakton neni 33/1 ñDepozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit, pika 1 e Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar, me pasoja në mungesën e të ardhurave në buxhetin e shtetit.

<u>Viti 2020</u>

Nga auditimi i të dhënave mbi deklarimin dhe arkëtimet për tatimin në burim për Dividend, konstatohet se 36 subjekte me vlerë rreth 72 milionë lekë kanë vijuar me deklarimin dhe pagesën për ñTatimin mbi të ardhurat nga Dividendët dhe Aksionetò për shpërndarjen e fitimit të vitit 2019 jashtë afatit ligjor të përcaktuar që është, jo më vonë se data 20 gusht, e vitit kur bëhet miratimi i rezultateve financiare, pra i vitit 2019, pavarësisht nëse është bërë ose jo shpërndarja e Dividendit, pas afatit ligjor 20 gusht 2020, siç përcaktohet me Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 i ndryshuar, neni 33/1 pika 3, për të cilat sistemi ka gjeneruar automatikisht gjobë e kamatëvonesë.

Titulli gjetjes:	**Zbritja e TVSH-së për blerjet e kryera nga tatimpaguesi "I. E.", për periudhën para së të miratohej leja e ndërtimit.**
Situata:	Nga auditimi i dokumentacioni dhe informacionit të vënë në dispozicion për këtë tatimpagues konstatohet se: - Sipas Ekstraktit historik, objekti i veprimtarisë është: ñ*Ndertimi, administrimi, operimi dhe transferimi i impiantit te trajtimit te mbetjeve ne Tiranë dhe prodhimi i energjise per autoritetin kontraktues, duke perfshire financimin, ndertimin, venien ne pune, furnizimin, transmetimin, shperndarjen, shitjen dhe eksportin e energjise elektrike ne kete kontrate koncesioni si dhe çdo lloj tjeter aktiviteti tregtar qe lidhet dhe ushtrohet sipas kesaj kontrate, gjithashtu dhe çdo aktivitet tjeter qe kontribuon ne zhvillimin dhe administrimin e projektit*ò. - Në mbledhjen e datës **27.02.2019**, Këshilli Kombëtar i Territorit ka miratuar **Lejen e Ndërtimit** për objektin: ñ*Ndërtimi i Landfillit, Inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë*ò, vendim të cilin nuk e ka të zbardhur në faqen zyrtare të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (http://www.azht.gov.al). Sipas ñRaportit Paraprak të Përmbledhur 2019 ñPerformanca e Kontratave të Koncesioneve/Partneritetit Publik Privatò, Nëntor 2019, të publikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përcaktohet që: ñ*Ndërtimi i Inceneratorit - Lidhur me këtë tregues raportohet mbi mosrealizimin e tij për shkak* ***të lejes së ndërtimit, e cila ende nuk është marrë****, ndërkohë që dokumentacioni është dorëzuar*ò. Sipas ñRaportit Paraprak të Përmbledhur Maj 2020 ñPerformanca e Kontratave të Koncesioneve/Partneritetit Publik Privatò, të publikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përcaktohet që: ñ*Sasia e përpunuar e mbetjeve nga ndërtimi i inceneratorit- E parealizuar pasi është bërë me vonesë kalimi pastaj* ***zbardhja e Vendimit të KKT për miratimin e lejes së ndërtimit të landfillit****, Inceneratorit dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese me vendndodhje në Bashkinë Tiranë*ò. Në sistemin C@ts, në pjesën ñDokumenteò, subjekti nuk e ka ngarkuar Lejen e Ndërtimit. - Detyrimi i tatimpaguesit më datë 31.12.2020, është në vlerën 153,176,831 lekë, i cili i ndarë sipas llojit përbëhet nga: o Tatim mbi fitimin në vlerën 50,194,406 lekë; o Tatimi mbi Vlerën e Shtuar në vlerën 91,549,063 lekë; o Gjobë Pagesë e Vonuar në vlerën dhe Deklarim i Vonuar në vlerën 7,502,327

	lekë; o Kamatë vonesa (Interesa) në vlerën 3,931,035 lekë. - Pagesa të përfituara nga Thesari për periudhën 01.10.2020-31.12.2020, janë në vlerën 300,010,100 lekë. - Me anë të Urdhrit të DTM nr. 8314, datë 23.10.2020 është vendosur bllokimi i llogarive bankare në vlerën 144,492,087 lekë, si masë shtrënguese për mospagimin e detyrimeve ndaj DTM-së. - Transferuar në DTM më datë 16.03.2019, nga DRT Tiranë. - Inspektori nga zyra për periudhën objekt auditimi: M. G. dhe P. K. - Ky subjekt nuk është kontrolluar nga Sektori i Kontrollit në Vend. - Ky subjekt nuk është trajtuar nga Sektori i Analizës së Riskut. - Për këtë subjekt, nga Sektori i Kontrollit nga Zyra, nuk ka shprehur asnjë rezervë në lidhje me çështje e TVSH-së. Leja për këtë subjekt është miratuar më datë 27.02.2019. Sipas ekstraktit të QKB, veprimtaria e këtij subjekti është vetëm për Landfillin e Sharrës. Për blerjet e kryera para miratimit të lejes së ndërtimit, ky tatimpagues, ka zbritur TVSH në vlerë 24,757,624 lekë për importe të mallrave/ investimeve më shkallë 20%, në vlerën 194,102,412 lekë për blerje nga furnitorët vendas me shkallë 20%, në vlerën 2,270,082 lekë për blerje të investimeve nga furnitorët vendas me shkallë 20%, si dhe në vlerën 258,438,611 lekë për Autongarkesë TVSH në blerje. Zbritja e TVSH-së për blerjet e kryera nga tatimpaguesi ñI. E.ò, për periudhën para së të miratohej leja e ndërtimit, sipas Aneksit nr. 2/1 bashkëngjitur RPA, është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 6, datë 30.01.2015 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 20, pika 8, gërma d, e cila përcakton që: ñ*Për shkeljet e konstatuara në rastin kur përgjegjës për TVSH-në është personi i tatueshëm blerës nëpërmjet "autongarkesës së TVSH-së", aplikohen dënimet si më poshtë:c) Me gjobë, në përputhje me pikën 1, të nenit 128, të këtij ligji, kur ky person ka lëshuar faturë tatimore jo në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligjin për TVSH-në. Neni 128 "Tatimpaguesi, që lëshon faturë tatimore të pasaktë e që rezulton me ulje të detyrimit apo rritje të shumës për t'u rimbursuar, dënohet me gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së efektit në ulje të detyrimit tatimor, përveç detyrimeve tatimore dhe interesave të llogaritura në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjeve specifike tatimore".* subjekti penalizohet me 0.06*365 ditë të shumës së efektit në ulje të detyrimit tatimor, për autongarkesat në vlerën 129,219,306 lekë dhe të nenit 115, me 0.06*365 ditë të shumës për furnizimet e furnitorëve vendas, investimeve dhe importeve në vlerën 48,427,496 lekë. Për furnizimet e furnitorëve vendas, investimeve dhe importeve, në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 115, i cili përcakton se... ñ*Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike".*
Kriteri:	Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 128/1, gërma ñcò, neni 115. Ligjin nr. 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 6, datë 30.01.2015 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 20, pika 8, gërma d.
Ndikimi:	Zbritja e TVSH-së për blerjet e kryera nga tatimpaguesi, në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 6, datë 30.01.2015 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, kanë sjellë për pasojë që subjekti të përfitojë padrejtësisht zbritje të TVSH në mënyrë të kundërligjeshme.
Shkaku:	Nga ana e DTM nuk është realizuar kontroll nga Sektori i Kontrollit në Vend, si dhe nuk

	është trajtuar nga Sektori i Analizës së Riskutô.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Tatimpagesve të Mëdhenj, pasi të ketë analizuar veprimet e konstatuara nga KLSH dhe nxjerrë përgjegjësitë konkrete, të marrë masa të menjëhershme për rregullimin e situatës dhe pas verifikimeve paraprake të tatimpaguesit ñI. E.ò, të bëjë propozimet përkatëse në DPT, për kryerjen e kontrollit të thelluar për këtë tatimpagues.

Rubrika [15] Pagesat për qiratë plotësohet me shumën e pagesave që kryhen për qiramarrjen e pasurive të luajtshme/paluajtshme.

Informacioni i përpunuar për periudhën e auditimit është bërë duke u mbështetur në të dhënat e vëna në dispozicion nga sistemi C@TS për deklarimin për pagesë të tatimit të mbajtur në burim nga qiratë, Rubrika{15-1}, nga verifikimi i kryer i kontratave të qerasë që tatimpaguesi ka riregjistruar në sistemin e-filling, nga verifikimi i adresave në ekstraktin historik të tatimpaguesve të bëra në faqen e QKB-së si dhe nga të dhënat nga sistemi C@TS të arkëtimeve sipas kodit buxhetor 7000400 ñTatim mbi të ardhura nga qiratëò. Referuar Rregullores së Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore, miratuar me Urdhër nr. 19, datë 22.02.2017 neni 26 ñDetyrat e inspektorit të kontrollit nga zyraò, pika 6 citon se ò*Bën shqyrtim formal të pasqyrave financiare bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat*ò, pika 9. ò*Mban në mbikëqyrje dhe analizon situatat e tatimpaguesve mbi treguesit financiar të realizuar dhe ecurinë e tyre, si edhe Manuali i Kontrollit nga Zyra përfaqëson një instrument të detyrueshëm pune i cili duhet të ndiqet nga të gjithë inspektorët e kontrollit nga zyra dhe njëkohësisht i udhëzon për të gjitha hapat që duhen ndjekur për kryerjen me sukses të një kontrolli nga zyra*. Edhe ndjekja kontratave të qirasë është përcaktuar qartë që me pranimin e pasqyrave financiare, sipas së cilit: Procedura e pranimit të pasqyrave financiare

- Pasqyrat financiare, vendimi i ortakut dhe gjithë dokumentacioni shoqërues do të deklarohen on-line në sistemin tatimor C@TS, konform ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëñ, i ndryshuar;
- Proçedura e verifikimit të pasqyrave financiare: Kryejnë verifikimin e pasqyrave financiare të dorëzuara të cilat janë. Kontratat e qirasë, për subjekte që ushtrojnë aktivitetin në ambiente të marra me qira; Procedura e shqyrtimit të treguesve të pasqyrave financiare dhe analiza: Verifikimi i detyrimeve tatimore të mbartura nga vitet paraardhës, të atyre të llogaritura dhe të derdhura për periudhën ushtrimore të mbyllur, si dhe krahasimi i tyre me gjendjet në fund të periudhave tatimore (31.12.) për çdo lloj tatim apo taksë (TVSH, kontribute dhe TAP për t`u paguar në 31 Dhjetor, teprica e tatim fitimit etj.), si dhe pika 9. ñ*Kalendari i punëve për strukturat e sektorit të kontrollit nga zyra në Prill, harton e miraton planin e kontrollit, verifikimit e pranimit të pasqyrave financiare për periudhën dy mujore në vazhdim, me objektivin që kontrolli dhe verifikimi të përfundojnë brenda 2 muajve nga data e dorëzimit të pasqyrave financiare dhe deklaratës së pagesës së tatimit mbi fitimin për vitin e kaluar. Kontrollon deklarimin e dokumenteve shoqëruese të pasqyrave financiare, evidenton dhe monitoron tatimpaguesit të cilët kanë vetë deklaruar detyrime tatimore por nuk i kanë paguar ato dhe ndërmerr çdo veprim të mundshëm për mbledhjen e detyrimeve për të mos lejuar që ato të kthehen në borxhe të papaguara*ò. Gjithashtu në faqen zyrtare të DPT-së për çdo vit publikohet dokumentacioni shtesë i kërkuar në bazë të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 60, dhe të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, i cili do të dorëzohet elektronikisht së bashku me pasqyrat financiare dhe është:

- Kontrata e qirasë për ambientet e marra me qira apo vërtetimin e pronësisë për objektin;

- Gjendja e inventarit të mallrave për shitje (analitik); Inventari i mjeteve të transportit në pronësi;
- Pasqyra e aktiveve afatgjata material (Ndërtesa).

Do të dorëzohen elektronikisht vetëm në version PDF (të skanuara), aneksi për shpjegimet sqaruese, raporti i ekspertit të autorizuar të shoqërisë, kontratat e qerasë për ambientet e marra me qira dhe vërtetimi i pronësisë për objektet në pronësi. Tatimpaguesi pas ngarkimit elektronikisht në format PDF të kontratave të qerasë bën përditësimin e NIPTeve, adresave sekondare në QKB dhe përgjegjësi i sektorit të regjistrimit ndjek përditësimin e regjistrit elektronik të tatimpaguesit aktiv. Baza e Regjistrit elektronik të tatimpaguesve, bazuar zhvillimeve teknike në fushën e TI, është transmetimi dhe pasqyrimi i të dhënave të tatimpaguesit nga Regjistri i QKB-së në Regjistrin e DRT-së. Të gjitha të dhënat që kanë lidhje dhe interes për DPT transmetohen në mënyrë elektronike nga Sistemi i QKB-së në atë të DRT-së nëpërmjet rregullave të përcaktuara midis dy institucioneve në Protokollin e Komunikimit Elektronik. Ky protokoll është i hartuar në gjuhë teknike nga Drejtoria e TI dhe realizimi i tij mbikëqyret në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve. Për të audituar saktësinë e plotësimit të tatimit në burim mbi të ardhurat nga qiraja si dhe e shkallës tatimore të aplikuar janë marrë në auditim subjektet që kanë detyrimin ligjor për të paguar tatimin e mbajtur në burimin nga marrja e objekteve të ndryshme me qira ku ushtrojnë aktivitetin e biznesit.

Detyrimi ligjor për dorëzimin e kontratave të qirasë përcaktohet edhe në Vendimin Nr. 953, datë 29.12.2014 Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Nr. 92/2014ñ*Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, neni 6 Modalitetet dhe rregullat e ushtrimit të së drejtës për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për qiradhënien e ndërtesës pika 2. *Për aplikimin e së drejtës së zgjedhjes është kriter domosdoshmëria e një kontrate noteriale midis qiradhënësit dhe qiramarrësit, në të cilën duhet të jetë shprehur qartë se palët bien dakord se qiradhënien do ta trajtojnë si furnizim të tatueshëm me TVSH. Personi i tatueshëm qiradhënës duhet të depozitojë, përveç deklaratës edhe kontratën e qirasë. Mungesa e kontratës së qirasë nuk i jep të drejtën e trajtimit të qiradhënies si furnizim i tatuesh*ëm si dhe në Udhëzimin Nr.5, datë 30.01.2006 ñ*Për Tatimin mbi të ardhurat"*, i ndryshuar Mbajtja e Dokumentacionit pika 2.8.6.1 *Për çdo të ardhur të deklaruar në deklaratën individuale vjetore të të ardhurave, individi tatimpagues në rast të një kërkese nga organit tatimor, duhet t'i paraqesë të këtij të fundit, dokumentacionin, si më poshtë: për të ardhurat bruto nga qiraja kopje të kontratës së qirasë dhe të dokumentit që vërteton pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja.*

Bazuar në të dhënat mbi deklarimet periodike të kryera mbi llogaritjen dhe pagesën e tatimit në burim, nga subjektet tatimpagues për tatimin e mbajtur në burim, nga marrja e objekteve të ndryshme me qira dhe të kontratave të dorëzuara pranë organit tatimor, referuar bazës ligjore të sipër cituar, konstatohet se:

Në DTM mungonte regjistri i subjekteve në të cilën të përcaktohet dhe lloji i pagesës sipas kontratës së lidhur midis palëve (mujore; 6 mujore apo vjetore) të cilat kanë zhvilluar aktivitet në objekte me qira ose në objekte në pronësi të tyre të vërtetuara me certifikata pronësie për vitin 2018, 2019, dhe vitin 2020, ndërsa nga ana e tatimpaguesit ato janë të regjistruara nëpërmjet sistemit e-Filing në format PDF. Duke qenë se pagesa e qirasë është përcaktuar për tu paguar për çdo muaj; 6-muaj ose vjetore rrjedhimisht edhe tatimi mbi të ardhurat në burim duhet likuiduar në bazë të kontratës në llogaritë e organeve tatimore deri në datën 20 të muajit pasardhës të muajit të pagesës së këstit të qerasë. Ky detyrim ligjor përcaktohet në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò i ndryshuar, neni 33*"Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat" gërma "ë", "pagesat për qiratë"* dhe neni 35 ñMbajtja e tatimit në burim, regjistrimi, deklarimi dhe pagesa ò, në bazë të Ligjit nr.

9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", neni 60, si më lart cituar.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për pagesat e kryera gjatë periudhës së auditimit nga subjektet tatimpagues për tatimin e mbajtur në burim, nga marrja e objekteve të ndryshme me qira dhe të kontratave të dorëzuar në DTM, të përzgjedhura në mënyrë rastësore konstatohet se:
- Për 4 tatimpagues në shumën 1,395,702 lekë nga DTM nuk është vepruar për të mbledhur dhe penalizuar për llogari të organeve tatimore që gjatë vitit 2018, 2019 dhe vitin 2020 kanë ushtruar veprimtari ekonomike në objekte apo terrene të kontraktuara me qira, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ñ*Për Tatimin mbi të Ardhurat*ò i ndryshuar, ñPagesat për qiratëò dhe neni 35 ñMbajtja e tatimit në burim, regjistrimi, deklarimi dhe pagesa, Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 ñPër tatimin mbi të ardhuratò i ndryshuar, pika 2.3.6, konkretisht:
1. Tatimpaguesi I. C. me NIPT K.:
- Sipas Kontratës së qirasë për një periudhë 5 vjeçare me qira mujore 30,000 lekë/muaj në adresën Rr.Onhezmi (lagja nr.3) Sarandë, datë fillimi 16.03.2015 dhe datë përfundimi 16.03.2020, si dhe nga verifikimi i bërë me ekstraktin historik del regjistruar në QKB me numër çështje: CN-021290-04-15 ka ndërprerë kontratën me marrëveshje dy paleshë në datë 01.09.2019, por nuk rezulton të jetë hedhur nga tatimpaguesi ndryshimi i kontratës në sistemin informatik dhe në QKB. Ndaj tatimpaguesit është llogaritur detyrimi i plotë nga data 01.09.2019 deri 16.03.2020 dhe penaliteti sipas përcaktimit në kërkesat e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 117, pika b (detyrim 29,250 lekë + gjobë 14,625 lekë). (Ky tatimpagues është transferuar në DTM në datë 03.03.2020).
-Sipas Kontratës së qirasë lidhur për një periudhë 8 vjeçare, me qira mujore 50,000 lekë/muaj në adresën Rr.Onhezmi, (lagja nr.3) Sarandë, datë fillimi 01.04.2017 dhe datë përfundimi 01.04.2025 e ka ndërprerë në datë 14.09.2019, por nuk rezulton të jetë bërë ndryshimi i kontratës nga tatimpaguesi në sistemin informatik dhe QKB. Ndaj tatimpaguesit është llogaritur detyrimi i plotë nga data 01.09.2019 deri 30.09.2020 dhe penaliteti sipas përcaktimit në kërkesat e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, neni 117, pika b (detyrim 97,500lekë + gjobë 48,750 lekë).
2. Tatimpaguesi A.- Z.S. SHPK me NIPT K... sipas Kontratës së qirasë lidhur për një periudhë 1 vjeçare, me qira mujore 176,000 lekë/muaj në adresën Rruga Fadil Rada Tiranë, datë fillimi 10.01.2019 dhe datë përfundimi 30.06.2020 ka bërë amendim kontrate datë 31.3.2020 vetëm për muajin prill e maj të vitit 2020 pagesa do jetë për 58,824 lekë/muaj, kjo për shkak të masave shtrënguese të marra nga qeveria për parandalimin e Covid 19. Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin informatik nuk rezulton të jetë hedhur nga tatimpaguesi ndryshimi i kontratës. Nga shqyrtimi i deklaratave të dorëzuara del se tatimpaguesi gjatë kësaj periudhe ka ushtruar aktivitet dhe ka dorëzuar deklarata të TMB dhe të tvsh-së dhe se Kontrata e qerasë dhe amendimi i saj nuk janë noteriale, por janë nënshkruar nga i njëjti person në cilësinë si individ (qiradhënës) dhe shoqëri (qiramarrës). Në nenin 9 të Kontratës Ndryshimet dhe shtesat në kontratë, pika 1 citon*: Ndryshimet ose shtesat e kësaj kontrate janë të vlefshme vetëm në rast se bëhen me shkrim përpara noterit dhe nënshkruhen nga të dyja palët*. Referuar edhe Aktit Normativ Nr. 12, datë 2.4.2020 Për një shtesë në Aktin Normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, ñPër marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19ò, të ndryshuar Neni 1 citon: *Të gjithë qiramarrësit persona fizikë/juridikë me të ardhura deri në 14 000 000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë në vit, të cilët kanë kontratë noteriale qiraje për zhvillimin e aktivitetit të tyre ekonomik, të nënshkruar përpara shpalljes së gjendjes së*

epidemisë, dhe e kanë ndaluar aktivitetin si pasojë e gjendjes së shkaktuar nga COVID–19, nuk do ta paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, prill dhe maj 2020. Detyrimi i prapambetur i këtyre dy muajve do të paguhet nga qiramarrësi, në mënyrë proporcionale dhe të dakordësuar me qiradhënësin, pas muajit maj 2020. Për ato kontrata që përfundojnë përpara afatit 31 maj 2020, detyrimi i prapambetur do të paguhet nga qiramarrësi brenda tre muajve pas datës 31 maj 2020, pra shoqëria nuk është përfitues këtij lehtësimi dhe si rrjedhim duhet të paguajë të plotë detyrimin e tatimit në burim për pagesë të qerasë për muajin prill, maj 2020 .Ndaj tatimpaguesit është llogaritur detyrimi i plotë për muajin prill-maj 2020 dhe penaliteti sipas përcaktimit në kërkesat e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, Neni 117, pika b (detyrim 35,153lekë + gjobë 17,576lekë).

3. Tatimpaguesi ñA. M. S.ò me NIPT K. sipas Kontratës së qerasë lidhur për një periudhë 5 vjeçare, me qera mujore 23,529.41 euro/muaj në adresën Lagja Skënderbeu, Durrës godina e quajtur Qendra Kristal me datë fillimi 06.04.2016 dhe datë përfundimi 05.04.2021 për periudhën Prill-Maj-Qershor 2020 ka paguar gjysmën e pagesës së qerasë për shkak të pandemisë. Nga inspektori u paraqet amendim kontratës datë 20.03.2020 i cili është i panoterizuar, ndërsa kontrata e lidhur është e noterizuar dhe me të drejtë rinovimi automatikisht një vit. Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin informatik nuk rezulton të jetë hedhur nga tatimpaguesi ndryshimi i kontratës. Nga verifikimi ë sistemin informatik rezulton se shoqëria ka dorëzuar deklaratën e pagesës së TVSH-së për muajt Prill, Maj Qershor 2020, çka tregon se kjo shoqëri ka punuar. Referuar edhe Aktit Normativ Nr. 12, datë 2.4.2020 Për një shtesë në Aktin Normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, ñ*Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19*ò, të ndryshuar Neni 1 të sipërcituar, pra shoqëria nuk është përfitues këtij lehtësimi dhe si rrjedhim duhet të paguajë të plotë detyrimin e tatimit në burim për pagesë të qerasë për muajin prill, maj, qershor 2020 dhe penalitet sipas përcaktimit në kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, Neni 117, pika b (detyrim 651,176 lekë + gjobë 325,588 lekë).

4. Tatimpaguesi ñM.C.I.ò me NIPT J. sipas Kontratës së qerasë lidhur për një periudhë 4 vjeçare, me të drejtë rinovimi me qira mujore 1,400 euro/muaj apartament në adresën Rruga ñIbrahim Rrugovaò Tiranë, datë fillimi 06.01.2017 dhe datë përfundimi 06.01.2021 ka ndërprerë kontratën me marrëveshje dypalëshe në datë 28.08.2018, por nuk rezulton të jetë hedhur nga tatimpaguesi ndryshimi i kontratës në sistemin informatik dhe në QKB. Nuk është ngarkuar në sistemin informatik me dokumentet shoqëruese të pasqyrave financiare të vitit 2019 dhe as me dokumente të tjera kontrata e qerasë dhe revokimi i saj. Ndaj tatimpaguesit është llogaritur detyrimi i plotë nga data 01.01.2018 deri 30.09.2020 dhe penaliteti sipas përcaktimit në kërkesat e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, Neni 117, pika b (detyrim 283,500 lekë + gjobë 141,750 lekë).

Tabela nr. 6*: Subjektet me detyrime për Tatimin e mbajtur në burim mbi të ardhurat nga qiratë*

Subjekti Qeramarrës		Data		Vlera	Deklaruar e paguar		Sa duhet		Diferenca			
Emri	Nipt	Fillimit	Mbarimit	mujore qerasë	Shuma e qerasë	Tatimi në burim	Shuma e qerasë	TMB pagesë për qera	Shuma e qerasë	Tatimi në burim	Penalitet sipas Nenit 126	Total për t'u paguar
I. C.	K.	16.03.2015	16.03.2020	30,000	240,000	36,000	435,000	65,250	195,000	29,250	14,625	43,875
I. C.	K.	01.04.2017	01.04.2025	50,000	400,000	60,000	1,050,000	157,500	200,000	97,500	48,750	146,250
A.-Z.	K.	10.01.2019	30.06.2020	176,000	821,648	123,247	1,056,000	158,400	234,352	35,153	17,576	52,729
A. M. S.	K.	06.04.2016	05.04.2021	23529.41E	21,705,881	3,255,882	26,047,057	3,907,059	4,341,176	651,176	325,588	976,765
M. C. I.	J.	06.01.2017	6.01.2021	1400E	4,347,000	652,050	6,237,000	935,550	1,890,000	283,500	141,750	425,250
Total										**1,096,579**	**548,289**	**1,644,869**

Burimi i të dhënave: Databasë e TMB nga sistemi C@ts dhe përpunuar nga grupi i auditimit.

Titulli i gjetjes:	**Mangësitë në monitorimin e deklaratave të tatimit të mbajtur në burim nga ana e sektorit të kontrollit nga zyra pranë DTM-së.**

Situata:	1.Nga auditimi i të dhënave në lidhje me deklarimin nga tatimpaguesit për TMB për rubrikën {9-1} ñNdarje e fitimitò dhe rubrikën {8-1}TMB ñDividendò me kod buxhetor 7009100 **"**Tatimi mbi të ardhurat nga ñDividendët dhe Aksionetò konstatohet se: Deklarimet dhe arkëtimeve e realizuara nga tatimpaguesit për fitimet e pashpërndara për periudha të kaluara (për vitin 2017 e më parë), tatimpaguesi S. në vlerën 3,500,000 lekë dhe A. C. në vlerën 511,00 lekë kanë vijuar me aplikimin e normës tatimore mbi Dividendin në shkallën 8% për fitimet e pashpërndara të vitit 2017 e më parë edhe pas afatit të fundit të aplikimit që është data 30 shtator 2019, në kundërshtim me nenin 38 ñDispozita kalimtareò, pika 9 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ñ*Për tatimin mbi të ardhurat*ò, i ndryshuar. pika 9 ñ*Pas kësaj date çdo subjekt që do të deklarojë dhe paguajë tatim mbi të ardhurat nga Dividendi nga viti 2017 e më parë nuk është më i "favorizuar" nga shkalla tatimore 8%, por duhet të aplikojë shkallën tatimore standarde të asaj periudhe 15%*ò. Në këto kushte tatimpaguesit penalizohen me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, sipas përcaktimit të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar Neni 117, ñDënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave*"*. **Në total shuma e detyrimit për t'u paguar është në vlerën 6,016,500 lekë.** Nga auditimi i deklarimeve dhe arkëtimeve të realizuara nga tatimpaguesit për Tatimi mbi të ardhurat nga Dividendët dhe Aksionetò u konstatua: Tatimpaguesi A.I. me NIPT K. në vlerën 17,000,000 lekë për vitin 2019 dhe 9,344,073 lekë për vitin 2020 ka vendosur për shpërndarjen e fitimit pa u mbyllur viti financiar për pagesën e tatimit në burim mbi Dividendin e pagueshëm e cila është kryer në formë paradhënie, pra pa u miratuar pasqyrat financiare të vitit ushtrimor. Dividendi është i lidhur me fitimin dhe po ti referohemi nenit 19 të Ligjit ñPër tatimin mbi të ardhuratò ñFitimi i tatueshëm për periudhën tatimore përcaktohet në bazë të bilancit dhe të anekseve të tij, që duhet të jenë në përputhje me ligjin ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me dispozitat e këtij ligji, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Financave për këtë qëllim. Në këtë kontekst Dividendi nuk mund të shkëputet nga momenti i miratimit të rezultatit financiar. Shoqëritë tregtare janë të detyruara sipas ligjit që fitimin e vitit paraardhës ta shpërndajnë brenda 6 mujorit të parë të vitit pasardhës sipas kërkesës dhe përcaktimit në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër Tatimin mbi të Ardhuratò i ndryshuar, neni 33/1, pika 1 dhe miratimi i pasqyrave financiare dhe i rezultatit financiar bëhet vetëm një herë në vit. - Evidentohen situata të parregullta ku 16 tatimpagues në shumën 2,318,572 mijë lekë kanë deklaruar/paguar herë më shumë, herë më pak duke kompesuar pagesën në muajt e tjerë më pas apo kanë paguar pa patur detyrim për të paguar tatimin në burim për Dividend për atë muaj, gjë e cila tregon se tatimpaguesit nuk kanë deklaruar e paguar korrekt tatimin në burim për Dividend sipas periudhës së cilës të jetë depozituar Vendimi i Asamblesë/Ortakut në organet tatimore, siç e përcakton neni 33/1 ñDepozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit, pika 1e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar.
	2.Nga auditimi u konstatua se në DTM mungonte regjistri i subjekteve në të cilën të përcaktohet lloji i pagesës sipas kontratës së lidhur midis palëve (mujore; 6 mujore apo vjetore), të cilat kanë zhvilluar aktivitet në objekte me qira ose në objekte në pronësi të tyre të vërtetuara me certifikata pronësie për vitin 2018, 2019 dhe 2020, sipas përcaktimit në nenin 33*"Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat" gërma "ë", "pagesat për qiratë"* dhe nenin 35 ñMbajtja e tatimit në burim, regjistrimi, deklarimi dhe pagesa ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër Tatimin mbi të Ardhuratò, i ndryshuar, të Manualit të Kontrollit nga Zyra pika ñProcedura e pranimit, e verifikimit dhe shqyrtimit të

	treguesve të pasqyrave financiare dhe analizaò, si dhe të faqes zyrtare të DPT-së, ku çdo vit publikohet dokumentacioni shtesë i kërkuar në bazë të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, neni 60, dhe të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se ñKontrata e qerasë për ambientet e marra me qira apo vërtetimin e pronësisë për objektin do të dorëzohet elektronikisht së bashku me pasqyrat financiareò. Sa më sipër u konstatua se, për 4 tatimpagues në shumën 1,096,579 lekë nga DTM nuk është vepruar për të mbledhur detyrimet e TMB nga qiratë për llogari të organeve tatimore që gjatë vitit 2018, 2019 dhe 2020, të cilat kanë ushtruar veprimtari ekonomike në objekte apo terrene të kontraktuara me qira, në kundërshtim me kërkesat e nenit 35 ñMbajtja e tatimit në burim, regjistrimi, deklarimi dhe pagesaò të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ñ*Për Tatimin mbi të Ardhurat*ò i ndryshuar; të nenit 60 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò; të Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 ñPër tatimin mbi të ardhuratò i ndryshuar, pika 2.3.6. Në këto kushte tatimpaguesit penalizohen me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, sipas përcaktimit të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar Neni 117, ñDënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”. Në total shuma e detyrimit për tu paguar është në vlerën 1,644,869 lekë.
Kriteri:	- Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në RSHò, i ndryshuar, Neni 117; - Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar, neni 35: Udhëzim nr.5, datë 30.01.2006 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar, pika 2.3.6; - VKM nr. 469 datë 3.6.2015 ñPër përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimoreò.
Ndikimi/Efekti	Mos evidentimi në kohë i deklarimeve të bëra nga subjektet tatimpaguese, të cilat ndikojnë në mos arkëtimin e saktë të të ardhurave nga tatimi në burim, të rezultuara, të cilat janë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.
Shkaku	Menaxhim joefektiv i strukturave nga ana e drejtimit të njësisë publike, si dhe mungesë e performancës së duhur të punonjësve të sektorit të kontrollit nga zyra.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandim:	- Sektori i Kontrollit nga Zyra pranë DTM, pasi të analizojë rastet e konstatuara nga KLSH duke nxjerrë përgjegjësitë konkrete, të marrë masa për kryerjen e vlerësimeve dhe rivlerësimeve përkatëse të diferencave të konstatuara në shumën 6,016,500 lekë,për 2 tatimpaguesit të cilët kanë vijuar me aplikimin e normës tatimore mbi Dividendin në shkallën 8% për fitimet e pashpërndara të vitit 2017 e më parë edhe pas afatit të fundit të aplikimit që ishte data 30 shtator 2019, si dhe të nxjerrë aktet e ñNjoftim vlerësimit për detyrimet tatimoreò ndaj tatimpaguesit, me qëllim arkëtimin e tyre në buxhetin e shtetit. - Sektori i Kontrollit nga Zyra pranë DTM, pasi të analizojë rastet e konstatuara nga KLSH duke nxjerrë përgjegjësitë konkrete, të marrë masa për kryerjen e vlerësimeve dhe rivlerësimeve përkatëse të diferencave të konstatuara në shumën 1,644,869lekë, për 4 tatimpaguesit, për të cilët nuk është vepruar për të mbledhur detyrimet e TMB nga qeratë për llogari të organeve tatimore që gjatë vitit 2018, 2019 dhe 2020, si dhe të nxjerrë aktet e ñNjoftim vlerësimit për detyrimet tatimoreò ndaj tatimpaguesve, me qëllim arkëtimin e tyre në buxhetin e shtetit.

Observacion i subjektit me nr. 544/25 prot., datë 20.12.2021 mbi projekt Raportin nr. 544/22 prot., datë 25.11.2021.
Pretendimi i Subjektit: *I. E.është transferuar në DTM me datën 16.03.2019. Nga Kontrolli nga zyra është e pamundur të bëhet zbatimi i ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pasi informacioni që merret nga librat e blerjes dhe të shitjes nuk mund të na informojë në lidhje me llojin e blerjeve që kryen tatimpaguesi. Subjekti nuk ka kaluar kontrollin nga zyra as për çështje të caktuara apo për tatime të veçanta. Detyrimet në lidhje me këtë subjekt nuk janë detyrë e Kontrollit nga zyra por e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara*.
Qëndrimi i Grupit të auditimit: *Grupi i auditimit mbështetur në komentet dhe dokumentacionit bashkëngjitur observacionit mbi projekt raportin, propozon daljen për kontroll në vend të këtij subjekti duke u përfshirë në planifikimet e DPT. Observacioni nuk merret në konsideratë*
Pretendimi i Subjektit: *Në lidhje me subjektet S., A. C., si dhe për për detyrimet në lidhje me tatim mbi qiranë për subjektet I.C., A., A. M. S., M.C.I. janë marrë masat duke ngarkuar subjektet me detyrimet e konstatuara nga ana juaj dhe kanë dalë njoftimet e vlerësimit.*
Qëndrimi i Grupit të auditimit: Sa më sipër reflektimi i detyrimeve nga ana e subjektit do të verifikohen në sistemin C@TS nga grupi i zbatimit të rekomandimeve, në auditimin e ardhshëm.

2.3.2.Sektori i Kontrollit në vend.

Në zbatim të pikës pika 3.2 të programit të auditimit Nr.544/1 prot., datë 27.05.2021, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1) Raportet e Kontrollit Tatimor të ushtruar në vend/subjekte (*kontrolli operacional*) me zgjedhje për periudhën 2018-2020;
2) Sistemi Elektronik/Informatik i Tatimeve C@TS (*Core Administration Tax System*).
3) Çdo dokumentacion i nevojshëm në lidhje me zbatimin e programit.

Drejtoria e Kontrollit Tatimor, bazuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar neni 80, ushtron kontroll tatimor në subjektet tatimpagues, në mënyrë që të verifikojë përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi nga ana e tatimpaguesve, kontrollin ndaj evazionit fiskal apo shmangieve tatimore që mund të jenë kryer nga tatimpaguesi.
Në zbatim të detyrimit ligjor, përcaktuar në nenin 80 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, DrejtoriaeKontrollit Tatimor kryen kontrolle në dy drejtime: nga zyra dhe në vend/ terren.
Kontrollet fillojnë në zbatim të planit operacional të hartuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), miratuar e dërguar për zbatim Drejtorisë/ve Rajonale Tatimore. Planet u dërgohen për zbatim DRT-ve brenda afati të përcaktuar në Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2[6] si dhe Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në RSHò, i ndryshuar neni 135, pika 3[7].
Bazuar në Manual, Kapitulli VIII, pika 8, Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit hap çështjen/kontrollin bazuar në kriteret e përcaktuara, ku përparësia e çështjes i referohet

[6] "Plani përfundimtar i subjekteve për kontroll për çdo DRT, hartohet nga Drejtoria e Manaxhimit të Riskut në DPT, miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe u dërgohet drejtorive rajonale tatimore brënda datës 25 të muajit për muajin pasardhësò.
[7] ñNgarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve që të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 29 pika 2 dhe të miratojë manualet teknike, manualin e vlerësimit, të investigimit, të shërbimit të tatimpaguesit dhe të masave shtrënguese, si dhe manuale të tjeraò.

rakordimit mes afatit të planifikuar nga DPT dhe përparësisë së çështjes sipas sistemit C@TS.
Vijohet me objektin e kontrolleve të inspektoreve të këtij sektori, me numrin e inspektoreve dhe numrin e kontrolleve tatimore gjithsej të kryera sipas viteve, kriteret e vendosura për përzgjedhjen e kontrolleve të marra në shqyrtim ne baze rrisku, numrin e kontrolleve të audituara dhe pastaj në vijim ato qe kane rezultuar me probleme.

Nga auditimi me zgjedhje i Raporteve të Kontrollit për vitet 2018-2020 u konstatuan:

Titulli gjetjes:	Moszbatim i manualit të kontrollit. Mosverivikim i blerjeve nga individë
Situata:	Subjekti ñA.òSHA me NIPT-L. Objekt aktiviteti ñImport eksport i të gjitha llojeve të gazit...ò. Nga auditimi i **praktikës/dokumentacionit zyrtar (fizik)** konstatohet: - Nuk është respektuar afati për kryerjen e kontrollit sipas Programit të Kontrollit, i cili është 160 orë pune/20 ditë pune pasi bazuar në P/Raport dhe Raport, kontrolli ka filluar me datë 18.5.2018 dhe ka përfunduar me datë 17.09.2018, duke tejkaluar afatin 20 ditor të përcaktuar në program, veprim jo në përputhje me Programin e miratuar dhe Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapi, pika 2.3. - Raporti i kontrollit nuk përmban bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij ñFormulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollitò i cili i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81, pika 3, brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (shtojca1) me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, jo në përputhje me Manualin Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6. - P/Raporti është hedhur me vonesë në sistemin C@TS jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2, pasi është përgatitur me datë 24.9.2018, hedhur në sistem datë 03.10.2018. - Procesverbalet nr.1, 2, 3 dhe 4, datë 17.7.2018 janë hedhur me vonesë në sistem me datë 3.10.2018 jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2, - Nga analiza e kryer mbi blerjet e përjashtuara për vitin 2017, rezulton se peshën më të madhe të blerjeve e zë ñBlerje nga individëò, në vlerën 301,129,110 lekë. Duke qenë se vlera e ñBlerje nga individëò për artikullin skrap përbën vlerën më të madhe, grupi auditimit arsyeton që bazuar në Ligjin Nr. 8438, Datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar, neni 13/2*Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi*ò, se këta individ, të cilët kryejnë shitjet në subjektin e sipërcituar, rrezikojnë të tejkalojnë shumën 2,000,000 lekë, vlerë për të cilën sipas Ligjit të sipërcituar janë të detyruar të bëjnë deklaratën mbi të ardhurat personale. Për këtë arsye grupi i auditivit e sheh si të arsyeshme që ndaj këtij subjekti të kryhet një analizë e thelluar nga institucionet kompetent të Administratës Tatimore(Hetimi Tatimor) mbi blerjet nga individët, pasi mund të kemi shmangie të detyrimeve tatimore
Kriteri:	Ligjin Nr. 8438, Datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar, neni 13/2
Ndikimi:	Shmangie e detyrimeve tatimore nga individë, të cilët mund të kalojnë të ardhurat 2,000,000 lekë, dhe për pasojë mungesa e te ardhurave ne buxhetin e shtetit.
Shkaku:	Moszbatim i pikave të Programit dhe manualit të kontrollit, mungesa e vlerësimit, mungesa e njohjes se Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 13/2.,
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të merren masa nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, që pasi të ketë analizuar mangësitë dhe parregullsitë e konstatuar në procedurën e kontrollit tatimor nga auditimi i KLSH duke nxjerrë përgjegjësitë konkrete, të propozojë pranë Administratës Tatimore (Hetimi Tatimor), për verifikimin e blerjeve të realizuara nga subjekti kundrejt individëve.

Titulli gjetjes:	Moszbatim i manualit të kontrollit: Mungesë informacioni në lidhje me marrjen me qira të pajisjeve (nga kush dhe nëse janë apo jo për qëllime të aktivitetit). Diferenca në lidhje me pasqyrimin e ndryshimit të gjendjes së inventarit në pasqyrën financiare, si dhe diferencë midis KMSH dhe asaj të pasqyruar në PASH, si dhe mos verifikim i burimit të huasë, mos raportim RAD, pra në organet kompetente.
Situata:	Subjekti ñV. H.ò SHPK me NIPT-K. <u>Objekt aktiviteti:</u> ñNdërmarrje ndërtimi për vete dhe të tretë...ò. Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit P. G. Nga auditimi i praktikës/dokumentacionin zyrtar (fizik) konstatohet: - Njoftimi i Kontrollit Nr. 7159/2, datë 21.08.2017 nuk ka konfirmim nga subjekti për marrjen dijeni të kontrollit. - Referuar programit të kontrollit, afati për kryerjen e kontrollit është 184 orë pune/23 ditë pune. P/Raporti është hartuar datë 15.12.2016 (*ka parregullsi viti i kontrollit*) dhe nuk pasqyron datën e fillimit të kontrollit, jo në përputhje me Manualin, Kap. II, pika 2.3. - P/Raporti është hedhur me vonesë në sistemin C@TS jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2, pasi P/Raporti është përgatitur me datë 15.12.2016 (*lapsus*), hedhur në sistem datë 28.12.2017. - Referuar analizës se blerjeve nga importi dhe brenda vendit për periudhën e kontrolluar (01.08.2016 -30.04.2017), rezulton që subjekti ka importuar makineri e pajisje të renda në një vlere rreth 80 milion leke. Gjithashtu nga dokumentacioni bashkangjitur bilancit financiar për vitin 2016,rezulton se shoqëria disponon një inventar te konsiderueshëm mjetesh te renda për rreth 100 cope. Nga ana tjetër nga analiza e blerjeve për periudhën e kontrolluar si dhe nga analiza e shpenzimeve te pasqyruara ne bilancin e vitit 2016,rezulton marrje mjete me qira nga te trete, pa specifikuar nga janë mare këto mjete dhe qëllimin e përdorimit te tyre për nevoja te aktivitetit. - Nga analiza e bilancit te vitit 2016 rezulton se në pasiv të bilancit janë pasqyruar detyrime ndaj ortakeveò në shumën 160 milion lekë, pa dhëne asnjë shpjegim lidhur me burimet e krijimit të fondeve nga ortakët të cilat i janë dhëne hua shoqërisë (në një kohe që për vitet e kaluara nga shoqëria nuk është shpërndare dividend), nëse ka kontrata të lidhura midis palëve, afatet e huadhënës, mënyra e kryerjes se transaksioneve nga ortaket te subjekti (me Banke apo Cash) ,etj. Gjithashtu në pasiv të bilancit në postin ñTituj të huamarrjes ñ, janë pasqyruar 22 milion lekë, shumë për të cilën nuk jepet asnjë shpjegim se çfarë përfaqëson, por vetëm thuhet që vjen e trashëguar nga vitet e kaluara. Gjithashtu në pasivet afat gjata në postin ñTituj te huamarrjesò janë pasqyruar 250 milion lekë, pa dhëne asnjë shpjegim se çfarë përfaqëson kjo shumë, vetëm thuhet që janë shuma te trashëguara nder vite, për hua te mara për nevoja te shoqërisë. Po në pasiv të bilancit ne postin ñKreditore te tjerë ñ janë pasqyruar rreth 22 milion leke, hua të marra nga individë të ndryshëm pa interes, pa dhëne shpjegime lidhur me personat huadhënës, dokumentacionin justifikues përkatës (kontratat,afatet) dhe mënyrën e kryerjes se transaksioneve midis palëve. **Në total detyrimet për huatë e marra nga subjekti nga të tretët rezultojnë 454 milion lekë, të cilat në mungesë të dokumentacionit justifikues përkatës si dhe mënyrës se kryerjes së transaksioneve mund të konsiderohen fitime të pa deklaruara ne vite.**Nga inspektori *P.G.*duhet të ishte bërë raportim RAD (*Raportim i aktivitetit të dyshimtë*) në organet kompetente, veprime në mospërputhje me Ligji Nr.9917, datë 19.5.2008 ñPër parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmitò i ndryshuar neni 18.1 ñ*Organet tatimore identifikojnë subjektet e tyre, sipas procedurave të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji dhe i raportojnë autoritetit përgjegjës menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë pas regjistrimit të veprimit, për çdo dyshim, sinjalizim, njoftim ose të dhënë, që ka të bëjë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit*ò, si dhe me UMF Nr.16, datë 16.2.2009, neni 2, pika 3

	ñ*Transaksione të dyshimta - çdo transaksion (pavarësisht sasisë), që nga natyra ose karakteri është i pazakonshëm për aktivitetin e personit, ose që për ndonjë arsye tjetër ngre dyshime për pastrim parash ose financim të terrorizmit*ò dhe neni 5 ñ1. *Organet tatimore i raportojnë autoritetit përgjegjës menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë pas regjistrimit të veprimit, për çdo dyshim, sinjalizim, njoftim ose të dhënë, që ka të bëjë me pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit.* 2. *Nëse zbulohet një transaksion i dyshimtë, atëherë duhet dërguar një raport tek autoriteti përgjegjës për aktivitetin e dyshimtë (sipas shtojcave në anekset II dhe III për 4 formularin dhe instruksionet bashkëlidhur, të cilat janë pjesë e këtij udhëzimi).* 3. *Bashkëngjitur këtij udhëzimi në shtojcën numër 1, janë pasqyruar modele të dyshimta të përdorura si standarde ndërkombëtare dhe kombëtare, orientuese për zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. 4. Punonjësve të organeve tatimore u ndalohet të informojnë klientin ose çdo person tjetër, në lidhje me procedurat e verifikimit të rasteve të dyshimta, si dhe për çdo raportim tek autoriteti përgjegjës*ò.
	- Nga analiza në Bilancin e vitit 2016 rezulton se ndryshimi i gjendjes së inventarit në bilanc në zërin ñLëndë e parëò, është 28,711,832 lekë, ndërsa nga Raport Kontrolli ndryshimi i gjendjes për të përllogaritur kosto të mallit të shitur (KMSH) ka përfshirë edhe ndryshimin e produktit të gatshëm në vlerën -7,789,850 lekë, vlerë e cila përllogaritet dhe reflektohet në zërin e të ardhurave në llogarinë ñndryshime në inventarin e produktit të gatshme në procesò, nga ku rezulton se dhe kjo vlerë është përllogaritur në shumën prej 8,357,646 Lekë, me një diferencë më shumë prej 567,796 lekë (16,675,875-24,515,725=-7,789,850 lekë). Mos rakordimi i ndryshimit të gjendjes se produktit të gatshëm në pasqyrën e performancës me ndryshimin e produktit të gatshëm në bilanc në diferencën prej 567,796 lekë, konsiderohet si mungesë e inventari i produktit të gatshëm gjendje, i shitur dhe i pa deklaruar nga subjekti me faturë tatimore, veprime në kundërshtim me: - Udhëzimin Nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar pika 57.1, ku përcaktohet: *"Personat e tatueshëm, subjekte te tatimit mbi vlerën e shtuar apo te tatimit mbi fitimin, janë te detyruar te mbajnë llogari, regjistrime dhe regjistra për te gjitha ngjarjet dhe veprimet qe përfshijnë furnizimet e kryera nga ana e tyre, furnizimet e marra prej tyre nga persona te tjerë, për te gjitha importet nga jashtë vendit dhe eksportet për jashtë vendit, në përputhje me dispozitat e Ligjit "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", dhe me aktet e tjera te nxjerra në zbatim të tij"* - Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008, ñPër Procedurat Tatimore të Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar, Nenin 124, ku përcaktohet se: *"Mos lëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i mos lëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore".* Nga ku subjektit i lindin detyrime si vijon: Detyrim TVSH 567,796 x 20% = 113,559 Lekë Gjobë TVSH (100%/) 113,559 Lekë **Detyrimi 227,118 Lekë** Detyrim TF 567,796 x 15% = 85,169 Lekë Gjobë TF (100%) 85,169 Lekë **Detyrimi 170,338 Lekë** - Sipas sistemit tatimor C@TS subjekti për vitin 2016 ka deklaruar blerje në total 1,126,147,530 Lekë, AAGJ të blera gjatë vitit 2016 është në vlerën 207,454,345 Lekë (e pasqyruar në shtesë tek regjistri i AAGJ, vlerë e cila zbritet nga blerjet totale për të përllogaritur koston e mallit. Sipas analizës rezulton se nga totali i shpenzimeve të tjera në vlerën 30,920,287 Lekë, nga të cilat shpenzimet e raportuara me fatura tatimore në librin e blerjeve janë në vlerën 26,910,224 Lekë. Për vitin 2016 janë përllogaritur edhe parapagimet në vlerën 55,310,165 Lekë. Sa më sipër, kostoja e mallit të shitur rezulton

<table>
<tr><td></td><td>të jetë në vlerën 918,381,294 Lekë, duke reflektuar dhe ndryshimin e gjendjes së inventarit. Në bilanc vlera e ñmallra, lëndë e parë dhe shërbimeò është në vlerën 954,766,083 Lekë.
Lekë
<table>
<tr><td>Blerje total</td><td>1,126,147,530</td></tr>
<tr><td>Gjendja e inventarit në fillim të vitit</td><td>30,12,770</td></tr>
<tr><td>Gjendja e inventarit në fund të vitit</td><td>58,835,602</td></tr>
<tr><td>AAGJ materiale</td><td>207,454,345</td></tr>
<tr><td>Shpenzime të raportuara në librin e blerjeve</td><td>26,910,224</td></tr>
<tr><td>Parapagime për blerje malli</td><td>55,310,165</td></tr>
<tr><td>KMSH</td><td>863,071,129</td></tr>
<tr><td>Bilanci</td><td>889,455,918</td></tr>
<tr><td>Ndryshimi</td><td>- 36,384,789</td></tr>
</table>
Si rezultat i kësaj analize rezulton një diferencë prej 36,384,789 lekë, ku duke marrë në konsideratë dhe vlerën prej 1,800,000 lekë të konstatuar nga inspektori në Raport Kontrollin, rezulton se vlera mbi të cilën do të llogariten detyrimet tatimore për subjektin është 34,584,789 Lekë (36,384,789 ï 1,800,000).
Në zbatim të Ligjit 8348, dt. 28.12.1998, ñPër Tatimin mbi të Ardhuratò, i ndryshuar, neni 20, germa ñlò, si dhe të Nenit 115 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, ñPër procedurat tatimore në RSHò, i ndryshuar i cili përcakton se... ñDorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”.
subjektit i lindin detyrimet si vijon:
Detyrim TF 34,584,789 x 15% = 5,187,718 Lekë
Gjobë TF (0.06% x 365) <u>1,136,110 Lekë</u>
Detyrimi 6,323,629 Lekë
Veprimet e sipërme janë kompetence e inspektorit të kontrollit P. G..</td></tr>
<tr><td>Kriteri:</td><td>- Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, nenin 115 dhe 124;
- Udhëzimi Ministrisë së Financave Nr.24, datë 02.09.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, pika 57.1; si dhe
- Manuali i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II;
- Ligji Nr. 9917, datë 19.5.2008 ñPër parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmitò i ndryshuar, neni 18.1; si dhe me
- UMF Nr.16, datë 16.2.2009, neni 2, pika 3 dhe neni 5.</td></tr>
<tr><td>Ndikimi:</td><td>Krijimi i të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 6,721,085 lekë, si dhe mos zbatim i legjislacionit për raportimin e subjektit për RAD.</td></tr>
<tr><td>Shkaku:</td><td>Moszbatim i manualit të kontrollit, mos analizim i hollësishëm nga ana e inspektorit të zërave të shpenzimeve të realizuara nga subjekti, mos analizim i detyrimeve për huatë e marra nga subjekti ndaj palëve të treta, si dhe mos zbatim të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar neni 124, Udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar pika 57.1, si rezultat i mungesës së përgjegjëshmërisë së inspektorëve në zbatimin e kuadrit ligjor, nënligjor dhëe rregullator.</td></tr>
<tr><td>Rëndësia:</td><td>E lartë</td></tr>
<tr><td>Rekomandimi:</td><td>- Të merren masa nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, që pasi të ketë analizuar mangësitë dhe parregullsitë e konstatuar në procedurën e kontrollit tatimornga auditimi i KLSH duke nxjerrë përgjegjësitë konkrete, të propozojë në DPT rikontroll tatimor ndaj subjektit duke nxjerrë vlerësim tatimor me qëllim arkëtimin e vlerave, llogaritur nga KLSH në shumën 6,721,085 lekë.
-Të merren masa nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, për dërgimin e informacionit RAD në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, mbi burimin detyrimet për huatë e mara nga subjekti ndaj palëve të treta në vlerën 454</td></tr>
</table>

	milion lekë, vlerë për të cilën mungojnë shpjegime dhe dokumentacioni justifikues përkatës, mungon informacioni në lidhje me mënyrën e kryerjes se transaksioneve midis palëve.

Observacion i subjektit ñV. H.ò me Nr. 544/25 prot., date 20.12.2021 mbi projekt Raportin nr. 544/22 prot., datë 25.11.2021 si dhe ankesa me nr 544/24 datë 13.12.2021.

Pretendimi i Subjektit: *Lidhur me Raportin e Kontrollit mbajtur për subjektin "V. H." SHPK, arsyetoj se: Lidhur me konstatimin për marrjen e mjeteve meqira vjen si pasojë e volumit të madh të punimeve të ndërtimit për vitin 2016, si dhe kompania duke qënë se ka shpërndarje gjeografike të punimeve për efekt të kostove të transportimit të makinerive të veta, ka marrë me qira makineri në vendin ku ushtron punimet.*

Lidhur me llogarinë e detyrimeve ndaj ortakut ne shumën 160 milion lekë, në postin titujt e huamarrjes 22 milion lekë sqaroj se ky veprim ka ndodhur jashtë periudhës time të kontrollit.

Lidhur me mospërputhjen e shpenzimeve te konstatuara KMSH është analizuar në përputhje me ligjin Nr. 9477,datë 09.06.2006 te SKK.

Lidhur me marrjen në konsideratë për efekt të KMSH-së paradhëniet për mallra dhe shërbime ka ndodh pasi shoqëria ka operuar me nënkontraktor.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Grupi i auditimit mbështet në raport kontrollin e përpiluar nga inspektori ku të dhënat e reflektuara në raport duhet të jenë të analizuara qartë, pasi finalizon një kontroll të një periudhë për të cilën, nga administrata tatimore për këtë tatimpaguese merret si periudhë e ezauruar. Duke qënë se grupi i auditimit nuk ka informacion dhe dokumentacion të detajuar në lidhje me konstatimet e reflektuar sa më sipër, qëndron në propozimin për rikontroll të subjektit. Çdo pretendim nga ana e inspektorit të qartësohet në rikontrollin e propozuar nga grupi i auditimit.

Titulli gjetjes:	Moszbatim i manualit të kontrollit. Shitje dhe dalje nën kosto të produktit gazoil. Mungesë analize të kostos së mallit gjendje të deklaruara nga subjekti në fund të periudhës ushtrimore. Mungesë e analizës së shpenzimeve, të cilat nuk janë në shërbim të aktivitetit, ku për efekt të fiskalitetit nuk njihen si shpenzime.
Situata 1:	Subjekti ñSH.-A.ò SHPK me NIPT-K.. Objekt aktiviteti: ñTransport mallrash dhe pasagjerësh brenda dhe jashtë vendit...ò. Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit z. I.Ldhe inxhinieri z. I. K. Nga auditimi i **praktikës/dokumentacionit zyrtar (fizik)** konstatohet: - Raporti i kontrollit nuk përmban bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij ñFormulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollitò i cili i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81, pika 3, brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (shtojca1) me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, jo në përputhje me Manualin Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6. - P/Raporti është hedhur me vonesë në sistemin C@TS jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2, pasi është përgatitur me datë 24.9.2018, hedhur në sistem datë 03.10.2018. - P/Raporti hedhur me vonesë në sistemin C@TS jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2, pasi P/Raporti është përgatitur me datë 07.9.2018,hedhur në sistem datë 7.9.2018. Gjithashtu dhe procesverbalet nr.1, 2,dhe 3, datë 13.8.2018 janë hedhur me vonesë në sistem datë 7.9.2018 si dhe procesverbalet e datës 5.6.2018 janë hedhur në sistem datë 7.9.2018. - Nga analiza e bilancit material të bërë nga inspektori, si dhe analiza e çmimit të blerjes dhe shitjes së gazoilit, u konstatuan dalje dhe shije nën kosto. të cilat ndikojnë në uljen e të ardhurave të pasqyruara si më poshtë. ***Për vitin 2015***

Përshkrimi	Njësi	Daljet		konsum te brendshëm		shitje me kosto		shitje me vlte shtuar		Përllogaritja
		Sasia	Vlera	Sasia	Vlera	Sasia	Vlera	çmimi	Vlera	
Nafte	lt	2,637,839	336,974,225	1,666,345	212,692,276	971,494	124,281,949	146	141,935,273	**17,653,324**
Benzine	lt	262,488	33,242,156					146	38,323,248	**5,081,092**
Gaz	lt	74,989	4,386,023					116	8,698,724	**4,312,701**
Solar	lt	100,150	8,071,058							
Bitum	lt	126,120	7,405,667							
Totali			390,079,128							**27,047,117**

Për vitin 2016

Përshkrimi	Njësi	Daljet		konsum te brendshëm		shitje me kosto		shitje me vlte shtuar		Përllogaritja
		Sasia	Vlera	Sasia	Vlera	Sasia	Vlera	çmimi	Vlera	
Nafte	lt	2,612,896	305,668,172	1,566,690	184,161,807	1,046,206	121,506,365	132	138,318,895	**16,812,530**
Benzine	lt	179,564	20,871,483					133.91	24,045,415	**3,173,932**
Gaz	lt	19,593	1,155,762					89.3	1,749,655	**593,893**
Solar	lt	53,007	3,759,384							
totali			329,163,696							**20,580,355**

Për vitin 2017

Përshkrimi	Njësi	Daljet		konsum te brendshëm		shitje me kosto		shitje me vlte shtuar		Përllogaritja
		Sasia	Vlera	Sasia	Vlera	Sasia	Vlera	çmimi	Vlera	
Nafte	lt	3,742,154	465,352,953	3,061,611	373,559,066	680,543	91,793,887	148	100,407,314	**8,613,427**
Benzine	lt	75,882	9,964,027					145	11,002,890	**1,038,863**
Gaz	lt	39,815	1,944,160					59	2,349,085	**404,925**
Solar	lt									
totali										**10,057,215**

Për vitin 2018

Përshkrimi	Njësi	Daljet		konsum te brendshëm		shitje me kosto		shitje me vlere shtuar		Përllogaritja
		Sasia	Vlera	Sasia	Vlera	Sasia	Vlera	çmimi	Vlera	
Nafte	lt	761,812	100,559,184	568,273	74,921,112	193,539	25,638,072	143	27,714,785	**2,076,713**
Benzine	lt	11,696	1,411,941					143	1,677,089	**265,148**
Gaz	lt	12,414	585,072					65	806,910	**221,838**
Solar	lt									
totali										**2,563,699**

Totali i përllogaritur nga grupi i auditimit është në vlerën 60,248,387 lekë, vlerë për të cilën në zbatim të Nenit 124 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, mos lëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i mos lëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore*ò subjektit i lindin detyrimet si më poshtë:

Detyrim TVSH 60,248,387 * 20% = 12,049,677 Lekë
Gjobë TVSH (100% e detyrimit) = 12,049,677 Lekë
Detyrimi **24,099,355 Lekë**

Detyrim TF 60,248,387*15% = 9,037,258 Lekë
Gjobë TF (100% e detyrimit) = 9,037,258 Lekë
Detyrimi **18,074,516 Lekë**

- Nga shqyrtimi i bilancit të vitit 2014,2016 dhe 2017 u konstatua se subjekti në shpenzimet e njohura ka llogaritur edhe **donacionet** në vlerën 600,000 lekë për vitin 2014: vlerën 2,783,080 lekë për vitin 2016 dhe vlerën 6,109,455 lekë për vitin 2017, veprime në kundërshtim me gërmën j , të nenin 21, të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 për ñTatimin mbi të ardhuratò i ndryshuar ñPër efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm, nuk njihen shpenzimet si vijoné ". Në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 115 ku citohet ñ*Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës*

*pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike*ò subjektit i lindin detyrime si vijon:

Detyrim TF 9,492,535 x 15% = 1,423,880 lekë

Gjobë TF (21.9% e detyrimit) 311,830 lekë

Detyrimi 1,735,710 lekë

- Nga analiza e bilancin material dhe analiza e çmimeve rezultoi se, për artikullin ñÇakullò për vitin 2015 gjendja e inventarit në fund të periudhës është me kosto 653 lekë, ku çmimi i blerjes së këtij artikulli është në vlerën 280 lekë pasqyruar si më poshtë:

Përshkrimi	Njësi	Gjendje ne Fillim			Hyrjet			Daljet			Gjendje ne Fund		
		Sasia	Vlera	kosto	Sasia	Vlera	kosto	Sasia	Vlera	kosto	Sasia	Vlera	kosto
Cakull	m3	943	263,939	280	59,180	16,570,400	280	59,719	16,721,320	280	404	263,939	653

Për sa më sipër diferencat e konstatuara prej 150,819 lekë (653-280)*404 rezultojnë të jenë shitje të padeklaruara nga subjekti, ku në zbatim të Nenit 124 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, *mos lëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i mos lëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore*ò subjektit i lindin detyrimet si më poshtë:

Detyrim TVSH (20%) 150,819 *20% = 30,164 lekë

Gjobë TVSH (100% e detyrimit) 30,164 lekë

Detyrimi 60,328 lekë

Detyrim TF 150,819 *15% = 22,623 lekë

Gjobë TF (100% e detyrimit) 22,623 lekë

Detyrimi 45,246 lekë

- Nga analiza e bilancin material dhe analizën e çmimit për vitin 2016 krahasuar me inventarin fizik të dorëzuar nga subjekti në sistemin C@TS ka rezultuar diferencë të vlerës të disa prej artikujve pasqyruar si vijon:

Përshkrimi	**Njësi**	**Gjendje ne Fund**		Vlera e inventarit te subjektit
		Sasia	**Vlera**	
Hekur	kv	288	1,728,159	22,828
Tulle solete 20x25x42	cope	119	6,117	1,771
Tjegull e plote	cope	131	5,178	5,202
Kulme	cope	34	2,175	2,175
hekur zgare	ton	22	44,920	32,926
Pllake	m3	140	54,655	101,258
Tulle 25x25x25	cope	97	3,677	1,771
Rrjete Teli	Kg	1,126	121,226	1,910
Granit	m3	30	78,690	79,444
Llamarine çeliku	Kg	1,203	72,922	7,690
Profile	Kg	13,904	855,125	2,717
Alumin	Kg	82	37,720	37,720
Tulle 9*14*33	cope	27	602	454
Tulle Termike 20x25x25	cope	211	4,019	3901
Çimento	kv	163	114,955	2963
Tulle 12x20x25	cope	146	2,189	2,043
Tulle 10x25x25	cope	99	1,481	1,448
TOTALI			3,133,810	308,221
Diference inventari inspektor/inventar subjekt			**2,825,589**	

Për sa më sipër diferencat e konstatuara prej 2,825,589 lekë rezultojnë të jenë shitje të padeklaruara nga subjekti, ku në zbatim të Nenit 124 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, *mos lëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i mos lëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me*

	*dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore*ò subjektit i lindin detyrimet si më poshtë: Detyrim TVSH (20%) 2,825,589 *20% = 365,118 lekë Gjobë TVSH (100% e detyrimit) 565,118 lekë **Detyrimi** **1,130,236 lekë** Detyrim TF 2,825,589 *15% = 423,838 lekë Gjobë TF (100% e detyrimit) 423,838 lekë **Detyrimi** **847,677 lekë** *Veprimet e sipërme janë kompetencë e inspektorit të kontrollit z. I.Ldhe inxhinieri z. I. K.*
Kriteri:	Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 124 dhe 115, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.24, datë 02.09.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, pika 57.1. Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPer tatimin mbi të ardhuratò i ndryshuar, neni 21. Udhëzimi nr.5 datë 30.01.2006 ñPër tatimin mbi fitiminò Pika 3.6. si dhe Manuali i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 dhe 2.2.
Ndikimi:	Krijimi i të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit **në vlerën 45,993,068** lekë.
Shkaku:	Mos analizim i çmimit të shitjes së produktit gazoil. Mungesë analize të kostos së mallit gjendje të deklaruara nga subjekti në fund të periudhës ushtrimore, për të nxjerrë sasinë reale gjendje në fund periudhës. Mungesë e analizës së shpenzimeve të njohura nga subjekti, si dhe mos zbatim të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 për ñTatimin mbi të ardhuratò i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5 datë 30.01.2006 ñPër Tatimin mbi Fitiminò, pra mungesë përgjegjëshmerie nga ana e insektorit në ushtrimin e funksioneve te tij publike.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të merren masa nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, që pasi të ketë analizuar mangësitë dhe parregullsitë e konstatuar në procedurën e kontrollit tatimornga auditimi i KLSH duke nxjerrë përgjegjësitë konkrete, të propozojë në DPT rikontroll tatimor ndaj subjektit duke nxjerrë vlerësim tatimor me qëllim arkëtimin e vlerave të llogaritura nga KLSH në shumën prej **45,993,068** lekë.

Observacion i subjektit me Nr. 544/25, date 20.12.2021 mbi Projekt Raportin nr. 544/22 datë 25.11.2021.

Pretendimi i Subjektit: *Lidhur me Raportin e Kontrollit mbajtur për subjektin "*Sh.-A.*" SHPK, arsyetoj se:...lidhur me konstatimin për shitjet nën kosto për artikujt naftë , benzinë dhe gaz për vitet 2015, 2016, 2017 dhe 2018 këto diferenca nuk qëndrojnë pasi analiza pasqyrohet në trajtimin e bilancit material sipas viteve përkatëse, për diferencën në artikullin Gaz dhe benzinë të konstatuar ju informoj se ajo është përdorur për nevojat e aktivitetit.*

Lidhur me shpenzimet për donacionet për vitet 2014, 2016 dhe 2017 të cilat janë përshkruar si donacione ka ndodhur një lapsus pasi janë dieta për punonjësit.

Lidhur me analizën për artikullin "Cakëll" kjo nuk qëndron pasi inventari i deklaruar nga shoqëria në sistemin C@ts është deklaruar gabim dhe ai i sakti është analiza e inventarit të bërë në raportin e kontrollit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Grupi i auditimit referuar kundërshtimeve të paraqitura nga ana juaj në këtë observacion nuk merren në konsideratë pasi grupi mbështet në faktet dhe argumentet e paraqitura nga inspektori në raport kontrolli, të cilat janë vërtetuar mbi bazën e dokumentacionit të kontrolluara në terren nga ana e tij. Pretendimet e paraqitura në observacion për gabime në regjistrime nuk mund të vërtetohen nga ana e audituesve, pasi auditimi është kryer në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga ana e juaj.

Titulli gjetjes:	Moszbatim i manualit të kontrollit. Diferenca mes shitjeve të deklaruara nga subjekti në Sistemin C@TS dhe shitjeve të deklaruara në Nexus (shitjet me kasë).
Situata 1:	Subjekti ñO.ò SHPK, me NIPT-J., Objekt aktiviteti: ñTregti me shumicë dhe pakicë e karburanteve etj. ...ò. Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit A.Sh.. Nga auditimi i praktikës/dokumentacionit zyrtar (fizik) konstatohet: - Njoftimi i Kontrollit nr.6568/1, datë 28.08.2019 dhe programi parashikon afatin për kryerjen e kontrollit në 488orë/56 ditë pune. Referuar Formularit1(*dokumentimit të lëvizjes së dokumentacionit të kontrollit*), data e fillimit të kontrollit është 16.09.2019 dhe e mbarimit 03.09.2020, pra kryer kontrolli jo në respekt të afateve të vendosur në program, jo në përputhje me Manualin Kapitulli II. - P/Raporti është përgatitur me datë 03.08.2020 dhe është hedhur me vonesë në sistemin C@TS jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2, - Raporti i kontrollit nuk përmban bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij ñFormulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollitò jo në përputhje me Manualin Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6. - Bashkangjitur praktikës nuk gjenden procesverbalet e mbajtur gjatë kryerjes së kontrollit jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2. - Nga analiza e shitjeve të deklaruara nga subjekti në Sistemin C@TS dhe krahasimi i tyre me shitjet e deklaruara në Nexus (shitjet me kasë) konstatohet diferenca për vitin 2016, 2017 dhe 2018, ku vlera e shitjeve në sistemi Nexus është më e lartë se ajo e deklaruar nga subjekti në pasqyrën e PASH në zërin ñTë ardhura nga shfrytëzimi ñ, pasqyruar si më poshtë për vitet objekt kontrolli:

Periudha (Viti 2016)	sasi e shitur	Shitje Tatueshme	TVSH
FDP	20,590,665	2,577,919,079	515,583,816
kasa	21,868,422	2,736,159,592	547,231,917
Diferenca	(1,277,757)	(158,240,513)	(31,648,101)

Periudha (Viti 2017)	sasi e shitur	Shitje Tatueshme	TVSH
FDP	20,875,891	2,740,549,145	548,109,829
kasa	22,780,837	**2,952,871,955**	590,574,284
Diferenca	**(1,904,946)**	**(212,322,810)**	**(42,464,455)**

Periudha (Viti 2018)	sasi e shitur	Shitje Tatueshme	TVSH
FDP	28,601,592	3,924,441,795	784,888,359
kasa	30,847,862	**4,236,300,753**	847,260,225
Diferenca	**(2,246,270)**	**(311,858,958)**	**(62,371,866)**

Për sa më sipër diferencat e konstatuara prej 682,422,281 lekë rezultojnë të jenë shitje malli të padeklaruara nga subjekti, ku në zbatim të Nenit 124 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, *mos lëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i mos lëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore*ò subjektit i lindin detyrimet si më poshtë:

Detyrim TVSH 682,422,281 * 20% = 136,484,456 Lekë
Gjobë TVSH (100% e detyrimit) = 136,484,456 Lekë
Detyrimi **272,968,912 Lekë**

Detyrim TF 682,422,281 *15% = 102,363,342 Lekë
Gjobë TF (100% e detyrimit) = 102,363,342 Lekë
Detyrimi **204,726,684 Lekë**

Veprimet e sipërme janë kompetencë e inspektorit të kontrollit z. A.Sh..

Kriteri:	Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 124 si dhe Manuali i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II pika 2.1 dhe 2.2.
Ndikimi:	Krijimi i të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën **477,695,596 lekë**
Shkaku:	Mos krahasimi nga ana e inspektorit të kontrollit të raportit të pajisjeve fiskale për vitet objekt kontrolli me ato të deklaruara nga subjekti në sistemin C@TS, për të verifikuar nëse ka apo jo diferenca, si dhe mos zbatim të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar,
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të merren masa nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, që pasi të ketë analizuar mangësitë dhe parregullsitë e konstatuar në procedurën e kontrollit tatimor nga auditimi i KLSH duke nxjerrë përgjegjësitë konkrete, të propozojë në DPT rikontroll tatimor ndaj subjektit duke nxjerrë vlerësim tatimor me qëllim arkëtimin e vlerave të llogaritura nga auditimi i KLSH në shumën **477,695,596 lekë**.

Observacion i subjektit me Nr. 544/25, datë 20.12.2021 mbi Projekt Raportin nr. 544/22 datë 25.11.2021.

Pretendimi i Subjektit: *Lidhur me Raportin e Kontrollit mbajtur për subjektin "***O.***" SHPK, arsyetoj se: ...lidhur me konstatimin e diferencës midis kasave dhe FDP-së ju sqarojë se ju keni llogaritur si qarkullim totalin e rubrikave 21, 22, 23, 24 ndërkohë sipas emailit bashkëlidhur rubrikat pasqyrohen në shumën totale në rubrikën 21. Diferencat në plus janë Tollonat Letër, Elektronik, si dhe transferimet dhe shitjet e tjera.*

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Për sa i përket kundërshtimit nga ana juaj duke ju referuar dhe observacionit në fazën e projektit përveçse bien në kundërshtim me njëra tjetrën nuk janë të bazuara në legjislacionin tatimor, si dhe nuk është paraqitur asnjë dokument apo bazë ligjore. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Titulli gjetjes:	Moszbatim i manualit të kontrollit. Diferenca mes shitjeve të deklaruara nga subjekti në Sistemin C@TS dhe shitjeve të deklaruara në Nexus (shitjet me kasë)
Situata	Subjekti ñG. C.òSHPK, me NIPT-K. <u>Objekt aktiviteti</u>:ò Tregti me shumicë dhe pakicë e karburanteve etj. ...ò. Nga auditimi i **praktikës/dokumentacionit zyrtar (fizik)** konstatohet: - Njoftimi i Kontrollit nr.503, datë 15.01.2018 i cili është konfirmuar nga tatimpaguesi me datë 29.01.2018 dhe programi i kontrollit parashikon afatin për kryerjen e kontrollit 208 orë/26 ditë pune. Bashkangjitur praktikës mungon Formulari 3 (*formulari i dokumentimit të lëvizjes së dokumentacionit*). Referuar datës së mbajtjes së procesverbaleve në momentin e fillimit të kontrollit datë 31.01.2018, rezulton se afati për mbarimin e kontrollit është bërë me vonesë datë 24.04.2018, duke mos respektuar afatet e vendosura në program, jo në përputhje me Manualin Kapitulli II. - Procesverbalet e datës 31.01.2018 janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2. - Raporti i kontrollit nuk përmban bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij ñFormulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollitò jo në përputhje me Manualin Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6. - Nga analiza e shitjeve të deklaruara nga subjekti në Sistemin C@TS dhe krahasimi i tyre me shitjet e deklaruara në Nexus (shitjet me kasë) konstatohet diferenca për vitin 2015,2016 dhe 2017, ku vlera e shitjeve në sistemi Nexus është më e lartë se ajo e deklaruar nga subjekti në pasqyrën ñPASHò në zërin ñTë ardhura nga shfrytëzimi ñ,pasqyruar si më poshtë për vitet objekt kontrolli:

Viti	Kasa	FDP	Diferenca	TVSh
2015	1,923,755,045	1,873,664,803	-50,090,242	-10,018,048
2016	3,334,510,688	3,276,055,756	-58,454,932	-11,690,986
2017	4,140,063,630	3,733,236,749	-406,826,881	-81,365,376
Total	**9,398,329,363**	**8,882,957,308**	**-515,372,055**	**-103,074,411**

Për sa më sipër diferencat e konstatuara prej 515,372,055 lekë rezultojnë të jenë shitje malli të padeklaruara nga subjekti, ku në zbatim të Nenit 124 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, *mos lëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i mos lëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore*ò subjektit i lindin detyrimet si më poshtë:

Detyrim TVSH 515,372,055 * 20% = 103,074,411 Lekë
Gjobë TVSH (100% e detyrimit) = 103,074,411 Lekë
Detyrimi **206,148,822 Lekë**

Detyrim TF 515,372,055 *15% = 77,305,808 Lekë
Gjobë TF (100% e detyrimit) = 77,305,808 Lekë
Detyrimi **154,611,617 Lekë**

Sa më sipër, pretendimet e inspektorit kanë qenë se në lidhje me sistemin Nexus nuk ka patur mundësi aksesimi dhe për këtë i ka kërkuar me email znj. D. G., ish Specialiste Drejtoria e Analizës dhe TIK në Drejtorin e Tatimpaguesve të Mëdhenj, të dhënat e shitjes me kasë për vitet 2015-2017. E-mail si dokument vërtetues nga inspektori i kontrollit z.E.D., mbi të cilën është bazuar për të realizuara kontrollin ju vu në dispozicion grupit auditues më datën 22.09.2021, si rrjedhojë për v*eprimet e sipërme janë kompetencë e znj. D. G., ish-Specialiste Drejtoria e Analizës dhe TIK në Drejtorinë Tatimpaguesve të Mëdhenj*

Kriteri:	Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar neni 124, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.24, datë 02.09.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar pika 57.1. si dhe Manuali i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II pika 2.1 dhe 2.2.
Ndikimi:	Krijimi i të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 360,760,439 lekë**.**
Shkaku:	Mos disponimi i informacionit të saktë nga inspektori i kontrollit të dhënave të shitjes me kasë të realizuara nga subjekti dhe krahasimi i tyre me ato të deklaruara nga subjekti në sistemin C@ts, për të verifikuar nëse ka apo jo diferenca, si dhe mos zbatim të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të merren masa nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, që pasi të ketë analizuar mangësitë dhe parregullsitë e konstatuar nëprocedurën e kontrollit tatimornga auditimi i KLSH duke nxjerrë përgjegjësitë konkrete, të propozojë në DPT rikontroll tatimor ndaj subjektit duke nxjerrë vlerësim tatimor me qëllim arkëtimin e vlerave të llogaritura nga auditimi i KLSH në shumën **360,760,439 lekë**.

Observacion i subjektit me Nr. 544/25, datë 20.12.2021 mbi Projekt Raportin nr. 544/22 datë 25.11.2021.

Pretendimi i Subjektit: *Në lidhje me Raportin e Kontrollit mbajtur për subjektin "* **G. C.***" SHPK, arsyetoj se: ...me konstatimin për ngarkim të personit tim me përgjegjësi lidhur me kthimin e përgjigjes së inspektorit të kontrollit, përgjigje të cilën ma kanë kthyer me email nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.*

Përsa i përket arsyetimit të diferencës midis kasave dhe fdp-së ju sqarojë se janë llogaritur si qarkullim totalin e rubrikave 21, 22, 23, 24 ndërkohë sipas emailit bashkëlidhur rubrikat pasqyrohen në shumën totale në rubrikën 21.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:Pavarsisht se ju në argumentat tuaj shpreheni se është përgjegjësi e inspektorit për të nxjer raportet nga sistemi dhe se inspektori ka pasur akses në sistemin Nexus ju keni marrë përsipër gjenerimin e këtyre të dhënave dhe si pasojë me vënien në dispozicion të një informacioni i cili rezulton të jetë i ndryshëm nga deklarimi në sistemin Nexus të këtyre pajisjeve fiskale ka sjell efektet financiare të sipër cituara.

Lidhur me pasqyrimin e rubrikave ky kundërshtim nuk është i bazuar në legjislacionin tatimor. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Titulli gjetjes: Moszbatim i manualit të kontrollit, Diferenca në bilancin material, si dhe shitje nën kosto e produkteve gazoil.

Situata

Subjekti ñA.ò SHA, me NIPT-L ..

Objekt aktiviteti: ñTregti me shumicë në fushën e hidrokarbureve etj....ò.

Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit z. F.Gj.

Nga auditimi i **praktikës/dokumentacionit zyrtar (fizik)** konstatohet:

-Raporti i kontrollit nuk përmban bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij ñFormulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollitò jo në përputhje me Manualin Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.

-Procesverbal inventarizimi fizik datë 21.07.2020 hedhur me vonesë në C@TS jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2.

- Për sasinë e mallit gjendje të datës 31.03.2018, grupi i auditimit për të bërë analizën e lëvizjes material për vitin 2018, në mungesë të analizës në raportin e kontrollit, u referuar në raportin e kontrollit nr.5294/1, të datës 03.12.2018.

- Nga analiza e lëvizjes material deri me datën 31.12.2018, u konstatuan diferenca si më poshtë:

Përshkrimi	Njësi	Gjendje kontabël 31.03.20	Blerje	Blerje +GJ fillim	Shitjet	Gjendja ne 31.12.20	inv kontabël	firo ligjore	Diferenca 2018	Vlera e tatueshme
Nafte	Litër	63,355	7,289,536	7,352,891	7,317,082	35,809	59,755	14,634	9,312	1,232,049
Benzine	Litër	4,559	1,658,460	1,663,019	1,653,031	9,988	8,489	3,306	-4,805	-606,927
										1,838,976

Nga sa më sipër rezulton një diferencë në vlerën prej 1,838,976 lekë midis gjendjes kontabël dhe asaj faktike të realizuara nga grupi auditimit bazuar në hyrjet dhe daljet e bëra nga subjekti gjatë vitit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

Udhëzimin Nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar pika 57.1, ku përcaktohet: *"Personat e tatueshëm, subjekte te tatimit mbi vlerën e shtuar apo te tatimit mbi fitimin, janë te detyruar te mbajnë llogari, regjistrime dhe regjistra për te gjitha ngjarjet dhe veprimet qe përfshijnë furnizimet e kryera nga ana e tyre, furnizimet e marra prej tyre nga persona te tjerë, për te gjitha importet nga jashtë vendit dhe eksportet për jashtë vendit, në përputhje me dispozitat e Ligjit "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", dhe me aktet e tjera te nxjerra në zbatim të tij"*

- Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008, ñPër Procedurat Tatimore të Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar, Nenin 124, ku përcaktohet qartë se: *"Mos lëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i mos lëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore".* Nga ku subjektit i lindin detyrime si vijon:

Detyrim TVSH	1,838,976 * 20%	= 367,795 Lekë
Gjobë TVSH (100% e detyrimit)		= 367,795 Lekë
Detyrimi		**735,590 Lekë**
Detyrim TF	1,838,976 *15%	= 275,846 Lekë
Gjobë TF (100% e detyrimit)	= 275,846 Lekë	

	Detyrimi **551,692 Lekë**

- Nga analiza e bilancin material dhe analizës sëçmimit për vitin 2018, u konstatua se subjekti ka bërë shitje të produktit nafte dhe benzinë nën kosto të detajuara sipas tabelave të mëposhtme:

Benzinë

	Njësia	Sasia	Çmimi i shitjes	Çmim blerjes	diferenca	Vlera e tatueshme	TVSH
DYLI-OIL	"	990	115.83	123.63	7.8	7,722	1,544
EUROPETROL DURRES	"	98,534	120.92	123.63	2.71	267,027	53,405
RUCI SHPK	"	44,806	121.77	123.63	1.86	83,339	16,668
F.S.T	"	111,362	122.29	123.63	1.34	149,225	29,845
Totali	**Benzine**					**507,313**	**101,463**

Naftë

Klienti	Njësia	Sasia	Çmimi i shitje	çmim blerjes	diferenca	Vlera e tatueshme	TVSH
SOIL	"	5,854	116.67	129.96	13.29	77,800	15,560
RUCI SHPK	"	130,793	125.8	129.96	4.16	544,099	108,820
DYLI-OIL	"	1,998	125.83	129.96	4.13	8,252	1,650
F.S.T	"	124,548	126.12	129.96	3.84	478,264	95,653
ARJEIL	"	42,577	126.97	129.96	2.99	127,305	25,461
FJORTES	"	134,427	127.21	129.96	2.75	369,674	73,935
CLASSIC AM	"	53,509	128.39	129.96	1.57	84,009	16,802
QORRIOIL	"	30,653	128.47	129.96	1.49	45,673	9,135
ARSA	"	3,959	128.75	129.96	1.21	4,790	958
GJIKURIA	"	3,945	128.75	129.96	1.21	4,773	955
QEMAL&SHABANIOIL	"	5,944	129.38	129.96	0.58	3,448	690
BEGAJ LEPENICA	"	19,837	129.58	129.96	0.38	7,538	1,508
BEGAJ T	"	4,960	129.58	129.96	0.38	1,885	377
GJOZIOIL	"	1,992	129.58	129.96	0.38	757	151
VELIAJ PETROL	"	519,995	129.68	129.96	0.28	145,599	29,120
LAMCE	"	478,327	129.72	129.96	0.24	114,798	22,960
Totali	**Nafte**	**1,563,318**				**2,018,664**	**403,733**

Diferenca e konstatuara nga shitja nën kosto nga subjekti ka ndikim në detyrim të TVSH-së në vitin 2018, për shitjet dhe në Tatim Fitim të vitit 2018, dhe në zbatim të Nenit 124 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, *mos lëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i mos lëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore"* subjektit i lindin detyrimet si vijon:

Detyrim TVSH 2,525,977 x 20% = 505.195 lekë
Gjobë TVSH (100% e detyrimit) 505,195 lekë
Detyrimi **1,010,390 lekë**

Detyrim TF 2,525,977 x 15% = 378,897 lekë
Gjobë TF (100% e detyrimit) 379,897 lekë
Detyrimi **757,794 lekë**

Veprimet e sipërme janë kompetencë e inspektorit të kontrollit z. F.Gj.

Kriteri:	Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar neni 124, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.24, datë 02.09.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar pika 57.1, si dhe Manuali i Kontrollit Tatimor, Kapitulli IIpika 2.1 dhe 2.2.
Ndikimi:	Krijimi i të ardhurave të **munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 3,055,466 lekë**.
Shkaku:	Mos analizim nga inspektori kontrollit e: çmimit të shitjes së produktit gazoil,

	analizës së lëvizjes së bilancit materiale si dhe moszbatim i Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të merren masa nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, që pasi të ketë analizuar mangësitë dhe parregullsitë e konstatuar në procedurën e kontrollit tatimor nga auditimi i KLSH duke nxjerrë përgjegjësitë konkrete, të propozojë në DPT rikontroll tatimor ndaj subjektit duke nxjerrë vlerësim tatimor me qëllim arkëtimin e vlerave të llogaritura nga auditimi i KLSH në shumën **3,055,466 lekë**.

Observacion i subjektit me Nr. 544/25, datë 20.12.2021 mbi Projekt Raportin nr. 544/22 datë 25.11.2021.

Pretendimi i Subjektit: *Lidhur me Raportin e Kontrollit mbajtur për subjektin "A." SHPK, sqarojë se:*

1- Blerje Naftë për periudhën 01.04.2018- 31.12.2018 është 7,289,536 litra.

Në inventarin kontabël në datën 31.12.2018 gjendja është 72,845 litra, pasi nuk është pasqyruar magazina me adresë në Vaqar në akt konstatimi.

2- Diferencat për artikullin Naftë janë si pasojë e firove ligjore të cilat mbarten nga kontrolli i kaluar.

3. Diferencat për artikullin Benzinë janë si pasojë e firove ligjore të cilat mbarten nga kontrolli i kaluar.

4.Lidhur me arsyetimin e shitjes nën kosto kjo nuk qëndron pasi analiza është bërë sipas blerjeve mujore.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Observacioni nuk merret në konsideratë pasi nuk janë paraqitur fakte apo argumente shtesë nga ato të paraqitura në observacionet e bëra ndaj aktkonstatimit dhe trajtuar në Projektraport.

Titulli gjetjes:	Moszbatim i manualit të kontrollit. Mungesë analizë e detajuar se nga është marrë burim i të ardhurave për likuidimin e detyrimeve ndaj institucioneve të kredisë.
Situata	Subjekti ñP.òSHPK, me NIPT- K. Objekt aktiviteti: ñProdhim tregtim të profileve të ndryshme metalike.. etj.ò. Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit I. P.. Nga auditimi i **praktikës/dokumentacionit zyrtar (fizik)** konstatohet: - Njoftimi i Kontrollit Nr.8305/1, datë 26.09.2018 nuk ka konfirmim nga subjekti për marrjen dijeni të kontrollit. - Bashkangjitur praktikës mungon Formulari 3. - Raporti i kontrollit nuk përmban bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij ñFormulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollitò jo në përputhje me Manualin Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6. - P/raporti dhe Raporti janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2. - Procesverbalet e mbajtura gjatë kontrollit nuk gjenden bashkangjitur praktikës. Nga analiza e zërave të pasqyrës financiare konstatohet se: ñDetyrime afatgjataò në pasiv të bilancit paraqiten në shumën 242,287,076 lekë, e cila përbëhet nga ñHuatë afatgjataò, që përfaqëson hua të mare në BKT bankë. Grupi i pasivit ñKapitaliò i paraqitur në bilancin e këtij viti ushtrimore është në shumën prej 586,603,131 lekë. Subjekti ka realizuar likuidime duke ulur zërin ñDetyrimeve ndaj institucioneve të kredisëò përkatësisht për: - vitin 2015 në vlerën 610,327,778 lekë - vitin 2016 në vlerën 443,913,409 lekë - vitin 2017 në vlerën 205,596,169 lekë. Nga ana inspektorit nuk është bërë një analizë e detajuar se nga është marrë ky burim të ardhurash për likuidimin e këtij zëri në vite, pasi sipas analizës së PASH së realizuar nga

	grupi i auditimit subjekti nuk i justifikon këto likuidime. - *Veprimet e sipërme janë kompetencë e inspektorit të kontrollit z. I. P..*
Kriteri:	Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 18 pika 1 si dhe Manuali i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 dhe 2.2.
Shkaku:	Moszbatim i manualit të kontrollit, mos analizim i hollësishëm nga ana e inspektorit të burimit të ardhurave për likuidimin e detyrimeve afatgjata, në kushtet kur subjekti nuk i justifikon këto likuiditete me të ardhurat e realizuara si dhe mos zbatim të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, Manuali i Kontrollit Tatimor,
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të merren masa nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, që pasi të ketë analizuar mangësitë dhe parregullsitë e konstatuar në procedurën e kontrollit tatimornga auditimi i KLSH duke nxjerrë përgjegjësitë konkrete, të propozojë në DPT rikontroll tatimor ndaj subjektit duke nxjerrë vlerësim tatimor me qëllim arkëtimin e vlerave.

Observacion i subjektit me Nr. 544/25, date 20.12.2021 mbi Projekt Raportin nr. 544/22 datë 25.11.2021.
Pretendimi i Subjektit: *1-Lidhur me hedhjen e formularëve me vones në sistem kjo ka ndodhur pasi kam qenë i angazhuar me kontrolle të tjera, 2-lidhur me grupin e pasivit Kapitali ne bilanc në shumën 586,603,131 lekë është detyrime ndaj institucionit të kredisë dhe përfaqëson detyrimet për overdraft prandaj nuk mund të bëhet analiza e detajuar e këtij zëri.*
Bashkëlidhur kopje e kontratave te kredisë.
Qëndrimi i Grupit të Auditimit: *lidhur me p*ikën 1, ju sqarojmë se duhet ti përmbaheni manualit të kontrollit, lidhur me pikën 2, nga se vërehet lidhur me transaksionet e shpeshta të subjetit dhe ndryshimit në zërat e huasë, për saktësimin e plotë të veprimeve financiare për përdorimin ose burimin e të ardhurave, për likuidimin si dhe kreditimin e këtyre vleravë është propozuar kalimin për rikontroll të subjektit. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Titulli gjetjes:	Moszbatim i manualit të kontrollit. Mos verifikim i zëri ñ*debitor e kreditor të tjerë* ñdhe mos raportimin e burimit të tyre në RAD *(Raportim i aktivitetit të dyshimtë)* në organet kompetente.
Situata 1:	Subjekti ñK.òSHA me NIPT- J. <u>Objekt aktivitetiò</u> Import eksport të pjesëve të këmbimit etj.....ò. Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit S.T.. Nga auditimi i **praktikës/dokumentacionit zyrtar (fizik)** konstatohet: -Kontrolli është kryer në tejkalim të afatit të parashikuar në programin e kontrollit, me afat 448 orë/56 ditë, pasi kontrolli ka filluar me datë 23.09.2019 dhe ka përfunduar në datë 05.02.2020, më shumë se 56 ditë pune. -P/raporti dhe procesverbalet e mbajtura për kontrollin e ushtruar janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2. -Raporti i kontrollit nuk përmban bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij ñFormulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollitò, jo në përputhje me Manualin Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6. - Nga analiza e bilancit të vitit 2018 rezulton se në pasiv të bilancit në zërin ñ***debitor e kreditor të tjerë***ò është pasqyruar në shumën 416,764,482 lekë. Sipas raportit të kryer nga ana e inspektorit citohet se në bilancin e vitit 2016 zëri ñ***debitor e kreditor të tjerë***ò paraqitet ne shumen 335,282,685 lekë dhe se kjo llogari është sistemuar në bazë të raport-kontrollit të mëparshëm të kryer nga inspektori i DTM. Nga grupi i auditimit u verifikua analiza e kryer nga inspektori i mëparshëm dhe për këtë zë në bilan citohet se: ñPër veprimet e kryera ndërmjet llogarive 401 dhe 467 shoqëria në bilancin e vitit 2016 duhet të pasqyrojë si çelje të bilancit për llogarinë 467 shumën 261,456,685 leke....ò, pra jo në vlerën 335,282,685 lekë që citohet në raportin e kontrollit.

	Sa më sipër diferenca prej 155,307,797 lekë (416,764,482 - 261,456,685**)** vlerë e cila është shtuar në periudhën e kontrolluar, nga ana e inspektorit nuk është kryer një analizë dhe nuk është dhëne asnjë shpjegim në lidhje me krijimin e këtyre të ardhurave, te cilat i janë dhëne hua shoqërisë. Nuk ka asnjë informacion nëse ka kontratat të lidhura midis palëve, afatet e huadhënies, mënyra e kryerjes se transaksioneve (me Banke apo Cash) ,etj. Në total detyrimet për huatë e mara nga subjekti nga ñkreditorë të tjerëò rezultojnë në vlerën ***416,764,482 lekë***, te cilat në mungese të dokumentacionit justifikues përkatës si dhe mënyrës së kryerjes së transaksioneve mund te konsiderohen fitime të pa deklaruara në vite. Nga inspektori duhet të ishte bërë raportim RAD (Raportim i aktivitetit të dyshimtë) në organet kompetente., në zbatim të Ligjin Nr.9917, datë 19.5.2008 ñPër parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmitò i ndryshuar neni 18.1 si dhe me UMF Nr.16, datë 16.2.2009, neni 2, pika 3 dhe neni 5.
Kriteri:	Ligji Nr.9917, datë 19.5.2008 ñPër parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmitò i ndryshuar neni 18.1 si dhe me UMF Nr.16, datë 16.2.2009, neni 2, pika 3 dhe neni 5.
Ndikimi:	Mos raportimi nga DTM sipas legjislacionit të burimit të shumave të raportuara në zërin ñ*debitorë e kreditorë të tjerë*ò të pasqyruara nga subjekti në pasqyrën e pozicionit financiar.
Shkaku:	Mungesë analize së burimit të të ardhurave nga inspektori në raportin e kontrollit dhe dërgimin e tyre për RAD.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të merren masa nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, për dërgimin e informacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, mbi burimin për detyrimet ñhuatë e mara nga subjekti nga kreditorë të tjerëò në vlerën **416,764,482 lekë,** për të cilën mungojnë shpjegime dhe dokumentacioni justifikues përkatës, si dhe informacioni në lidhje me mënyrën e kryerjes se transaksioneve midis palëve.

Titulli gjetjes:	Moszbatim i manualit të kontrollit. Diferenca në inventar dhe në bilancin material.
Situata 1:	Subjekti ñM. T.ò SHA, me NIPT- J . <u>Objekt aktiviteti</u> ñ Prodhim dhe tregtim mielli import-eksportò. Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit A.T.dhe L.M.. Nga auditimi i **praktikës/dokumentacionit zyrtar (fizik)** konstatohet: - Referuar Formularit 1ñRaporti i vizitës së kontrollitò, kryerja e kontrollit figuron datë 01.09.2018-11.02.2018 (lapsus) në një kohë që sipas Programit ñafati i kryerjes së kontrollit nga momenti i paraqitje në subjekt 529 orë pune/66.1 ditëò dhe momenti i paraqitjes në subjekt konsiderohet mbajtja e procesverbalit të inventarizimit datë 01.08.2018. Kjo datë konsiderohet dhe data e fillimit të kontrollit. Për pasojë kryerja e kontrollit është bërë në tejkalim të afatit të vendosur në Program. - Raporti i kontrollit nuk përmban bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij ñFormulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollitò, jo në përputhje me Manualin Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6. - P/raporti dhe procesverbalet e mbajtura për kontrollin e ushtruar janë hedhur me vonesë në C@ts, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2. - P/raporti dhe Raporti janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2. **-** Në raportin e kontrollit inspektori nuk është shprehur në lidhje me referencat doganore të subjektit për vitet objekt kontrolli. Mos pasqyrimi i referencave doganore në raport kontrolli vështirëson përllogaritjen e kostos së mallit të shitur të pasqyruar në PASH dhe krahasimin e saj me shpenzimet e deklaruara nga subjekti sipas FDP-së në sistemin C@TS. Grupi i auditimit, bazuar në analizën e bilancit material dhe kostos për ñLëndë e parëò dhe ñProdukte të Gatshëm & nënprodukteò të kryer nga inspektor dhe duke e krahasuar me gjendjen kontabël të pasqyruar nga subjekti dhe inventarin fizik të dorëzuar nga

subjekti në sistemin tatimor C@TS u konstatuan diferenca.
- Më poshtë paraqitet gjendja kontabël dhe vlera e tatueshme me kosto, sipas analizës së bërë nga inspektori për vitin 2015:

Emërtimi	Gjendja kontabël 31.12.2015	**Kosto magazinë /kg**	Vlera e tatueshme
Grurë	15,328,872	27	413,879,544
Miell 00	81,512	44	3,586,528
Miell 00 (1kg)	12,670	44	557,480
Miell 0 (Blu 1kg)	9,270	44	407,880
Miell 45 (50kg)	74,961	42	3,148,362
Miell 45 (25kg)	68,808	42	2,889,936
Miell 45 (1kg)	22,855	42	959,910
Miell 50 (50kg)	74,604	40	2,984,160
Miell 50 (25kg)	135,942	40	5,437,680
Miell 70 (50kg)	77,000	38	2,926,000
Miell 90 (25kg)	71,258	36	2,565,288
Farina (25kg)	38,190	34	1,298,460
Hime	36,957	10	369,570
Hime	9,100	9	81,900
		Totali	**441,092,698**

Në bilanc vlera ñlënde e parëò është në shumën 380,808,303 lekë dhe ñProdukte të Gatshëm & nënprodukteò në vlerën 27,213,408 lekë, në total 408,021,711 lekë.
Diferenca nga krahasimi rezulton në vlerën 33,070,987 lekë.
Për sa më sipër diferencat e konstatuara prej 33,070,987 lekë rezultojnë të jenë shitje malli të padeklaruara nga subjekti, duke shtuar një marzhi mesatar të fitimit prej 13% rezulton në vlerën e tatueshme të shitjes pas rivlerësimit prej 37,370,215 lekë. ku në zbatim të Nenit 124 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, *mos lëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i mos lëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore"* subjektit i lindin detyrimet si më poshtë:

Detyrim TVSH ,370,215 lekë * 20% = 7,474,043 Lekë
Gjobë TVSH (100% e detyrimit) = 7,474,043 Lekë
Detyrimi **14,948,086 Lekë**

Detyrim TF 37,370,215 lekë *15% = 5,605,532 Lekë
Gjobë TF (100% e detyrimit) = 5,605,532 Lekë
Detyrimi **11,211,065 Lekë**

- Më poshtë paraqitet gjendja kontabël dhe vlera e tatueshme me kosto sipas analizës së bërë nga inspektori për vitin 2016:

Nr. ren	**Emërtimi**	**Nj.m**	**Gjendja kontabël 31.12.2016**	**Kosto magazinë /kg**	Vlera e tatueshme
1	Grurë	Kg	15,627,568	23.72	370,685,913
2	Miell 00	Kg	102,218	42.11	4,304,400
3	Miell 00 (1kg)	Kg	2,275	43.64	99,281
4	Miell 0 (Blu 1kg)	Kg	8,524	41.78	356,133
5	Miell 45 (50kg)	Kg	91,823	39.25	3,604,053
6	Miell 45 (25kg)	Kg	21,105	39.43	832,170
7	Miell 45 (1kg)	Kg	3,498	40.64	142,159
8	Miell 50 (50kg)	Kg	178,929	38.16	6,827,931
9	Miell 50 (25kg)	Kg	89,487	38.19	3,417,509
10	Miell 70 (50kg)	Kg	53,520	35.32	1,890,326
11	Miell 90 (25kg)	Kg	56,838	33.43	1,900,094
12	Farina (25kg)	Kg	59,200	32.65	1,932,880
13	Hime	Kg	450,067	10.03	4,514,172
14	Hime tr	Kg	69,130	9	622,170
				Totali	**401,129,190**

Në bilanc dhe në inventarin fizik të dorëzuar nga subjekti vlera ñlënde e parëò është në shumën 368,666,879 lekë dhe ñProdukte të Gatshëm & nënprodukte ñnë vlerën 29198248 lekë, në total 397,865,127 lekë, Diferenca nga krahasimi rezulton në vlerën 3,264,063 lekë.
Për sa më sipër diferencat e konstatuara prej 3,264,063 lekë rezultojnë të jenë shitje malli të padeklaruara nga subjekti, duke shtuar një marzhi mesatar të fitimit prej 7%

rezulton në vlerën e tatueshme të shitjes pas rivlerësimit prej 3,492,547 lekë, ku në zbatim të Nenit 124 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, mos lëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo ʻ faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i mos lëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimoreò subjektit i lindin detyrimet si më poshtë:

Detyrim TVSH 3,492,547 lekë * 20% = 688,510 Lekë
Gjobë TVSH (100% e detyrimit) = 698,510 Lekë
Detyrimi **1,397,019 Lekë**

Detyrim TF 3,492,547 lekë *15% = 523,882 Lekë
Gjobë TF (100% e detyrimit) = 523,882 Lekë
Detyrimi **1,047,764 Lekë**

- Më poshtë paraqitet gjendja kontabël dhe vlera e tatueshme me kosto sipas analizës së bërë nga inspektori për vitin 2017:

Emërtimi	NJ.M	Gjendja kontabël 31.12.2017	**Kosto magazinë /kg**	Vlera e tatueshme
GRURE	Kg	9,984,176	23.43	233,929,244
GRURE 2	Kg	1,882,960	23.53	44,306,049
Miell 00	Kg	63,625	38.41	2,443,836
Miell 00 (1	Kg	1,075	42.11	45,268
Miell 0 (Bl	Kg	1,116	38.24	42,676
Miell 45 (5	Kg	116,350	35.42	4,121,117
Miell 45 (2	Kg	25,600	35.35	904,960
Miell 45 (1	Kg	1,147	38.34	43,976
Miell 50 (5	Kg	159,525	34.35	5,479,684
Miell 50 (2	Kg	85,675	35.13	3,009,763
Miell 50 (2	Kg	74,050	36	2,665,800
Miell 70 (5	Kg	26,450	32.38	856,451
Miell 70 (2	Kg	3,000	33.3	99,900
Miell 90 (2	Kg	17,950	31.95	573,503
Farina (25k	Kg	40,700	30.75	1,251,525
Hime	Kg	241,850	10	2,418,500
Hime tr	Kg	0	9	0
			Totali	302,192,251

Në bilanc dhe në inventarin fizik të dorëzuar nga subjekti vlera ñlënde e parëò është në shumën 281,931,471 lekë dhe ñProdukte të Gatshëm & nënprodukteò në vlerën 23,722,591 lekë, në total 305,654,062 lekë, Diferenca nga krahasimi rezulton në vlerën 3,461,811 lekë.

Për sa më sipër diferencat e konstatuara prej 3,461,811 lekë rezultojnë të jenë shitje malli të padeklaruara nga subjekti, duke shtuar një marshi mesatar të fitimit prej 7% rezulton në vlerën e tatueshme të shitjes pas rivlerësimit prej 3,704,138 lekë, ku në zbatim të Nenit 124 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, mos lëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo ʻ faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i mos lëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimoreò subjektit i lindin detyrimet si më poshtë:

Detyrim TVSH 3,704,138 lekë * 20% = 740,828 Lekë
Gjobë TVSH (100% e detyrimit) = 740,828 Lekë
Detyrimi **1,481,655 Lekë**

Detyrim TF 3,704,138 lekë *15% = 555,621 Lekë
Gjobë TF (100% e detyrimit) = 555,621 Lekë
Detyrimi **1,111,241 Lekë**

Veprimet e sipërme janë kompetencë e inspektorit të kontrollit Z. A.T.,Znj. L.M..

Kriteri:	Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 124; Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr.24, datë 02.09.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar pika 57.1, Manuali i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II.
Ndikimi:	Krijimi i të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 31,196,830 lekë.
Shkaku:	Mungesë e analizës nga inspektori në Raport Kontrolli, të bilancit material dhe krahasimit

	të zërit ñlënde e parëò të pasqyruar në bilanc dhe në inventarin fizik të dorëzuar nga subjekti, si dhe mos zbatimi i Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, si dhe Manuali i Kontrollit Tatimor.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të merren masa nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, që pasi të ketë analizuar mangësitë dhe parregullsitë e konstatuar në procedurën e kontrollit tatimornga auditimi i KLSH duke nxjerrë përgjegjësitë konkrete, të propozojë në DPT rikontroll tatimor ndaj subjektit duke nxjerrë vlerësim tatimor me qëllim arkëtimin e vlerave të llogaritura nga auditimi i KLSH në shumën 31,196,830 lekë.

Titulli gjetjes:	Moszbatim i manualit të kontrollit. Diferenca në sasi të shitura, nga krahasimi i deklaratës së eksportit me atë të deklaruar nga subjekti.
Situata	Subjekti ñD. F.ò SHPK, me NIPT- L . Objekt aktiviteti ñ Tregtia me shumicë e fruta perimeveò. Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit V.M.. Nga auditimi i **praktikës/dokumentacionit zyrtar (fizik)** konstatohet: -Raporti nuk ka bashkangjitur si pjesë përbërëse të tij ñFormulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollitò, jo në përputhje me Manualin Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6. -Praktika nuk ka bashkangjitur Formularin ñRaporti i vizitës së kontrollitò, - Nga verifikimi i deklaratës analitike të eksportit për periudhën Dhjetor 2018, rezultoi se për artikullin ñDOMATEò ka diferenca në sasinë e deklaruar nga subjekti me sasinë në deklaratën e eksportit në vlerë të tatueshme prej 3,274,150 lekë.

	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Sasi sipas doganës	Diferenca subjekt - dogane	Diferenca në vlerë
1	DOMATE	Kg	251,651	75,53	19,006,355	295,000	-43,349	-3,274,150
			Totali					-3,274,150

Pra në përfundim rezulton se diferenca në vlerë të tatueshme në shumën 3,274,150 lekë eksport pa faturë *(shitje pa faturë) për artikulli*

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

Udhëzimin Nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar pika 57.1, ku përcaktohet: *"Personat e tatueshëm, subjekte te tatimit mbi vlerën e shtuar apo te tatimit mbi fitimin, janë te detyruar te mbajnë llogari, regjistrime dhe regjistra për te gjitha ngjarjet dhe veprimet qe përfshijnë furnizimet e kryera nga ana e tyre, furnizimet e marra prej tyre nga persona te tjerë, për te gjitha importet nga jashtë vendit dhe eksportet për jashtë vendit, në përputhje me dispozitat e Ligjit "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", dhe me aktet e tjera te nxjerra në zbatim të tij"*

- Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008ñPër Procedurat Tatimore të Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar, Nenin 124, ku përcaktohet qartë se: *"Mos lëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i mos lëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore".* Nga ku subjektit i lindin detyrime si vijon:

Detyrim TF 3,274,150 lekë * 15% = 491,122 Lekë

Gjobë TF (100% e detyrimit) = 491,122 Lekë

Detyrimi **982,245 Lekë**

Veprimet e sipërme janë kompetencë e inspektorit të kontrollit znj. V.M. dhe znj.*Edona Kraja.*

Kriteri:	Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, Nenin 124; Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr.24, datë 02.09.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar pika 57.1, Manuali i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II pika 2.1 dhe 2.2.

Ndikimi:	Krijimi i të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 982,245 lekë.
Shkaku:	Mos zbatim i Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, si dhe Manuali i Kontrollit Tatimor.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të merren masa nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, që pasi të ketë analizuar mangësitë dhe parregullsitë e konstatuar në procedurën e kontrollit tatimornga auditimi i KLSH duke nxjerrë përgjegjësitë konkrete, të propozojë në DPT rikontroll tatimor ndaj subjektit duke nxjerrë vlerësim tatimor me qëllim arkëtimin e vlerave të llogaritura nga auditimi i KLSH në shumën **982,245** lekë.

Observacion i subjektit me Nr. 544/25, date 22.12.2021 mbi Projekt Raportin nr. 544/22 datë 25.11.2021 si dhe ankesa me nr 544/26 datë 21.12.2021.

Pretendimi i Subjektit: *Lidhur me Raportin e Kontrollit mbajtur për subjektin "***D. F.***" SHPK, arsyetoj se: Lidhur me konstatimin për diferencën e konstatuar në muajin dhjetor 2018 midis deklaratës analitike të eksporteve nga dogana dhe bilancit material pasqyruar në raport kontrolli ju informojë se u jam referuar faturave të shitjes dhe deklarimeve të subjektit, por kjo diferencë vjen për shkak të sistemit doganor.*

Për kryerjen e kontrollit jemi caktuar dy inspektore V.M. dhe E. K., pse duhet të mbajë vetëm një inspektor përgjegjësi?

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nuk janë paraqitur fakte apo argumente shtesë nga ato të paraqitura në observacionet e bëra ndaj aktkonstatimit dhe trajtuar në Projektraport.

Lidhur me ushtrimin e kontrollit nga grupi i auditimit duke qenë se kryesisht për pasqyrimin e inspektorve të cilat kanë kryer kontrollin, i është referuar ngarkimit të materialit në sistemin C@TS, pasi u paraqit njoftimi për kontroll do të bëhen ndryshimet duke shtuar edhe inspektoren znj.*E. K.*. Observacioni juaj merret pjesërisht në konsideratë.

Titulli gjetjes:	Diferenca e KMSH me vlerën e reflektuar në ñPasqyrë e Performancësò në zërin ñLënda e parë dhe materiale të konsumueshmeò.
Situata	Subjekti ñI.òSHPK, me NIPT-K.. <u>Objekt aktiviteti</u> Ndërtime ndustriale Prodhim dhe tregti elemente të parafabrikuara etj...ò. Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit A.D.. -P/raporti, Raporti dhe procesverbalet mbi kontrollin e kryer janë hedhur me vonesë në C@ts. jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2. - Nga analiza e tatim fitimit për vitin 2014 të bërë nga grupi i auditimit rezultoi se KMSH është më e ulët se vlera e reflektuar në ñPasqyrë e Performancësò në zërin ñLënda e parë dhe materiale te konsumueshmeò. Në faqen 136 të Raportit të kontrollit, inspektori ka analizuar KMSH duke bërë krahasimin e blerjeve sipas sistemit (blerje të deklaruara në FDP-të e TVSH-së) dhe shpenzime sipas ñPasqyrë e Performancësò. Nga analiza e zërave të përllogaritur nga inspektori konstatohet se ndryshimi i gjendjes së produktit të gatshëm dhe prodhimit në proces është reflektuar në zbritje dy herë. Ne diferencën e konstatuar PDF/PASH në vlerën 99,003,513 lekë, të analizuar nga inspektori, konstatohet se vlera prej 4,297,056 lekë õNdryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në procesô është zbritur përsëri duke e përfshirë në vlerën totale të ndryshimit të gjendjes së mallit prej 7,997,421 lekë. Sa më sipër rezulton shpenzime më shumë në pasqyrën e performancës me një diferencë prej 4,297,056 lekë, ku në zbatimi të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 i ndryshuar neni 21 pika 1/l, si dhe Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 115 ñ*Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një*

	periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike", detyrimet e subjektit për këtë diferencë paraqiten si vijon: Detyrim për tatim fitimin 4,297,056 lekë * 0.15 = 644,558 lekë Penaliteti në masën 0.06% në ditë 644,558 lekë * 0.06%*365 = 141,158 lekë **Totali i detyrimit** **785,717 lekë** ***Për vitin 2015***, në faqen 150 të Raportit të kontrollit, inspektori ka analizuar KMSH për vitin 2015 duke bërë krahasimin e blerjeve sipas sistemit (blerje të deklaruara në FDP-të e TVSH-së) dhe shpenzime sipas ñPasqyrë e Performancësò. Nga analiza e zërave të përllogaritur nga inspektori konstatohet se ñndryshimi i gjendjes së produktit të gatshëm dhe prodhimit në procesò është reflektuar në zbritje dy herë. Ne diferencën e konstatuar PDF /PASH në vlerën 135,084,316 lekë, të analizuar nga inspektori, konstatohet se vlera prej 34,724,549 lekë ôNdryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në procesô është zbritur përsëri duke e përfshirë në vlerën totale të ndryshimit të gjendjes së mallit prej -47,293,240 lekë. Sa më sipër rezulton shpenzime më shumë në pasqyrën e performancës me një diferencë prej 34,724,549 lekë, ku në zbatimi të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 i ndryshuar neni 21 pika 1/l ñçdo shpenzim, masa e të cilit nuk vërtetohet me dokumente nga tatimpaguesiné òò, si dhe Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 115 ñ*Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike*ò, detyrimet e subjektit për këtë diferencë paraqiten si vijon: Detyrim për tatim fitimin 34,724,549 lekë *0.15 = 5,208,682 lekë Penaliteti në masën 0.06% në ditë 5,208,682 lekë *0.06%*365 = 1,140,701 lekë **Totali i detyrimit** **6,349,364 lekë** *Veprimet e sipërme janë kompetencë e inspektorit të kontrollit z. A.D..*
Kriteri:	Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 i ndryshuar neni 21 pika 1/l, Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar. neni 115.
Ndikimi:	Krijimi i të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 7,135,081 lekë
Shkaku:	Mos zbatimi i Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të merren masa nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, që pasi të ketë analizuar mangësitë dhe parregullsitë e konstatuar në procedurën e kontrollit tatimornga auditimi i KLSH duke nxjerrë përgjegjësitë konkrete, të propozojë në DPT rikontroll tatimor ndaj subjektit duke nxjerrë vlerësim tatimor me qëllim arkëtimin e vlerave të llogaritura nga auditimi i KLSH në shumën **7,135,081** lekë.

Observacion i subjektit me Nr. 544/27, date 22.12.2021 mbi Projekt raportin e Auiditimit si dhe ankesa me nr 544/27 datë 22.12.2021.

Pretendimi i Subjektit: *Lidhur me Raportin e Kontrollit mbajtur për subjektin "***I.***" SHPK, arsyetoj se: Lidhur me konstatimin për diferencën e konstatuar në zërin* ôNdryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në procesô për vitin 2014 dhe 2015 sqaroj se referuar SKK 4 zëri inventarët kosto paraqitet sipas formatit 1, pra bazuar ne SKK4 rritja e gjendjes së produktit të gatshëm pasqyrohet si paksim i shpenzimeve.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Grupi i auditimit ka realizuar analizën e fdp dhe PASH mbi te dhënat në raport kontrolli , pasqyrat financiare të subjektit dhe dokumenteve të cilat gjenden në sistemin C@ts. Në zbatim të standardeve të SKK saç është sqaruar dhe në materialin e spërcituar kemi të bëjmë me mosnjohje të ôNdryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në procesô, për vitin 2014 dhe 2015 në pasqyrën e të ardhurave dhe

shpenzimeve ka rezultuar me efekt zero, veprim i cili nuk është konstatuar në vitet pasardhëse të cilat janë kontrolluar nga inspektori, por pasqyrimi i ôNdryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në procesô ka dhënë efektet e tij (me +ose -). Sa më sipër observimi juaj nuk merret në konsideratë.

Titulli gjetjes:	Mungesë të lejes së Ndërtimit të HEC-it si dhe kreditimi i TVSH-së nga subjekti në shkelje të ligjit.
Situata	Subjekti ñA.E.**”** SHA, me NIPT-... <u>Objekt aktiviteti : ñ</u>Tregti e energjisë elektrike....ò Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit N.H. Nga auditimi i **praktikës/dokumentacionit zyrtar (fizik)** konstatohet: -P/raporti, Raporti dhe procesverbalet mbi kontrollin e kryer janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2. - Nga auditimi i raportit te kontrollit u konstatua se objekti i kontrollit nga ana e DTM për tatimpaguesin ñA.E.iò me Nipt L..ka qenë verifikimi i punimeve të kryera, nëse janë në përputhje me afatet e lejes së ndërtimit. Në rast konstatimi të shkeljes së afatit të lejes së ndërtimit, duhej të propozohej kontrolli i thelluar. Në shkresën nr.06 prot të AKBN drejtuar DPT më date 27.09.2019 thuhet se AKBN ka kryer verifikime në lidhje me HEC-et, të cilave iu mungon leja për kryerjen e punimeve të ndërtimit. Mungesa e lejes ndikon në kufizimin e të drejtës së kreditimit të TVSH-se, për ato punime që janë kryer pa leje apo në shkelje të saj. Sipas Nenit 20, pika d, të Udhëzimit Ministrit Financave nr. 6, datë 30.01.2015 "*Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë* ", i ndryshuar. *d) Për çdo punim në ndërtim të kryer në shkelje të lejes përkatëse të ndërtimit të lëshuar nga autoritetet e fushës, ose çdo punim të kryer përpara se leja përkatëse e kërkuar nga legjislacioni i fushës, të jetë lëshuar, personi i tatueshëm ndërtues është i detyruar të paguajë TVSH për pjesën e punimeve të kryera, por ndërkohë atij nuk i lejohet të zbresë TVSH-në për blerjet e kryera që i korrespondojnë situacioneve (pjesës së punimeve) në fjalë, përsa për kryerjen e punimeve nuk janë respektuar kërkesat dhe dispozitat ligjore të fushës përkatëse. Nga ana tjetër investitorit të objektit, nëse e ka zbritur TVSH-në e punimeve të kryera prej personit të tatueshëm ndërtues, nuk i lejohet të zbresë TVSH-në përkatëse të punimeve të ndërtimit të kryera në kushtet e shkeljes.* Tatimpaguesi është pajisur me leje ndërtimi nr. 5, datë 20.12.2012 dhënë nga Këshilli Kombëtar i Territorit, punimet duhet të përfundonin brenda vitit 2017. Në kontrollin e kryer në subjekt më datë 25.11.2019 nga inspektori i DTM z. N.H., rezulton që ka mungesë të lejes së Ndërtimit të HEC-it pas këtij afati si dhe konstatohet paligjshmëri kreditimi vetëm për dy situacione, konkretisht nr. 64 dhe nr.65, në periudhën Janar dhe Shkurt 2018. **Në total shuma e TVSH-së për dy faturave është 3,665,217 lekë.** Në kontrollin tatimor nga DTM në datë 25.11.2019 thuhet se në rast konstatimi të shkeljes së afatit të lejes së ndërtimit, duhej të propozohej kontrolli i thelluar. Pavarësisht konstatimit të shkeljes nuk është propozuar kontroll i thelluar për periudhat pasardhëse dhe deri më sot nuk është parashikuar ndonjë kontroll në të për këtë tatimpagues. Ndërsa për situacionet pasardhëse inspektori N.H. nuk ka shprehur qëndrimin zyrtar mbi ligjshmërinë e kreditimit të TVSH-së në mungese të lejes së ndërtimit. Nga kontrolli i dosjes rezulton se pas përfundimit të lejes së ndërtimit të HEC-it , tatimpaguesi në fjalë ka pasur aktive deri më date 31.12.2018 një leje zhvillimi të ndërtimit të rrugëve të fshatit Bukëmirë. Nga kontrolli në sistemin C@TS për periudhën Mars 2018 është konstatuar një faturë me datë 20.03.2018, ku është kryer një blerje të investimeve me furnitor vendas nga tatimpaguesi ñS. M.ò me NIPT :L..me vlerë TVSH-je të zbritshme 17,955,495 Lekë, edhe pse leja e ndertimit të HEC-it kishte përfunduar, blerja është kryer tek një kompani e cila sipas ekstraktit të QKB ka si objekt veprimtarie ñ*Prodhimi dhe montimi në lidhje me*

	materialet e nevojshme në ndërtimin e hidroçentraleve duke nisur nga tubat e fuqishme për kalimin e ujit, valve me rreshqitje, valvola flutur, valvola kon, kapake ëikale, kapake për mbrojtjen nga rreziqet si dhe të zgarave." **Për vlerën e tvsh së zbritshme prej 17,955,495 lekë shoqërisë duhet ti hiqet kreditimi**. Gjithashtu, ndaj këtij subjekti duhet aplikuar gjobat në zbatim të ligjit nr.9920 dt 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republiken e Shqiperisëò, i ndryshuar neni 115, shoqeria duhet dënohet me 0.06% të vlerës së tvsh, pra në shumën 861,163 lekë. *Veprimet e sipërme janë kompetencë e inspektorit të kontrollit z. N.H.j*
Kriteri:	Ligji nr.92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, neni 25. Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 6, datë 30.01.2015, i ndryshuar, nenit 20, pika d. Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 115.
Ndikimi:	Krijimi i të ardhurave të munguara në buxhetin e **shtetit në vlerën 21,887,748 lekë**.
Shkaku:	Mos zbatim i Ligjit nr. 92/2014 Udhëzimit MF nr. 6, i ndryshuar.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	- Të merren masa nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, që pasi të ketë analizuar mangësitë dhe parregullsitë e konstatuar në procedurën e kontrollit tatimornga auditimi i KLSH duke nxjerrë përgjegjësitë konkrete, të propozojë në DPT rikontroll tatimor ndaj subjektit duke nxjerrë vlerësim tatimor me qëllim arkëtimin e vlerave të llogaritura nga auditimi i KLSH në shumën **21,887,748** lekë.

Observacion i subjektit me Nr. 544/25, datë 20.12.2021 2021 mbi Projekt Raportin nr. 544/22 datë 25.11.2021.
Pretendimi i Subjektit: *1-Lidhur me konstatimin e shkeljes për kreditimin e TVSh-së në muajin Mars 2018 për investime, ku afati i lejes së ndërtimit është deri ne 31.12.2017 ju informojë se ky faturim është për mirëmbajtjen e tubacioneve dhe jo për pjesën e ndërtimit.*
Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nuk janë paraqitur fakte apo argumente shtesë nga ato të paraqitura në observacionet e bëra ndaj aktkonstatimit dhe trajtuar në Projektraport. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

- Subjekti **"D. G.**ò SHA me NIPT-J.
Objekt aktiviteti ñImport eksport i të gjitha llojeve të gazit...ò.
Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit z. Dh.S.
Nga auditimi i **praktikës/dokumentacionit zyrtar (fizik)** konstatohet:
-Njoftimi i Kontrollit Nr. 5190/1, datë 23.07.2019 nuk ka konfirmim nga subjekti për marrjen dijeni të kontrollit.
-P/Raporti dhe Raporti përfundimtar janë hedhur me vonesë në sistem jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2[8], pasi P/Raporti është përgatitur me datë 17.9.2019,hedhur në sistem datë 19.9.2019.
-Raporti i kontrollit nuk përmban bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij ñFormulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollitò i cili i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81, pika 3, brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (shtojca1) me Udhëzimin e Ministrisë së

[8] ñInspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve ***C@TS*** gjithçka... Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proçes-verbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem **jo më vonë se dita e nesërme e punës"**.

Financave Nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, jo në përputhje me Manualin Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.

Veprimet e sipërme janë kompetencë e inspektorit të kontrollit Dh.S..

- Subjekti ñ**L.**òSHPK:

NIPT- K.

Objekt aktiviteti ñGrumbullim, përpunim e tregtim të bulmetit etj....ò.

Nga auditimi i **praktikës/dokumentacionit zyrtar (fizik)** konstatohet:

- Raporti nuk ka bashkangjitur si pjesë përbërëse të tij ñFormulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollitò, jo në përputhje me Manualin Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.
- P/raporti nuk është hedhur në sistemin C@TS.
- Raporti dhe procesverbalet mbi kontrollin e kryer janë hedhur me vonesë në C@TS jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2.

Sa më sipër arrihet në konkluzion:

Nga auditimi i veprimtarisë së DTM përkontrollin në vend për vitet 2018-2020 mbi Raportet e Kontrollit Tatimor për të cilat janë konstatuar diferenca në vlerë (të cituara më sipër) si dhe për ato raportet e kontrollit të tërhequra nga ana e grupit ndaj të cilave nuk janë konstatuar diferenca në vlerë, rezultojnë me problematikat e mëposhtëme:

- → Raportet e kontrollit nuk përmbajnë bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij ñFormulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollitò i cili i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81, pika 3, brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (shtojca1) me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, jo në përputhje me Manualin Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6[9].
- → Në disa raste, të kontrolleve për rimbursim, përgatitja e Raport Kontrollit/Projektit dhe Raportit Përfundimtar te kontrollet bëhet në tejkalim të afatit 5 ditor, jo në përputhje me UMF Nr.24, datë 02.09.2008 ñPër procedurat tatimore në RSHò, pika 75.1, pika 2.5.2[10] dhe Manualin Kapitulli II, pika 2.1.2[11].
- → Në disa raste, në kontrollet e planifikuara, përgatitja e Raport Kontrolli/Projekti dhe Raportit Përfundimtar bëhet në tejkalim të afatit 7 ditor, jo në përputhje me Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar neni 83-84/1 dhe Manualin, Kapitulli II, pika 2.3 dhe 2.5.
- → Raportet e Kontrollit në shumicën e rasteve nuk kanë bashkangjitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e kontrollit si p.sh.: intervista me tatimpaguesin, apo aktet nuk hidhen të gjitha në sistemin C@TS, veprim jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.8/b[12], Kapitulli VII, pika 7.1[13]. Kapitulli II, pika 2.8/b dhe Kapitulli VII, pika 7.

---

[9] "Modeli i Njoftimit për Kontroll Tatimor është sipas formularit ñNjoftim Kontrolli Tatimorò ..... Formulari-pyetësor që i vihet në dispozicion së bashku me njoftimin për kontroll, brenda 30 ditëve, është sipas formatit të miratuar me Udhezimin e Ministrit të Financave.ò.

[10] "Me qëllim respektimin e afateve të rimbursimit të TVSH-së, në rastet kur tatimpaguesi i nënshtrohet kontrollit tatimor, afati për përfundimin e Raportit të Kontrollit nga inspektori/inspektorët është, jo më shumë se 5 ditë kalendarike pas përfundimit të tijò.

[11] "Në rastin kur tatimpaguesi, i cili ka kërkuar rimbursim, i nënshtrohet kontrollit, sipas analizës së riskut, me qëllim respektimin e afatit të rimbursimit, sipas këtij neni, afatet e përcaktuara nga nenet 83 dhe 84 nuk do të zbatohen dhe çdo afat do të jetë 5 ditë kalendarikeò.

[12] "....Këto evidentime të kryera nga inspektori/grupi i kontrollit të mbajtuara shënim apo të siguruara nëpërmjet dokumentacionit mbështetës pasqyrohen nga ana e inspektorit të kontrollit në sistemin informatik të tatimeve C@TSò.

[13] ñNë fillim, kontrollori interviston një përfaqësues të shoqërisë. Intervista fillestare është shumë e rëndësishme dhe është e nevojshme.....formularë të cilat duhet të jenë në fund, pjesë përbërse e praktikës se kontrollit Tatimore të firmosura nga inspektori dhe përfaqësuesi i shoqërisë së kontrolluar...ò

2.4.Përputhshmëria ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara. Niveli i borxhit për çdo vit ushtrimor nën auditim, masat shtrënguese të zbatuara për mbledhjen e borxhit. Ecuria e proceseve gjyqësore lidhur me detyrimet tatimore të vlerësuara.

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
2) Plani operacional vjetor për monitorimin dhe mbledhjen me forcë të borxhit (2018-2020)
3) Evidencat për detyrimet tatimore të papaguara për periudhën 2018; 2019 dhe 2020
4) Evidenca e aktmarrëveshjeve me këste dhe praktikat e tyre
5) Evidenca e masave shtrënguese
6) Çdo dokumentacion i nevojshëm në lidhje me zbatimin e programit
7) Manual i Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë
Çdo dokumentacion i cilësuar i nevojshëm për përpunimin e materialit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:
Administrata Tatimore sipas dispozitave të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, kreu XI, nenet 88-104, ka detyrimin ligjor nëpërmjet ushtrimit të kompetencës të mbledhë detyrimin tatimor të papaguara brenda afateve ligjore sipas burimeve të krijimit. Mbledhja e detyrimeve të papaguara kryhet nga drejtoritë përgjegjëse të mbledhjes me forcë të detyrimeve të papaguara. **Drejtoria/Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara** në DRT ka si objektiv kryesor mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara, menaxhimin e borxhit me qëllim reduktimin e tij dhe mos krijimin e borxhit të ri.
Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DRT është e organizuar dhe funksionon në zbatim ñRregullores së funksionimit të Drejtorive Tatimore Rajonaleò miratuar me Urdhrin e MFE nr.19, datë 22.02.2017.
Detyrat kryesore të kësaj strukture janë:

- ✓ *Përmbush detyrat dhe funksionet duke zbatuar parimin e analizës së riskut, me koston më të ulët të mundshme, ndërkohë që sigurohet respektimi i të drejtave të tatimpaguesve;*
- ✓ *Mban në monitorim dhe ndjek borxhin duke synuar uljen e tij, veçanërisht të borxhit të ri, por edhe atë të vjetër në të njëjtën kohë; etj.*

Drejtoria/Sektori i Menaxhimit dhe Analizës së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Drejtorinë Rajonale ka si objektiv kryesor mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara dhe deklaratave të pa dorëzuara, dhe ka këto funksione:

- <u>Funksioni i menaxhimit të Programit të Detyrimeve të Papaguara dhe Deklaratave të Pa dorëzuara(DePa) sipas sistemit informatik C@TS:</u>

Ky funksion menaxhon procedurat që lidhen me përdorimin e ñProgramit të Detyrimeve të Papaguara dhe Deklaratave të Pa dorëzuaraò dhe zbatimin e hapave të parashikuara për përpunimin e rasteve, përfshirë:

- ✓ *Gjenerimin e rasteve të detyrimeve tatimore te papaguara.*
- ✓ *Gjenerimin e rasteve të deklaratave të pa dorëzuara.*
- ✓ *Kalimin e rasteve të deklaratave tatimore të pa dorëzuara dhe detyrimeve tatimore të papaguara tek inspektorët e mbledhjes nga zyra dhe inspektorët e mbledhjes në terren.*
- ✓ *Menaxhimin e sistemit të informacionit të DePa-s.*

Në zbatim të nenit 68 të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në RSHò i ndryshuar, dy janë aktet administrative tatimore të cilat prodhojnë detyrime tatimore

mospagimi në afat i të cilave, inicion ndërmarrjen e masave shtrënguese për mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor: *Vlerësimi tatimor:*

a) është llogaritja e detyrimit tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore (Njoftim Vlerësimi);

b) në rastet kur shuma e detyrimit tatimor të vetëdeklaruar nuk paguhet, është njoftimi, që kërkon pagesën e detyrimit tatimor në datën e përcaktuar në ligjin përkatës. Analizuar sipas burimit të detyrimit.

Bazuar në Manualin e Mbledhjes, pika 3.3.1, ku përcaktohet: ñ*Çdo muaj, Drejtoria e Mbledhjes me Forcë në Drejtoritë Rajonale duhet t'i dërgojë Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë në DPT raporte, evidenca dhe analiza të cilat pasqyrojnë situatën e borxhit. ...Raportimet periodike mujore të Drejtorive Rajonale duhet të dërgohen në rrugë elektronike brenda datës 8 të çdo muaji pasardhës dhe me postë zyrtare brenda datës 14 të çdo muaji pasardhës pranë DPT/Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë. Raportimet duhet të bëhen sipas evidencave të miratuara*é ò,.

Sistemi C@TS mundëson ekzekutimin e veprimeve automatike të lidhura me menaxhimin e detyrimeve tatimore të papaguara në afat, që në opsionin e sistemit emërtohet ñMbledhje me Forcëò.

Veprimet e mbledhjes, kryhen automatikisht nga sistemi dhe me kalimin e afatit për detyrimet tatimore, procesi i mbledhjes me forcë aktivizohet, dhe të gjitha transaksionet që e kanë kaluar afatin gjenden në sistem.

Viti 2018

Detyrimi Tatimor sipas statusit në datën 31.12.2018 është në shumën 30,240,315 mijë lekë për 310 subjekte nga të cilat:

Subjekte Aktive 238 në shumën 17,172,457 mijë lekë ose 57 % të totalit aktiv ku vetëm dy subjektet O. dhe K. janë me detyrime në shumën 8,139,839 mijë lekë ose 47 % të borxhit të subjekteve aktive;

Subjekte Pasive 72 në shumën 13,067,857 mijë lekë ose 43% të totalit pasiv ku vetëm ñA.ò ka shumën 8,434,597 mijë lekë ose 65% të totalit të subjekteve pasive.

Detyrimi Tatimor në datën 01.01.2018 është në shumën 30,306,801 mijë lekë për 409 subjekte duke pësuar një ulje në shumën 66,486 mijë lekë dhe 99 subjekte më pak në 31.12.2018 në krahasim me fillimin e vitit.

- Subjekte Aktive 332 në shumën 17,148,474 mijë lekë ose 57 % të totalit
- Subjekte Pasive 77 në shumën 13,158,327 mijë lekë ose 43% të totalit

Gjatë vitit 2018 nga detyrimi tatimor është arkëtuar shuma 6,072,690 mijë lekë ose 20 % të detyrimeve tatimore të vitit 2018 .

Tabela nr. 7: *Totali i detyrimeve sipas llojit të tatimit në 31.12.2018*

000/lekë

Nr	Lloji I Tatimit	Vlefta	Ne %	Detyrimi	Gjoba	Kamatëvonesa
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	11,545,699	38.2	5,403,216	5,298,392	844,092
2	Tatim mbi Fitimi	9,981,313	33.0	6,075,157	3,116,793	789,363
3	Akcize	2,231,447	7.4	589,752	1,304,164	337,531
4	Tatimi mbi Lojërat e Fatit	2,054,728	6.8	1,786,247	207,973	60,508
5	Taksa dhe Tarifa	1,696,114	5.6	765,269	856,650	74,195
6	Kontributet e Sig. Shoq. dhe Tap	1,303,936	4.3	921,210	342,270	40,457
7	Tatim ne Burim	989,546	3.3	501,370	467,948	20,228
8	Të tjera (global)	437,531	1.4	0	437,531	0
	T O T A L I	**30,240,315**	**100**	**16,042,220**	**12,031,721**	**2,166,374**

Burimi: DTM, përpunuar nga grupi i auditimit



Viti 2019

Detyrimi Tatimor sipas statusit në datën 31.12.2019 është ne shumën **11,242,411 mijë lekë** për 203 subjekte nga të cilat:

Subjekte Aktive 193 subjekte në shumën 9,983,143 mijë lekë ose 89 % të totalit ku vetëm dy subjektet O. dhe K. janë me detyrime në shumën 5,203,320 mijë lekë ose 52 % të detyrimeve të subjekteve aktive.

Subjekte Pasive dhe Kërkesa për çregjistrim 10 subjekte në shumën 1,259,267 mijë lekë ose 11% të totalit ku vetëm dy subjektet pasive ñS. P. A.ò dhe ñS. C. T.ò janë me detyrime në shumën 1,151,753 mijë lekë ose 91 % të totalit të subjekteve pasive.

Tabela nr. 8: *Totali i detyrimeve sipas llojit të tatimit në 31.12.2019*

000/lekë

Nr	Lloji I Tatimit	Vlefta	Ne %	Principiali	Gjoba	Kamatëvonesa
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	4,020,489	35.8	1,214,538	2,634,482	171,469
2	Tatim mbi Fitimi	5,893,930	52.4	2,474,810	2,550,223	868,897
3	Taksa dhe Tarifa	538,536	4.8	475,992	56,632	5,912
4	Kontributet e Sig. Shoq. dhe Tap	170,482	1.5	143,932	24,509	2,041
5	Tatim ne Burim	270,494	2.4	80,251	177,198	13,045
6	Të tjera (global)	348,480	3.1	222	348,175	83
	T O T A L I	**11,242,411**	**100**	**4,389,746**	**5,791,218**	**1,061,447**

Burimi: DTM, përpunuar nga grupi i auditimit



Rreth 93 % të totalit të detyrimeve të papaguara, për detyrime mbi 100,000 mijë lekë, e zëne 18 subjekte *(ose 9 % të totalit të subjekteve debitorë)* ne shumën **10,146,754** mijë lekë nga **11,242,411** mijë lekë ne total.

Gjatë muajit Mars 2019 e vazhdim në zbatim të shkresës se DPT-se nr. 2258, datë 31.01.2019 ñRregullores datë 31.01.2019 ñPër Administrimin e Tatimpaguesve të Mëdhenjò janë realizuar transferime të subjekteve nga DTM-ja në DRT-të e rretheve dhe anasjelltas.
Në zbatim të shkresës për transferimin e tatimpaguesve ka sjellë ndryshime në treguesit e detyrimeve tatimore të papaguara dhe menaxhimi i tyre.
Ne baze të të dhënave të raportuara çdo muaj edhe ne DPT rezulton se detyrimi tatimor nga procedura e mësipërme e transferimit;

- është pakësuar në shumën 17,524,620 mijë lekë për 147 subjekte dhe
- është shtuar në shumën 851,370 mijë lekë për 83 subjekte.

Viti 2020

Detyrimi tatimor gjithsej (Raporti i Sistemit C@TS) sipas statusit në datën 31.12.2020 është në shumën 12,509,377 mijë lekë për 271 subjekte nga 901 ne administrim të DTM-se të cilat:
Subjekte Aktive 262 subjekte nga 879 ne administrim ne shumën 11,118,156 mijë lekë ose 89 % të totalit ku vetëm katër subjektet shtetërore O., K., A. dhe A. P. Durrës janë me detyrime ne shumën 6,207,192 mijë lekë ose 56 % të detyrimeve të subjekteve aktive.
*Subjekte Pasive dhe Kërkesa për çregjistrim*9 subjekte nga 22 në administrim në shumën 1,391,221 mijë lekë ose 11 % të totalit ku vetëm tre subjektet pasive ñS. P. A.ò, ñS. C. T.ò dhe ñS. P. A. T.ò janë me detyrime në shumën 1,333,314 mijë lekë ose 96 % të totalit të subjekteve pasive.

Tabela nr. 9: *Totali i detyrimeve sipas llojit të tatimit në 31.12.2020*

000/lekë

Nr	Lloji I Tatimit	Vlefta	Ne %	Principiali	Gjoba	Kamatëvonesa
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	4,043,800	32.3	1,419,214	2,553,556	71,030
2	Tatim mbi Fitimi	6,730,567	53.8	2,791,747	2,978,354	960,466
3	Taksa dhe Tarifa	608,860	4.9	521,987	74,782	12,092
4	Kontributet e Sig. Shoq. dhe Tap	359,424	2.9	300,195	46,098	13,131
5	Tatim ne Burim	328,936	2.6	108,571	202,047	18,317
6	Të tjera (global)	437,789	3.5		437,789	
	T O T A L I	12,509,377	100	5,141,713	6,292,627	1,075,037

Burimi: DTM, përpunuar nga grupi i auditimit



Rreth 90 % të totalit të detyrimeve të papaguara, për detyrime mbi 100,000 mijë lekë, e zënë 21 subjekte *(ose 8 % të totalit të subjekteve debitorë)* ne shumën **11,168,072** mijë lekë nga **12,509,377 mijë lekë** ne total. Tatimpagues me detyrime mbi 100,000 mije leke. (Lista bashkëngjitur aneksit janë
- Detyrime tatimore të papaguara në procedura ankimimi administrativ janë në shumën 3,383,290 mije leke, ose 27 % të totalit për 101 subjekte të ndarë:
- Në Apelim Tatimor 115,234 mije lekë për 24 subjekte
- Në Procese Gjyqësore 3,268,056 mije lekë për 80 subjekte.

- ***Detyrime tatimore në procedurë arkëtimi*** në vijim pa masa shtrënguese në shumën 6,207,828 mije lekë ose 50 % të totalit, ku vetëm shoqëritë shtetërore O., K. dhe A. kanë shumën 5,749,256 mije leke ose 93 % të totalit në procedurë arkëtimi ne vijim pa masa shtrënguese.
Pjesa tjetër e detyrimeve të mundshme për arkëtim në shumën 458,573 mijë lekë përbëhet nga;
- Detyrime ne marrëveshje me këste për 24 subjekte ne shumën 294,269, mije leke dhe
- Detyrime për arkëtim e kompensim në vazhdim 143 subjekte ne shumën 172,463 mijë leke, ku 105 subjekte janë ne shumen 16,223 mije leke për vlerat e detyrimit deri ne 1,000 mijë lekë.

- ***Detyrime të papaguara ne procedure mbledhje me forcë dhe masa shtrënguese*** në shumën 2,857,471 mije leke ose 23 % të totalit të detyrimeve për 26 subjekte.
- Detyrime të për arkëtim në shumën prej 632,451 mijë leke për 16 subjekte dhe
- Detyrime të paarkëtueshme në shumën prej 2,225,020 mije lekë për 10 subjekte, pas vendosjes së masave shtrënguese rezulton se subjektet nuk kanë likuiditet dhe asete për shlyerjen e detyrimeve.

Duke analizuar situatën e detyrimeve tatimore në datën 31.12.2020 ne shumen 12,509,377 mije leke për 271 subjekte ne raport me datën 31.12.2019 ne shumen 11,242,411 mije leke për 203 subjekte, rezulton se kemi një rritje të detyrimeve si ne numër subjektesh + 68 dhe vlere ne shumen 1,266,966 mije leke ose 11.1 % me shume.
Shtimi i numrit të subjekteve debitorë është kryesisht nga transferimi + 56 subjekte, ndërsa shtimi i detyrimeve ne shumen 1,266,966 mije leke vjen nga tre subjektet shtetërore në shumën1,141,062 mije leke ose 90 %*(O. 939,563 mije leke, A. 115,276 mije leke dhe K. 86,223 mije leke)*
Tabela nr 9 : *Gjendja e detyrimi tatimor për periudhën 2018-2019-2020*

lekë

Përshkrimi	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Gjendja në fillim	30,306,800,551	30,240,314,845	11,242,410,520
Shtesa	7,773,411,046	9,178,552,731	6,220,653,288
Arkëtime	-6,072,689,893	-9,037,496,380	-4,510,442,264
Sistemime	-1,679,695,194	-2,465,710,702	-435,078,890
Falje	-87,511,665	0	0
Transferime (-)	0	-17,524,620,441	-260,540,730
Transferime (+)	0	851,370,467	252,374,953
Gjendja në fund	**30,240,314,845**	**11,242,410,520**	**12,509,376,877**

Vlera e detyrimit tatimor deri më 31.12.2020, është në vlerën **12,509 milion lekë**, e cila e ndarë sipas vjetërsisë së tij, përbëhet nga:

- 653,570 mijë lekë deri në 3 muaj;
- 1,110,419 mijë lekë 3-6 muaj;
- 651,895 mijë lekë 6-12 muaj;
- 3,825,754 mijë lekë 1-2 vjet;
- 5,367,647 mijë lekë 2-5 vjet; dhe
- 900,110 mijë lekë mbi 5 vjet.

Nga analiza e vjetërsisë së krijimit të detyrimit tatimor vihet re se përqindjen më të lartë ndaj totalit e zë detyrimi tatimor me vjetërsi 2-5 vjet në masën 43% e ndjekur nga detyrimi me vjetërsi 1-2 vjet në masën 30%.

Masat e marra

Në zbatim të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1988 ñPër tatimin mbi të ardhuratò i ndryshuar, neni 88 dhe Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 ñPër procedurat tatimoreò, i ndryshuar, përcaktuar në paragrafin 89-104, ku parashikohen instrumentet që DRT duhet dhe mund të përdorin për mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor.

Masat e marra nga DTM për periudhën 2018-2020 janë detajuar në aneksin 3/2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Të dhënat janë paraqitur në total për masat e marra pavarësisht llojit të detyrimit, gjithsej 1,669 masa të vendosura nga të cilat 1,684 kanë rezultuar me arkëtim ose 47% e tyre, por nëse do tõi referoheshim vlerës së arkëtuar impakti në vlerën e detyrimit të mbledhur është i ulët me 4,098,287mijë lekë nga 12,815,931 mijë lekë gjithsej ose vetëm 32% e detyrimit.

Nga evidencat e vëna në dispozicion nga DTM rezulton se i janë përgjigjur Njoftimit dhe kërkesës për të paguar 1617 raste (subjekte), por me një rezultat arkëtimi vetëm 37% të detyrimit të papaguar të njoftuar ose 3,852,415 mijë lekë.

Po ashtu në lidhje me urdhër bllokimet e llogarive raportohen si 70 raste nga të cilët janë arkëtuar 21.5% e shumës së njoftuar për bllokim ose 193,890 mijë lekë (50 raste).

Sipas DTM numri i rasteve të arkëtuara vjen dhe si rezultat i arkëtimeve gjatë 2020 nga masat e lëna në periudhat e mëparshme. Në këtë mënyrë edhe pse evidencat janë paraqitur ñpër periudhënò dhe ñprogresiveò nuk mund të vlerësohet impakti i mjeteve shtrënguese të një viti (periudha në auditim).

Konstatim:

Nga auditimi konstatohet se arkëtimet e një periudhe ushtrimore e realizuar nga tatimpaguesit si rezultat i vendosjes së masave shtrënguese, përfshijnë edhe vlerën e detyrimeve të cilat duhet të arkëtoheshin mbi bazën e masave shtrënguese të vendosura nga vitet paraardhëse, për pasoje raporti i detyrimit të arkëtuar me numrin e masave shtrënguese në një periudhë ushtrimore nuk është në raport të drejtë.

Nga DTM, detyrimet sipas tabelës së mëposhtme, edhe pse janë me masa shtrënguese, nisur nga fakti që tatimpaguesit nuk kanë asete të regjistruara në emër të tyre, konsiderohen të pa arkëtueshme si mëposhtë:

Tabela nr. 10: *Tatimpaguesit që detyrimet e tyre ndaj DTM-së konsiderohen të pa arkëtueshme*

Lekë

Nr.	NIPT	Tatimpaguesi	Statusi	Detyrimi i papaguar më 31.12.2020
1	L.	S. P. A.	Pasiv	819,531,420
2	L.	T. E.	Aktiv	523,045,746
3	L.	S. C. T.	Pasiv	367,106,491
4	L.	N.	Aktiv	217,853,417
5	L.	S. P. A.T.	Pasiv	146,675,674
6	K.	P. P.	Aktiv	53,555,458
7	L.	D. G. C.	Aktiv	44,664,730
8	J.	F.	Kërkesë për Çregjistrim	38,232,645
9	L.	B. E.	Aktiv	11,887,262
10	L.	I.P.	Aktiv	2,467,140
	SHUMA			**2,225,019,983**

Burimi: DTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Tatimpagues me masa shtrënguese dhe të cilat kanë detyrime tatimore të papaguara deri më datë 31.12.2020, si dhe veprimet e DTM për to, paraqitën si më poshtë vijon:

1. Subjekti ñS. P. Al.ò, me NIPT L., vlera e detyrimit për të cilin janë zbatuar masat shtrënguese 819,531 mijë lekë. Masat shtrënguese për mbledhjen me forcë janë zbatuar për vlerën totale të detyrimit ditën e zbatimit të procedurës së mbledhjes me forcë në datë

19.04.2018. Masat shtrënguese janë zbatuar deri në konfiskim të pasurisë objekt të Urdhër Sekuestrimit nr. 4415/2 prot, datë 09.05.2018, në bashkëpunim me grupin e punës të ngritur edhe nga Drejtoria e Hetimit Tatimor.

2. Subjekti ñT. E.ò me NIPT L., vlera e detyrimit për të cilin është vendosur Urdhër Bllokimi i llogarive bankare me shkresat nr.10790 prot, datë 23.10.2019 në vlerën 523,045 mijë lekë. Masat shtrënguese për mbledhjen me forcë janë zbatuar për vlerën totale të detyrimeve tatimore të papaguara ditën e zbatimit të procedurës së mbledhjes me forcë si masë e fundit. Njoftimi i përgjithshëm për vendosjen e barrës Hipotekore dhe siguruese në QKB me nr. 10794 prot, datë 23.10.2019. Ndaj subjektit nuk është vijuar me Urdhër Sekuestrimi pasi *nuk rezultojnë pasuri të regjistruara në emër të tatimpaguesit*, në Pasqyrat Financiare të shoqërisë si dhe në Zyrat vendore të Hipotekave dhe Drejtorisë së Shërbimit të Transportit Rrugor, përgjigjet e hipotekave dhe asaj së Transportit Rrugor janë arkivuar në dosjen e tatimpaguesit.

3. Subjekti ñS. C. T.ò, me NIPT L., vlera e detyrimit të papaguar 367,106 mijë lekë. Masat shtrënguese për mbledhjen me forcë janë zbatuar për vlerën totale të detyrimit ditën e zbatimit të procedurës së mbledhjes me forcë në datë 27.12.2017. Masa e fundit e zbatuar për mbledhjen me forcë është Vendosja e Masave të Sigurimit të Pasurive, Barrë Siguruese, Barrë Hipotekore, QKB me nr.14237 datë 27.12.2017. Subjekti ka shpallur falimentin. DTM me shkresën me nr.13725/5 prot, datë 15.01.2018, ka njoftuar për detyrimet e subjektit Avokaturën e Shtetit, e cila me shkresën nr. 01/5 prot, datë 06.02.2018, njofton DTM për fillimin e seancave gjyqësore për procedurat e falimentit. DTM në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit është në ndjekje të procedurës së falimentit në gjykatë.

4. Subjekti ñN.ò me NIPT L., vlera e detyrimit për të cilin janë zbatuar masat shtrënguese 214,742 mijë lekë. Masat shtrënguese për mbledhjen me forcë janë zbatuar për vlerën totale të detyrimeve tatimore të papaguara ditën e zbatimit të procedurës së mbledhjes me forcë në datë 08.05.2019. Masat shtrënguese janë zbatuar deri në Vendosjen e Masave të sigurimit të pasurive, barrë siguruese, Hipotekore, QKB, me nr.4673 prot, datë 08.05.2019. Ndaj subjektit nuk është vijuar me Urdhër Sekuestrimi pasi nuk rezultojnë pasuri të regjistruara në emër të tatimpaguesit, në Pasqyrat Financiare të shoqërisë si dhe në Zyrat vendore të Hipotekave dhe Drejtorisë së Shërbimit të Transportit Rrugor.

5. Subjekti ñS. P. A. T.ò, me NIPT L., vlera e detyrimit për të cilin janë zbatuar masat shtrënguese 146,676 mijë lekë. Masat shtrënguese për mbledhjen me forcë janë zbatuar për vlerën totale të detyrimit ditën e zbatimit të procedurës së mbledhjes me forcë në datë 18.03.2019. Subjekti është transferuar nga DRT Tiranë në datë 21.03.2019 me masa shtrënguese. Masa e fundit e zbatuar për mbledhjen me forcë është vendosja e Masave të Sigurimit të Pasurive, Barrë Siguruese, Barrë Hipotekore, QKB me nr.13093/1 datë 18.03.2019. Nuk ka pasuri të regjistruara.

6. Subjekti ñP. P.ò, me NIPT K., vlera e detyrimit për të cilin janë zbatuar masat shtrënguese 53,555 mijë lekë. Masat shtrënguese për mbledhjen me forcë janë zbatuar për vlerën totale të detyrimeve tatimore të papaguara ditën e zbatimit të procedurës së mbledhjes me forcë në datë 29.05.2019. Subjekti është transferuar nga DRT Tiranë më datë 21.03.2019 me masa shtrënguese deri në vendosjen e masave të sigurimit të detyrimit. Në DTM janë zbatuar masat shtrënguese deri në Vendosjen e Barrave të sigurimit të pasurive, barrë siguruese, Hipotekore, QKB, Bllokim të aktivitetit në doganë me nr. 4629/30/31/32 prot, datë 08.05.2019. Ndaj subjektit është vijuar me Urdhër Sekuestrimi nr. 1003 prot, datë

31.01.2020, pasi rezulton një pasuri e luajtshme e regjistruar në emër të tatimpaguesit, në Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor, Tiranë. Në vijim DTM ka dërguar shkresë ñKërkesë për veprimò pranë Drejtorisë së Hetimit Tatimor Tiranë nr.1003/3 prot, datë 29.07.2020.

7. Subjekti ñD. G. C.ò, me NIPT L., vlera e detyrimit për të cilin janë zbatuar masat shtrënguese 41,845 mijë lekë. Masat shtrënguese për mbledhjen me forcë janë zbatuar për vlerën totale të detyrimit ditën e zbatimit të procedurës së mbledhjes me forcë në datë 29.05.2019. Subjekti është transferuar nga DRT Tiranë në datë 16.03.2019 me masa shtrënguese deri në vendosjen e masave të sigurimit të pasurisë. Nga DTMï ja janë përsëritur masat shtrënguese deri në Vendosjen e Masave të sigurimit të pasurive, barrë siguruese, Hipotekore, QKB, Bllokim të aktivitetit në doganë me nr.4627 prot, datë 08.05.2019.
Ndaj subjektit nuk është vijuar me Urdhër Sekuestrimi pasi nuk rezultojnë pasuri të regjistruara në emër të tatimpaguesit, në Pasqyrat Financiare të shoqërisë si dhe në Zyrat vendore të Hipotekave dhe Drejtorisë së Shërbimit të Transportit Rrugor, përgjigjet e hipotekave dhe asaj së Transportit Rrugor me shkresën nr.4528/20 prot, datë 19.06.2019 janë arkivuar në dosjen e tatimpaguesit. Në vijim të masave për mbledhjen e detyrimeve tatimore është kërkuar bashkëpunimi i Drejtorisë së Hetimit Tatimor, Rajoni Qendror Tiranë me shkresën nr. 6086 prot, datë 29.05.2019 ñKërkesë për veprimò.

8. Subjekti ñF.ò, me NIPT J. vlera e detyrimit për të cilin janë zbatuar masat shtrënguese është 38.233 mijë lekë. Subjekti është me status ñKërkesë për Çregjistrimò nga data 28.12.2012. Masat shtrënguese për mbledhjen me forcë janë zbatuar për vlerën totale të detyrimit ditën e zbatimit të procedurës së mbledhjes me forcë në datë 08.11.2018. Masa e fundit e zbatuar për mbledhjen me forcë është Urdhër Sekuestrimi nr.1729/38 datë 08.11.2018 në të cilin është përcaktuar pasuria objekt sekuestrimi, me shkresën nr.1730/1prot, datë 09.11.2019 i janë drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Durrës për vendosjen e barrës siguruese të pasurisë. Ndaj tatimpaguesit janë zbatuar masat shtrënguese sa herë që është konstatuar rritje e detyrimit në sistemin C@ts. Në vitin 2015 masat janë zbatuar deri në fazën e kërkesës për pagesën e detyrimit nga palët e treta me Kërkesën nr.4439 prot, datë 15.04.2015 si dhe me Kërkesën nr.4439/1 prot, datë 29.04.2019 i është kërkuar DRT Durrës të procedohet për mbledhjen me forcë të detyrimit pasi palët e treta janë subjekte në administrim të DRT Durrës me shkresën nr. 8283/1 datë 01.09.2019 informon DTM-në se për subjektet janë zbatuar procedurat deri në Vendosjen e Masave të Sigurimit të Pasurisë.

9. Subjekti ñB. E.ò, me NIPT L., vlera e detyrimit për të cilin është vendosur Urdhër Bllokimi i llogarive bankare me shkresat nr.1460 prot, datë 18.02.2020 në vlerën 11,121 mijë lekë. Masat shtrënguese për mbledhjen me forcë janë zbatuar për vlerën totale të detyrimeve tatimore të papaguara ditën e zbatimit të procedurës së mbledhjes me forcë si masë e fundit Njoftimi i përgjithshëm për vendosjen e barrës Hipotekore dhe siguruese në QKB me nr.10728 prot. datë 23.10.2020. Ndaj subjektit nuk është vijuar me Urdhër Sekuestrimi pasi nuk rezultojnë pasuri të regjistruara në emër të tatimpaguesit, në Pasqyrat Financiare të shoqërisë si dhe në Zyrat vendore të Hipotekave dhe Drejtorisë së Shërbimit të Transportit Rrugor, përgjigjet e hipotekave dhe asaj së Transportit Rrugor janë arkivuar në dosjen e tatimpaguesit.

10. Subjekti ñI. P.ò, me NIPT L., vlera e detyrimit për të cilin është vendosur Urdhër Bllokimi i llogarive bankare me shkresat nr.67000 prot, datë 31.08.2018 është 2,437 mijë

lekë. Subjekti është transferuar nga DRT Tiranë më datë 14.03.2019 me masa shtrënguese deri në vendosjen e masave të sigurimit të detyrimit nr.71481/1/2/3 datë 27.09.2018.
Në DTM është përsëritur masat shtrënguese e Bllokimit të Llogarive bankare me nr.3631 prot, datë 09.04.2019. Ndaj subjektit nuk është vijuar me Urdhër Sekuestrimi pasi nuk rezultojnë pasuri të regjistruara në emër të tatimpaguesit, në Pasqyrat Financiare të shoqërisë si dhe në Zyrat vendore të Hipotekave dhe Drejtorisë së Shërbimit të Transportit Rrugor, përgjigjet e hipotekave dhe asaj së Transportit Rrugor me shkresën nr.6085/1.2 prot, datë 14.10.2019 janë arkivuar në dosjen e tatimpaguesit. Në vijim të masave për mbledhjen e detyrimeve tatimore është kërkuar bashkëpunimi i Drejtorisë së Hetimit Tatimor, me shkresën nr.6085 prot, datë 29.05.2019 ñKërkesë për veprimò, i është kërkuar Drejtorisë së Hetimit Tatimor, Rajoni Qendror Tiranë, për të vijuar me ndalimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, administratorit dhe shumave të depozituara në llogaritë bankare. Me shkresën nr.6091/1 prot, datë 21.06.2019 i është vënë në dispozicion Drejtorisë së Hetimit, Rajoni Qendror Tiranë, proçedura e ndjekur nga DTM për mbledhjen me Forcë. Po ashtu për subjektin e mësipërm me kërkesë të Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës parë Tiranë është përcjellë praktika me procedurat e ndjekura përkatëse zyrtarisht nëpërmjet shkresës nr.16/1 datë 09.01.2020.

Nga DTM, detyrimet për subjektet e mëposhtme për të cilat janë marrë masa shtrënguese deri me 31.12.2020, i cili konsiderohet i arkëtueshëm:
1. Subjekti ñB.ò, me NIPT L., vlera e detyrimit për të cilin është vendosur Urdhër Bllokimi i llogarive bankare në vlerën 17.797 mijë lekë, kurse për detyrimet e tjera prej 26,393 mijë. Masat shtrënguese për mbledhjen me forcë janë zbatuar për vlerën totale të detyrimit ditën e zbatimit të procedurës së mbledhjes me forcë në datë 18.02.2021. Masat shtrënguese janë zbatuar deri në Vendosjen e Masave të sigurimit të pasurive, barrë siguruese, Hipotekore, QKB, bllokim të aktivitetit në doganë me nr. 494 prot, datë 21.01.2021. Ndaj subjektit nuk është vijuar me Urdhër Sekuestrimi pasi nuk rezultojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të tatimpaguesit, konfirmuar nga përgjigjet e dërguara nga Zyrat vendore të Hipotekave. Për pasurinë e paluajtshme nuk ka pasur të regjistruar në emër të tatimpaguesit.
Kërkesë ndaj DPSHTRR nr.6358/10 datë 23.08.2021, për plotësim informacioni mbi pasurinë e paluajtshme, e cila nuk ka përgjigje nga institucioni.

2. Subjekti ñA.M.ò, me NIPT K., vlera e detyrimit për të cilin janë zbatuar masat shtrënguese 143,036 mijë lekë. Masat shtrënguese për mbledhjen me forcë janë zbatuar për vlerën totale të detyrimeve tatimore të papaguara ditën e zbatimit të procedurës së mbledhjes me forcë në datë 08.05.2019. Masat shtrënguese janë zbatuar deri në Vendosjen e Masave të sigurimit të pasurive, barrë siguruese, Hipotekore, QKB, bllokim të aktivitetit në doganë me nr. 4668 prot, datë 08.05.2019. Ndaj subjektit nuk është vijuar me Urdhër Sekuestrimi pasi nuk rezultojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të tatimpaguesit, konfirmuar nga përgjigjet e dërguara nga Zyrat Vendore të Hipotekave.

3. Subjekti ñB. T.ò, me NIPT J., vlera e detyrimit për të cilin është vendosur Urdhër Bllokimi i llogarive bankare me shkresat nr. 11886 prot, datë 25.11.2019 si dhe nr. 6355 prot, datë 28.08.2020 në vlerën 98,450 mijë lekë. Masat shtrënguese për mbledhjen me forcë janë zbatuar për vlerën totale të detyrimeve tatimore të papaguara ditën e zbatimit të procedurës së mbledhjes me forcë si masë e fundit njoftimi i përgjithshëm për vendosjen e barrës Hipotekore dhe siguruese në QKB me nr. 6359 prot., datë 28.08.2020.

4. Subjekti ñS.ò, me NIPT J., vlera e detyrimit për të cilin është vendosur Urdhër Bllokimi i llogarive bankare me shkresën nr.6163 prot, datë 20.08.2020 në vlerën 65,231 mijë lekë.

Masat shtrënguese për mbledhjen me forcë janë zbatuar për vlerën totale të detyrimeve tatimore të papaguara ditën e zbatimit të procedurës së mbledhjes me forcë si masë e fundit njoftimi i përgjithshëm për vendosjen e barrës Hipotekore dhe siguruese në QKB me nr. 7660 prot. datë 10.07.2020.

5.Subjekti ñC. D.ò, me NIPT L., vlera e detyrimit për të cilin janë zbatuar masat shtrënguese 32,923 mije lekë. Masat shtrënguese për mbledhjen me forcë janë zbatuar për vlerën totale të detyrimeve tatimore të papaguara ditën e zbatimit të procedurës së mbledhjes me forcë në datë 05.05.2019. Masat shtrënguese janë zbatuar deri në Vendosjen e Masave të sigurimit të pasurive, barrë siguruese, Hipotekore, me Nr.8049 prot, datë 05.07.2019.
Ndaj subjektit është vijuar me Urdhër Sekuestrimi të pasurive të luajtshme me shkresën Nr.1001 prot, datë 31.01.2020 dhe në vijim është dërguar për procedurë Drejtorisë së Hetimit Tatimor Tiranë me shkresën nr.1001/3 datë 29.07.2020. Për pasuritë e paluajtshme nuk ka patur të regjistruar në emër të tatimpaguesit sipas përgjigjeve të ardhura zyrtarisht nga Hipotekat.

6.Subjekti ñT. A. LTD-ò, me NIPT K., vlera e detyrimit për të cilin është vendosur Urdhër Bllokimi i llogarive bankare me shkresat nr.12369 prot, datë 19.12.2018 në vlerën 10,380 mijë lekë. Masat shtrënguese për mbledhjen me forcë janë zbatuar për vlerën totale të detyrimeve tatimore të papaguara ditën e zbatimit të procedurës së mbledhjes me forcë si masë e fundit Njoftimi i përgjithshëm për vendosjen e barrës Hipotekore dhe siguruese në QKB me nr.12373 prot. datë 19.12.2018. Ndaj subjektit është vijuar me Urdhër Sekuestrimi të pasurive të luajtshme me shkresën nr.1006 prot, datë 31.01.2020 dhe me shkresën nr. 5237 protokolli, datë 21.07.2020 i është kërkuar Drejtorisë se Hetimit Tatimor kërkesa për veprim të mëtejshëm.

7.Subjekti ñJ. V. D. K.ò, me NIPT L, vlera e detyrimit për të cilin janë zbatuar masat shtrënguese 9,579 mijë lekë. Masat shtrënguese për mbledhjen me forcë janë zbatuar për vlerën totale të detyrimeve tatimore të papaguara ditën e zbatimit të procedurës së mbledhjes me forcë në datë 25.09.2019. Masat shtrënguese janë zbatuar deri në Vendosjen e Masave të sigurimit të pasurive, barrë siguruese, Hipotekore, me nr.9795 prot, datë 25.09.2019.Ndaj subjektit nuk është vijuar me Urdhër Sekuestrimi pasi nuk rezultojnë pasuri të regjistruara në emër të tatimpaguesit, në Pasqyrat Financiare të shoqërisë si dhe në Zyrat vendore të Hipotekave dhe Drejtorisë së Shërbimit të Transportit Rrugor, përgjigjet e hipotekave dhe asaj së Transportit Rrugor janë arkivuar në dosjen e tatimpaguesit.

8. Subjekti ñV.ò SHPK, me NIPT K., vlera e detyrimit për të cilin është vendosur Urdhër Bllokimi llogarive bankare me shkresën nr.5614 prot, datë 03.08.2020 në vlerën 5.939 mijë lekë. Tatimpaguesi ka paguar detyrimet për të cilat është vendosur Urdhër bllokimi.

9.Subjekti ñA.ò, me NIPT J., vlera e detyrimit për të cilin është vendosur Urdhër Bllokimi i llogarive bankare me shkresën nr. 11826 prot, datë 22.11.2019 në vlerën 4.134 mijë lekë. Masat shtrënguese për mbledhjen me forcë janë zbatuar për vlerën totale të detyrimeve tatimore të papaguara ditën e zbatimit të procedurës së mbledhjes me forcë në datë 29.10.2019. Masat shtrënguese janë zbatuar deri në Vendosjen e Masave të sigurimit të pasurive, barrë siguruese, Hipotekore, bllokim të aktiviteti në doganë dhe QKB, me nr.12344 prot, datë 12.12.2019. Ndaj subjektit është vijuar me Urdhër Sekuestrimi të pasurive të luajtshme me shkresën Nr.1005 prot, datë 31.01.2020.

10. Subjekti ñÇ. ï S. T. B.ò, me NIPT L., vlera e detyrimit për të cilin është vendosur Urdhër Bllokimi i llogarive bankare me shkresën nr.4912 prot, datë 09.07.2020 është në vlerën 1.965 mijë miljon lekë.

11. Subjekti ñK. ï T.ò, me NIPT L., vlera e detyrimit për të cilin është vendosur Urdhër Bllokimi i llogarive bankare me shkresën nr.9845 prot, datë 27.09.2019 në vlerën 1,865 mijë lekë. Masat shtrënguese për mbledhjen me forcë janë zbatuar për vlerën totale të detyrimeve tatimore të papaguara ditën e zbatimit të procedurës së mbledhjes me forcë në datë 29.10.2019. Masat shtrënguese janë zbatuar deri në Vendosjen e Masave të sigurimit të pasurive, barrë siguruese, Hipotekore, bllokim të aktiviteti në doganë dhe QKB, me nr.11088 prot, datë 29.10.2019. Ndaj subjektit është vijuar me Urdhër Sekuestrimi të pasurive të luajtshme me shkresën nr.1002 prot, datë 31.01.2020. Në vijim tatimpaguesi ka ulur ndjeshëm detyrimet tatimore duke kryer pagesat periodike.

Akt-Marrëveshjet me këste

Akt-Marrëveshja me këste është Akt Administrativ, që aplikohet nga drejtoritë rajonale tatimore për tatimpaguesit që nuk kanë mundësi për të paguar në afat detyrimet tatimore, dhe kanë vërtetuar që janë në kushtet e pamundësisë financiare për të paguar të plotë detyrimin tatimor, me aprovim dhe nënshkrim të Drejtorit të Drejtorisë Rajonale dhe tatimpaguesit.
Bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, neni 77 ñMarrëveshja e pagesës me kësteò, si dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, pika 77, për periudhën objekt auditim akt-marrëveshjet e lidhura janë si më poshtë:

Tabela nr. 11: *Akt-marrëveshjet e lidhura për vitin 2018-2019-2020*

000/lekë

Nr.	Nr. Akt Marrëveshje të lidhura	Nr. Subjekteve të cilët lidhin A-M	Vlera totale e debisë për të cilën janë lidhur A-M	Paguar në lidhjen e A-M (vlera fillestare e paguar)	Vlera e paguar gjatë vitit nga A-M	Nr. A-M të anulluara gjatë vitit për mosrespektim	Vlera e A ï M të anulluara	Vlera e paguar sipas AKT AM
2018	31	30	612,233	167,566	50,366	4	154,623	604,516
2019	17	16	405,021	111,076	124,890	7	135,408	297,774
2020	32	30	742,343	185,578	22,852	3	143,378	294,269

Burimi: DTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Në zbatim të Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, pika 77.3.1: ñ*Marrëveshja e pagesës me këste bëhet me shkrim, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës dhe nënshkruhet nga tatimpaguesi dhe drejtori i drejtorisë rajonale apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të. Për të nënshkruar një marrëveshje të pagesës me këste, tatimpaguesi detyrohet të paguajë menjëherë të paktën njëzet për qind të vlerës së detyrimit, për të cilin lidhet marrëveshja*...ò si dhe në zbatim të pikës 2.3 të kontratave tip të lidhjes së marrëveshjes për pagesën me këste të detyrimeve, nga auditimi rezultoi se, të gjithë subjektet kanë bërë parapagimin e 20% të detyrimit total, mbi të cilën është lidhur akt-marrëveshje.
Nga auditimi i praktikave për lidhjen e akt-marrëveshjeve konstatohet se, në të gjitha kërkesat e tatimpaguesve drejtuar DTM-së mungon vërtetësia e pamundësisë së situatës aktuale financiare, si dhe argumente nga ana e subjektit që pavarësisht rrethanës financiare të vështirë, është në gjendje të zbatojë kushtet e marrëveshjes. Gjithashtu mungon dhe analiza e situatës ekonomike financiare të subjektit të realizuar nga vetë DTM-ja, mbështetur në pasqyrat financiare të shoqërisë, gjendja e detyrimeve, kapitaleve të shoqërisë, aftësia qarkulluese e inventarit, likuiditetet etj, veprime në kundërshtim me pikën 77.1 të Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 dhe Nenit 18 të Rregullores së funksionimit të DRT për lidhjen e akt-

marrëveshjes pika 2 ñ*struktura përgjegjëse në DRT pasi merr në dorëzim kërkesat për marrëveshje i analizon ato duke përcaktuar riskun përkatës*ò, dhe pika 3: ñ*nëse plotëson kushtet pas analizës harton draft marrëveshjen përkatëse për pagesën me këste duke analizuar për të parë situatën nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore*.ò

Akt-Marrëveshjet e anulluara në vitin 2018, 2019 dhe 2020

Tabela nr. 12: *Akt-Marrëveshje të anulluara në vitin 2018*

Lekë

Nr.	Emër tatimpaguesi	NIPT	Det.Total (për të cilin u lidh A-M)	Paguar në fillimi të A-M	Data e anullimit të A-M	Nr. total Kësteve	Këste të paguara	Vlera e kësteve të paguara	Vlera e mbetur pa paguar
1	E.E. I.	K	46,426,583	8,653,000	15.03.2018	20	13	30,177,290	13,989,470
2	V. K.	K.	51,451,224	14,000,000	06.04.2018	22	8	18,733,800	30,217,636
3	N.	K.	103,840,356	32,752,858	27.04.2018	15	3	25,768,070	78,072,286
4	B.	L.	63,246,497	16,031,243	30.07.2018	15	8	30,903,031	32,343,466

Burimi: DTM, përpunuar nga grupi i auditimit

- Tatimpaguesi ñE. E. I.ò me Nipt K. për Akt-marrëveshjen e lidhur është bërë zgjidhje e Akt-marrëveshjes në datën 15.03.2018 dhe nga DTM është lidhur akt marrëveshje me pagese me këste me nr. 3641/2 prot., datë 12.04.2018;
- Tatimpaguesi ñV. K.ò, me Nipt K. është transferuar nga administrimi i DTM-se në DRT Tiranë;
- Tatimpaguesi ñN.ò, me Nipt K. është transferuar nga administrimi i DTM-se në DRT Tiranë;
- Tatimpaguesi ñB.ò, me Nipt L. është bërë zgjidhja e Akt-Marrëveshjes me datë 30.07.2018, për të cilin është vijuar me masat shtrënguese si më poshtë :
  - Urdhër Bllokim Llogarie nr. 7836 prot., datë 30.07.2018
  - Njoftim për vendosjen e barrës Hipotekore nr. 7973 prot., datë 03.08.2018
  - Njoftim për vendosjen e barrës Siguruese nr. 7974 prot., datë 03.08.2018
  - Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës Siguruese dhe Hipotekore nr. 7975 prot., datë 03.08.2018
  - Kërkese për vendosjen e barrës Siguruese dhe Hipotekore ne QKB nr 7976 prot. datë 03.08.2018.

Tabela nr 13*: Akt-Marrëveshjeve e anulluara në vitin 2019*

Lekë

Nr.	Emër tatimpaguesi	NIPT	Det. Total (për të cilin u lidh A-M)	Paguar në fillimi të A-M	Data e anullimit të A-M	Nr.total Kësteve	Këstë të paguara	Vlera e kësteve të paguara	Vlera e mbetur pa paguar
1	X& M SH.P.K	J.	6,793,877	3,000,000	04.01.2019	20	7	2,038,158	4,755,719
2	B.-A.	L.	23,021,569	5,825,758	12.02.2019	14	0	0	23,021,569
3	A.-M.	K.	85,620,396	22,500,000	09.04.2019	18	6	28,540,128	57,080,268
4	A.K SHA	K.	24,600,415	8,290,268	21.05.2019	19	11	14,300,000	10,300,415
5	E. E. I.	K.	66,381,698	16,604,000	21.05.2019	20	10	32,652,680	33,729,018
6	X& M sh.p.k	J.	5,016,749	1,721,052	12.06.2019	12	0	-	5,016,749
7	K.ï T.	L.	3,040,890	800,000	01.10.2019	6	3	1,536,258	1,504,632

Burimi: DTM, përpunuar nga grupi i auditimit

- Për tatimpaguesin, ñB.-A.ò me NIPT L. është transferuar në administrimin DRT-se, Lezhë, dhe nga DTM nuk ka informacion mbi ecurinë e detyrimeve tatimore të tij.
-Për tatimpaguesin ñA. ï M.ò, me NIPT K., nga DTM me shkresën nr.4145/6 prot, datë 09.04.2019 është bërë zgjidhja e marrëveshjes për pagesë me këste, për mospagim kësti.
Nga DMDP pranë DTM, me shkresën nr.3662 Prot, datë 09.04.2019 është bërë bllokimi i llogarive të tatimpaguesit të sipërcituar.
Në përfundim të afatit referuar nenit 78, pika 2 të Ligjit nr. 9920 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, nga DMDP është vijuar me zbatimin e masave shtrënguese si (dokumente të ngarkuar në sistemin C@TS):

- Njoftim tatimpaguesit për vendosjes e barrës siguruese
- Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore ZQRPP
- Njoftim për vendosjen e barrës siguruese DPSHTRR
- Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit të detyrimit tatimor në QKB
- Bllokim aktiviteti në doganë
- Me shkresën nr.1956 Prot, datë 05.03.2020, është bërë bllokimi i llogarive të tatimpaguesit për detyrimet tatimore të shtuara.

- Tatimpaguesit ñA.-M.ò SHPK, me NIPT K., nga DTM me shkresën nr. 6297/1 Prot, datë 09.09.2020 i është kthyer përgjigje negative kërkesës së tij për lidhje marrëveshje, për shkak të mosplotësimit të kushtit ligjor për pagimit e të paktën 20 % të vlerës së detyrimit, për të cilën lidhet marrëveshja me këste.
Në vijim të masave shtrënguese, për subjekti është vijuar me ñUrdhër Sekuestrimin e pasuriveò me shkresën nr. 3503 Prot, datë 04.05.2021.
- Për tatimpaguesin ñA.ò Sha, me NIPT K.. për diferencën e mbetur pa paguar nga marrëveshja e vitit 2018, e cila është zgjidhur, DTM ka lidhur marrëveshje për pagesë me këste më shkresën nr. 5096/2 Prot, datë 29.05.2019. Rilidhja e akt marrëveshjes nga DTM argumentohet me pretendimin se me implementimin në sistemin C@TS të planeve të marrëveshjes me këste ishte e pamundur lidhja njëkohësisht e një marrëveshje në sistemin C@TS për një detyrim të ri tatimor.
-Për tatimpaguesin ñE. E. I.ò, me NIPT K. për akt-marrëveshjen e lidhur në vitin 2019 është bërë zgjidhje akt-marrëveshje me nr. 3641/3 prot. datë 21.05.2019 dhe nga DTM-ja është vijuar me masën shtrënguese ñBllokim i Llogariveò me urdhërin nr 8283 prot. datë 31.07.2019, ku mbas urdhër bllokimit është lidhur akt-marrëveshja me nr. 9186/2 prot. datë 04.09.2019 për pagesë me këste të detyrimeve tatimore të papaguara.
- Për tatimpaguesin ñX.&Mò ShPK, me NIPT J. bashkë me dosjen ishte transferuar në administrimin DRT-se Tiranë.
-Për tatimpaguesin ñK.T.ò me NIPT L.., u konstatua se ky tatimpagues nuk kishte respektuar kushtet e marrëveshjes, për të cilën duhej të kryente pagesat sipas kësteve respektive të përcaktuara në marrëveshjen e lidhur me shkresën nr.4841/1 Prot., datë 24.05.2019, për detyrimet tatimore sipas llojit të tatimit Tatim mbi Fitimin periudha 2018, TVSh, gjoba global, dhe Tatim i Mbajtur në Burim, si pasojë nga DTM ishte zgjidhur marrëveshja, duke vijuar me procedurat e mbledhjes me forcë, konkretisht me vendosjen e

- Urdhër Bllokimit të llogarive bankare me shkresën nr. 9845 Prot, datë 27.09.2019.
- Njoftim për vendosje të barrës Hipotekore me shkresën nr. 11086 Prot, datë 29.10.2019.
- Njoftim për vendosje të barrës Siguruese me shkresën nr. 11087 Prot, datë 29.10.2019.
- Kërkesë për vendosje të masës së sigurimit të detyrimit tatimor QKB-së me shkresën nr.11088 Prot, datë 29.10.2019.
- Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës Hipotekore dhe Siguruese me shkresën nr.11089 Prot, datë 29.10.2019.

- Njoftim për Vendosjen e Barrës Siguruese RBS-së me shkresën nr. 962 Prot, datë 30.01.2020, pasi DTM-ja ka kryer pagesën e tarifës së shërbimit ndaj RBS-së, më datë 12.12.2019.
- Urdhër Sekuestrimi i nxjerr për pasuritë e luajtshme (mjetë e tatimpaguesit) e shkresën nr.1002 Prot, datë 31.01.2020.

Tabela nr. 14: *Akt-Marrëveshjeve e anulluara në vitin 2020*

Lekë

Nr.	Emër tatimpaguesi	NIPT	Det. Total (për të cilin u lidh A-M)	Paguar në fillimi të A-M	Data e anullimit të A-M	Arsyeja e anullimit	Nr .total Kësteve	Këste të papaguara	Vlera e kësteve të paguara	Vlera e mbetur pa paguar
1	XH & M	J.	4,112,900	1,038,935	14.02.2020	Mospagim kësti	17	13	991,534	3,121,366
2	E. E. I.	K.	120,305,341	29,715,249	28.02.2020	nuk ka paguar këstet e Aktmarrëveshjes dhe detyrimet korente	15	12	17,080,956	103,224,385
3	S.	J.	37,033,073	3,075,653	14.04.2020	Mospagimi kësteve dhe detyrimeve të tjera korentë	12	-	37,033,073	37,033,073

- Për tatimpaguesin ñX& Mò SHPK, me NIPT J., me shkresën nr.1410 Prot. datë 14.02.2020 është bërë zgjidhja e Akt-Marrëveshjes, nr. 6981 Prot. datë 04.07.2019.Tatimpaguesi është transferuar në administrimin e DRT-së Tiranë dhe DTM nuk ka informacion mbi ecurinë e detyrimeve tatimore të tij.
- Për tatimpaguesin ñE. E. I.ò me NIPT K., nga DTM është bërë zgjidhja e akt-marrëveshjes me nr. 9186/3 prot. datë 28.02.2020, për të cilin kanë vijuar masat shtrënguese si më poshtë:
  - Urdhër Bllokim llogarie nr 1782 prot. datë 28.02.2020
  - Njoftim për vendosjen e Barrës Hopotekore me nr 1989 prot. datë 06.03.2020
  - Njoftim për vendosjen e Barrës Siguruese nr. 1990 prot. datë 06.03.2020
  - Kërkesë për vendosjen e barrës Siguruese dhe Hipotëkore ne QKB nr. 1991 prot. datë 06.03.2021
  - Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e Barrës Siguruese dhe Hipotekore me nr. 1992 prot. datë 06.03.2020.
- Për tatimpaguesin ñS.ò me NIPT J. është zgjidhur akt marrëveshja me shkresën nr. 2559 Prot, 14.04.2020, për të cilin kanë filluar masat shtrënguese si më poshtë:
  - Urdhër bllokimi i llogarive bankare me shkresën nr.6163 Prot, datë 20.08.2020.
  - Për detyrimet tatimore të papaguara ka lidhur marrëveshje për pagese me këste me shkresën nr.1656/1.2 Prot, datë 26.02.2021, nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor

Konstatim:

Për sa më sipër, në marrëveshjet e anuluara ka dhe subjekte të cilët nuk kanë paguar asnjë këst.

Gjithashtu për subjektet për të cilat është anulluar akt marrëveshja, referuar dispozitave ligjore të sipërcituara janë të detyruar të paguajnë të gjitha detyrimet tatimore të papaguara, që mbulohen nga kjo marrëveshje, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit të zgjidhjes së marrëveshjes dhe nëse këto detyrime nuk paguhen, administrata tatimore mbledh detyrimet në përputhje me dispozitat e Kreut XI të Ligjit nr. 9920 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, ku nga auditimi u konstatua se për subjektet ñ*E. E. I.”*dhe *“X& M*ò SHPK nuk është respektuar kjo dispozitë e ligjit, madje nga DTM është bërë rilidhje e akt marrëveshjes duke dubluar detyrimet që subjekti ka lidhur marrëveshjen e cila është anulluar. DTM ka mbajtur dy qëndrime mbi akt marrëveshjet e anulluara, ku për subjektin ñX& M ñ shpk dhe ñE. E. I.ò ka rilidhur akt marrëveshje edhe pse nuk është zbatuar kushtet e akt marrëveshjes, ndërsa për subjektet e tjera kanë filluar marrja e masave shtrënguese pas prishjes së marrëveshjes.

Tabela nr. 15: *Akt marrëveshje të përsëritura për të njëjtin subjekt 2018-2019-2020*

Lekë

Nr.	Subjektet	Nipti	Detyrimi total për të cilën lidhet A-M	Paguar në fillim të A-M	Data e lidhjes së A-M	Data e anullimit të A-M	Arsyeja e anullimit të A-M	Nr. total këste	Këste të paguar	Vlera e mbetur pa paguar
2018	X&M SH.P.K	K.	6,793,877	3,000,000	17.04.2018	28.12.2018	Mospagim Detyrimi	20	13	4,755,719
2019	X&M SH.P.K	K.	5,016,749	1,721,052	30.04.2019	27.04.2020	Mospagim Detyrimi	12	12	5,016,749
2020	X&M SH.P.K	K.	4,112,900	1,038,935	04.07.2019	28.12.2020	Mospagim Detyrimi	17	13	4,112,887
2018	E. E. I.	K.	66,381,698	12.04.2018	31.12.2019	15.03.2018	Mospagim Detyrimi	20	7	13,989,470
2019	E. E. I.E	K.	120,305,341	04.09.2019	28.12.2020	21.05.2019	Mospagim Detyrimi	20	10	33,729,018
2020	E. E. I.	K.	112,741,860	23.06.2020	28.12.2021	28.02.2020	Mospagim Detyrimi	15	12	112,741,848

Nga auditimi i praktikave të akt marrëveshjeve rezultoi se për dy subjektet e pasqyruara në tabelën e mësipërme janë rilidhur akt-marrëveshje, pa u përmbushur kushtet e marrëveshjes paraardhëse veprime në kundërshtim me:

- Udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, të ndryshuar, pika 78 ñZgjidhja e Marrëveshjes së pagesës me kësteò sipas të cilës ñ*Marrëveshja e pagesës me këste mund të zgjidhet nga administrata tatimore, në momentin më të parë që personi i tatueshëm nuk e respekton atë lidhur me rregullshmërinë e pagesave si dhe kur ai nuk paguan detyrimet e tjera tatimore, që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja. Në këtë rast, personi i tatueshëm është i detyruar të paguajë të gjitha detyrimet tatimore të papaguara, që mbulohen nga kjo marrëveshje, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit të zgjidhjes së marrëveshjes. Nëse këto detyrime nuk paguhen, administrata tatimore mbledh detyrimet në përputhje me dispozitat e Kreut XI të Ligjit*ò, si dhe nenin 77.3.2 ñ *Pranimi i pagesës me këste të një detyrimi tatimor të papaguar, nga administrata tatimore, do të thotë se gjatë periudhës për të cilën është rene dakord për pagimin me këste, ndaj tatimpaguesit nuk mund të merren masat e mbledhjes me force të detyrimeve tatimore të përcaktuara ne Ligj. Këto masa duhet të merren vetëm pasi ka përfunduar afati për të cilin është pranuar pagesa me këste ose pas datës se zgjidhjes se marrëveshjes se pagesës me këste*ò.

Për sa më sipër konstatohet se subjektet kanë përdorur akt-marrëveshjen për të mos kaluar në masa të tjera shtrënguese nga ana e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara.

Konstatim*:*

Nga krahasimi i të dhënave mbi proceset gjyqësore në lidhje me detyrimet e papaguara të mara nga sektori juridik, me të dhënat e marra nga Drejtorisa e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara konstatohet se të dhënat në kohë reale nga dy drejtoritë nuk janë në raport të drejtë pasi DMDTP i ka të gjeneruara këto procese direkt nga sistemi C@TS ndërsa Sektori juridik i mban regjistrin në bazë të proceseve të hapura, e cila bën të pamundur krahasimin e të dhënave nga sistemi C@TS me të dhënat e sektori juridik për të arritur në një vlerë të saktë të proceseve gjyqësore që DTM ka ndaj subjekteve.

Titulli i gjetjes:	*Lidhja e Akt-Marrëveshjeve në mënyrë të përsëritur për tatimpagues të cilët nuk kanë respektuar Akt-Marrëveshjet e mëparshme.*
Situata	Nga auditimi i praktikave për lidhjen e akt-marrëveshjeve konstatohet se, në të gjitha kërkesat e tatimpaguesve drejtuar DTM-së mungon vërtetësia e pamundësisë së situatës aktuale financiare, si dhe argumente nga ana e subjektit që pavarësisht rrethanës financiare të vështirë është në gjendje të zbatojë kushtet e marrëveshjes. Gjithashtu mungon dhe analiza e situatës ekonomike financiare të subjektit të realizuar nga vetë DTM-ja mbështetur në pasqyrat financiare të shoqërisë, gjendja e detyrimeve, kapitaleve të shoqërisë, aftësia qarkulluese e inventarit, likuiditetet etj, veprime në kundërshtim me pikën 77.1

	të Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 dhe Nenit 18 të Rregullores së funksionimit të DRT për lidhjen e akt- marrëveshjes pika 2 ñ*struktura përgjegjëse në DRT pasi merr në dorëzim kërkesat për marrëveshje i analizon ato duke përcaktuar riskun përkatës*ò, dhe pika 3: ñ*nëse plotëson kushtet pas analizës harton draft marrëveshjen përkatëse për pagesën me këste duke analizuar për të parë situatën nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore*.ò Nga testimet e kryera mbi databasen e akt-marrëveshjeve të lidhura dhe atyre të anuluara për vitin 2018, 2019 dhe vitit 2020 janë evidentuar raste ku për të njëjtin tatimpagues në mënyrë të përsëritur, në periudha të shkurtra kohore, janë lidhur akt-marrëveshje për pagesë me këste, edhe pse tatimpaguesit nuk kanë paguar detyrimin tatimor sipas kushteve të marrëveshjes së lidhur, duke shmangur marrjen e masave shtrënguese ndaj tyre, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, të ndryshuar, pika 78 ñZgjidhja e Marrëveshjes së pagesës me kësteò si dhe pika 77.3.2 ñ*Pranimi i pagesës me këste të një detyrimi tatimor të papaguar....”.*
	Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara u konstatua se d***etyrime tatimore në procedurë arkëtimi*** në vijim pa masa shtrënguese janë në shumën 6,207,828 mije lekë ose 50 % të totalit, ku vetëm shoqëritë shtetërore O, K. dhe A. kanë shumën 5,749,256 mije leke ose 93 % të totalit në procedurë arkëtimi në vijim pa masa shtrënguese. Nga DTM nuk janë bërë përpjekje për lidhjen e akt-marrëveshjeve me këto ente shtetërore, ku për shkaqe që kane te bëjnë me gjendjen e keqe te përkohshme financiare te personit te tatueshëm, ky i fundit mund te kërkojë te paguaje me këste një detyrim tatimor te papaguar, me qëllim shmangien e marrjes së masave shtrënguese të mbledhjes së detyrimeve të papaguara. Veprime në mospërputhje me nenin 77 ñMarrëveshja e pagesës me kësteò të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar.
Kriteri:	-Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 77: -Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, pika 77.1: -Udhëzues i përgjithshëm i procedurave të mbledhjes me forcë, miratuar me nr. 5731 prot, datë 15.03.2018 nga Zv/Drejtori i Përgjithshëm. Manual i mbledhjes me forcë të detyrimeve të papaguara.
Ndikimi/Efekti	Efekti është mungesa e të ardhurave të programuara në buxhetin e shtetit.
Shkaku	Mos respektimi idispozitave ligjore nga ana e strukturave përgjegjëse, si dhe subjektet kanë përdorur akt-marrëveshjen për të mos kaluar në masa të tjera shtrënguese nga ana e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandim:	- Sektori i Kontrollit nga Zyra pranë DTM-së/ përpara lidhjes së Akt-Marrëveshjeve të analizojnë aftësinë paguese të tatimpaguesit, me qëllim arritjen e objektivave të lidhjes së Akt-Marrëveshjeve, për likuidimin e plotë të detyrimeve. - Sektori i Kontrollit nga Zyra pranë DTM-sëpër subjektet që kanë lidhur Akt-Marrëveshje të monitorojë nivelin e detyrimeve të tatimpaguesve, si dhe pagesat e kryera për çdo këst me qëllim përmbushjen e kushteve të marrëveshjeve dhe uljen e riskut të anulimit të tyre, si dhe të shmangë rilidhjet e akt marrëveshjeve për të njëjtat subjekte të cilat kanë shkelur kushtet marrëveshjes, brenda të njëjtës periudhë kohore. - Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në bashkëpunim me DPT dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të merren masa për lidhjen e akt-

	marrëveshjeve me ente shtetërore, me qëllim mbledhjen e detyrimeve në kohë, si dhe shmangien e krijimit të detyrimeve në vlera të konsiderueshme dhe mbartjen e tyre në periudha të gjata kohore.

2.5.Përputhshmëria ligjore në veprimtarinë e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve dhe Individëve të realizuara nga strukturat e administratës së DTM-së nëpërmjet platformës elektronike e-Albania, ose jo, në arritjen e objektivit për lehtësimin dhe modernizimin e shërbimeve publike.

Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve (*këtu e më poshtëDSHT*) si pjesë përbërëse e DTM-së funksionon në zbatim të ñRregullores së funksionimit të Drejtorive Tatimore Rajonaleò miratuar me Urdhrin nr.19, datë 22.02.2017, si dheManualit të shërbimit për tatimpaguesit dhe individët, miratuar me Urdhrin Nr.81, prot., datë 22.12.2017. Administrata Tatimore në bashkëpunim me AKSHI-n ofron për tatimpaguesit shërbimin on line përmes portalit e-Albania, me qëllim ardhjen në ndihmë bizneseve.

Struktura.
Në zbatim të neneve 5, 6, 7, dhe 8 të rregullores së brendshme, DSHT ka në përbërje të saj 2 sektorë: **Sektori i Asistencës dheRegjistrimit** fokusuar kryesisht në dministrimin e mirëmbajtjen e regjistrit të tatimpaguesve etj.; dhe **Sektori i Shërbimeve të Marrëdhënieve me Publikun** fokusuar në informimin e shpejtë dhe të saktë të tatimpaguesve në lidhje me ndryshimet ligjore, administrimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme teknike brenda një periudhe sa më të shpejtë etj.

Titulli i gjetjes:	Mos plotësimi i vendeve të lira/vakante.
Situata:	DSHT, përbëhet nga 7 (shtatë) punonjës, 1 (një) drejtor, 2(dy) përgjegjës sektori, dhe 4 (katër) specialistë. Nga data 18.12.2019 e në vijim rezulton 1 (një) vend i lirë/vakant në pozicionin e specialistit jo në përputhje me strukturën e miratuar. Mos plotësimi i organikës me personel ndikon në funksionimin me kapacitet jo të plotë të saj dhe është kompetencë e titullarit të institucionit znj. Iris Ago në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) si organ qendror për menaxhimin e burimeve njerëzore si dhe Drejtorinë e Administratës Publike (DAP).
Kriteri:	Ligji nr.152/2013 ñPër nëpunësin Civilò i ndryshuar, neni 22, Ligji nr. 9920, datë 18.05.2008 ñPër procedurat tatimoreò i ndryshuar neni 19.
Ndikimi/Efekti:	Funksionimi me kapacitet jo të plotë të DSHT.
Shkaku:	Mos zbatimi i legjislacionit për nëpunësin civil dhe procedurat tatimore.
Rëndësia:	I ulët
Rekomandimi:	Të merren masa nga DTM që në bashkëpunim me Drejtorinë e Përngjitmë të Tatimeve dhe Drejtorinë e Administratës Publike, të plotësohen vendet e lira/vakante konform strukturës së miratuar.

Funksionimi.
Për periudhën nën auditim, DSHT ka mbështetur veprimtarinë e saj bazuar në planet vjetore operacionale të miratuara si pjesë e Planit Operacional të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj.
Një ndër detyrat funksionale DSHT është pranimi dhe përpunimi i kërkesave të tatimpaguesve të regjistruar dhe individëve, në zbatim të Manualit të Shërbimeve për tatimpaguesit dhe individët.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 158 datë 25.11.2019 ñPër marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on line nga data 1.1.2020ò, DSHT ka nisur procedurën e shërbimit të tatimpaguesit on line.
DSHT, në përgjigje të kërkesave të individëve apo subjekteve të ndryshme, lëshon vërtetime të cilat sipas llojit të përcaktuar në Manualin e Shërbimit për Tatimpaguesit dhe Individët (*këtu e më poshtë Manuali*) ndahen në:
Vërtetime që lëshohen në sportele disa nga të cilat janë:
-Vërtetime për individë referuar TAP dhe jo kontributeve (*kryesisht me qellim deklarimi te DIVA*)
-Vërtetime ESIG03/A për punonjës të huaj etj.

Disa nga vërtetimetqë gjenerohen nga portali e-albania:
-Vërtetim xhiro per 3-vjecarin e fundit për subjektet
-Vërtetim Kontributeve për subjektin
-Vërtetim Kontributeve për individin
-Vërtetim përgjegjesive tatimore etj.

Vërtetimet e lëshuar sipas llojit për vitet 2018-2020 referuar aneksit 4/1; 4/2 dhe 4/3, bashkëngjitur këtij Raporti bazuar në të dhënat e siguruar nga DSHT/DTM, janë 5495 që i përkasinnë total kërkesave të paraqitura, të cilat janë plotësuar dhe trajtuar në masën 100%. Numrin më të lartë të vërtetimeve të lëshuara sipas llojit e zënë ñFormulari E-sig 03/Aò (*Vërtetim për kontributet individuale të punonjësve*), ñFormulari i dyfishtëò dhe ñFormulari 4ò (*Vërtetim për pagesën e detyrimeve tatimore*).
Referuar viteve respektivë:
2018, numrin më të madh të aplikimeve për vërtetime e zënë ato të llojit ñFormulari E-sig 03/Aò (*Vërtetim për kontributet individuale të punonjësve*) për të cilin janë lëshuar 108 vërtetime, pasuar nga vërtetimet e llojit ñFormulari i dyfishtëò lëshuar 47 vërtetime.
2019, lëshuar gjithsej 1714 vërtetime për ñFormulari E-sig 03/Aò, pasuar nga 1100 vërtetime për ñFormularin e dyfishtëò.
2020, lëshuar 770 vërtetime për ñFormulari E-sig 03/Aò, pasuar nga 234 vërtetime për ñFormulari 4ò.

Regjistri i Tatimpaguesve, administrohet nga kjo drejtori dhe evidenton subjektet e rinj, siguron kontaktet me tatimpaguesit për të garantuar një data bazë të saktë, mbi regjistrimin/ndryshimin e përgjegjesive tatimore të tatimpaguesve, çregjistrimet në kohë të subjekteve, në mënyrë që të sigurohet një regjistër i pastër i të dhënave mbi tatimpaguesit.
Në lidhje me këtë detyrim ligjor, Sektori i Asistencës dhe Regjistrimit, administron Regjistrin e regjistrimeve duke pasqyruar të dhënat sipas kërkesave të legjislacionit tatimor.
Të dhënat mbi Regjistrin e subjekteve ñTatimpagues të Mëdhenjò deri me datë **31.12.2018-31.12.2020** jepen në Aneksin 4/4 bashkëngjitur këtij Raporti, ku u konstatua se:
Numri më i madh i subjekteve të cilëve iu është miratuar transferimi nga DRT në DTM por që figurojnë të pa transferuar i takon vitit 2019, ku nga 213 subjekte që kanë kërkuar transferim 28 subjekte figurojnë të pa transferuara, si pasojë e mos përfundimit të kontrolleve të cilat nuk gjenerohen nga sistemi C@TS, ushtruar nga drejtoritë respective për ato subjekte që kanë kërkuar transferim. Gjithashtu numri më i madh i subjekteve të cilëve iu është miratuar transferimi nga DTM në DRT e tjera i përket vitit 2019 me 309 subjekte.

Të dhënat për subjektet që kanë kaluar me status pasiv për periudhën Janar ï Dhjetor 2018, subjektet që janë riaktivizuar për 2018, subjektet që kanë kaluar me status pasiv për

periudhën Janar ï Dhjetor 2019 dhe subjektet që kanë kaluar me status pasiv për periudhën Janar -Dhjetor 2020 jepen në Aneksin 4/5, bashkëngjitur këtij Raporti.
Nga të dhënat rezulton se numri më i madh i subjekteve (9) që kanë kaluar me status pasiv i takon periudhës Janar-Dhjetor 2020. Për periudhën 2019-2020 nuk ka patur riaktivizime të subjekteve me status pasiv.
Ndryshimi i statusit të subjektit njoftohet në rrugë shkresore në përputhje me legjislacion e procedurave tatimore. Me përmirësimin e teknologjisë së informacionit, kalimi automatik në sistem, i ndryshimit të statusit, ka nisur në Maj të vitit 2016 e vijim.
Nga ana e Sektorit të Asistencës dhe Regjistrimit është ndjekur gjithashtu edhe ndryshimi i përgjegjësive tatimore bazuar në informacionet e ardhura nga Drejtoritë e tjera të DTM si dhe bazuar në kërkesat e subjekteve.
Referuar të dhënave në tabelat respektive në pjesën ñAnekse 4/6ò pjesë përbërëse e këtij raporti, rezulton se subjekte të cilat kanë pësuar ndryshim në përgjegjësi tatimore për vitin 2018 janë 4, për vitin 2019 janë 9 dhe për vitin 2020 janë 3.

Për të gjithë subjektet që kanë ndryshuar përgjegjësi tatimore është përgatitur njoftimi përkatës dhe dërgohet brenda afateve ligjore. Sqarimi i subjekteve lidhur me detyrimet tatimore dhe afatet e deklarimit dhe të pagesave që rrjedhin nga ndryshimi i kryer, bëhet në mënyrë të vazhdueshme.

Të dhënat për subjektet që janë transferuar nga DTM në DRT dhe anasjelltas për priudhën 2018-2020 jepen në Aneksin 1, bashkëngjiturRaportit.

Për vitet **2018-2020** janë ndjekur procedurat për të gjitha subjektet të cilat kanë kaluar në statusin ñKërkesë për çregjistrimò. Për realizimin e këtij procesi janë mbajtur kontakte me Drejtorinë e Kontrollit Tatimor dhe Drejtorinë e Mbledhjes me Force për të përshpejtuar procedurat e Çregjistrimit në sistemin C@TS. Sektori i Asistencës dhe i Regjistrimit ka kontrolluar në mënyrë të përsëritur kryesisht situatën e subjekteve të çregjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Bashkëpunimi mes DSHT dhe Drejtorisë së Kontrollit Tatimor evidentohet në shkëmbimin e informacioneve të përditësuara për vazhdimin e procedurave ligjore për finalizimin e Çregjistrimit me shënimin/arsyen që pengon finalizimin e tij si dhe i është dërguar njoftim subjekteve.
Problematikat që kanë penguar procedurën e çregjistrimit për subjektet gjatë vitit 2018 sipas DSHT janë të shumta, por ato më kryesoret janë:
-Detyrimet e shfaqura në C@TS
-Mos dorëzim i deklaratave dhe listëpagesave.
Nga DSHT janë ndjekur në vazhdimësi edhe subjektet të cilat kanë mbartur statusin ñKërkese për çregjistrimò, para periudhës 2018 si edhe subjekte te cilat kanë kaluar në këtë status gjatë vitit 2018.

Subjektet të cilat kanë bërë "*kërkesë për çregjistrim*" që janë çregjistruar me vendim gjykate, palikuidim, përthithje/ndarje bazuar në të dhënat e siguruara nga DSHT/DTMsipas Aneksit 4/5, bashkëngjitur këtij Raport Auditimi, për periudhën 2018-2020 janë si numër më i madh në vitin 2018 ku figurojnë 13 të tilla, për vitin 2019 figurojnë 10 dhe për vitin 2020 figurojnë 9 subjekte. Siç shihet numri i tyre ka ardhur duke u ulur.
Referuar të dhënave të DSHT/DTM subjektet që figurojnë të çregjistruar në QKB njoftohen në lidhje me detyrimet tatimore të pashlyera. Gjithashtu janë njoftuar dhe subjektet përthithëse për zbatimin e ligjit Nr. 9920, date 19.05.2008, me ndryshime Neni 45, si dhe Udhëzimit Nr. 24, datë 02.09.2008, pika 45.2.6 ku citohet se ñ*nëse procesi i bashkimit apo ndarjes është kryer pa pagimin e detyrimeve tatimore të subjektit që "likuidohet" këto detyrime do të vijojnë të mbeten tek subjekti i ri që krijohet nga procesi i bashkimit apo*

*detyrimet tatimore do të jenë të kërkueshme në mënyrë solidare kundrejt çdo subjekti të ri të krijuar nga ndarja e shoqëris*ë. Administrate tatimore ka të drejtën të kërkojë arkëtimin e këtyre detyrimeve deri në përdorimin e masave të parashikuara nga legjislacioni tatimor për mbledhjen me forcë të tyre.

Subjekte me status "*kërkesë për çregjistrim*" me proces likuidimi:

Viti 2018

Nr	Nipt	Subjekti	Çregjistrimi ne QKB
1	L.	N.& G.	shoqëri ne likuidim e sipër
2	K.	P. S.	22.10.2015 (vend gjykate)
3	L.	A.K.	shoqëri ne likuidim e sipër
4	K.	P. B. GMBH	shoqëri ne likuidim e sipër

Burimi: DSHT/DTM

Subjekte me status "*kërkese për cregjistrim*" me proces likuidimi:

Viti 2019

Nr	Nipt	Subjekti	Çregjistrimi ne QKB
1	L.	N.& G.	shoqëri ne likuidim e sipër
2	K.	P. B. GMBH	çregjistruar

Burimi: DSHT/DTM

Subjekte me status "*kërkese për cregjistrim*" me proces likujdimi:

Viti 2020

Nr	Nipti	Subjektit	"K Ç" në C@TS	Çregjistrimi ne QKB/ data e aplik PF
1	L.	N& G	11.06.2015	shoqeri ne likujdim e siper
2	K.	P. B. Gmbh ,	11.12.2018	cregjistruar
3	J.	I. F.	08.06.2020	cregjistruar
4	J.	T. N.	31.10.2019	shoqeri ne likujdim e siper
5	K.	B. K.	29.10.2020	29.10.2020 (shoqeri ne likujdim e siper)

Burimi: DSHT/DTM

Evidenca e subjekteve që janë riaktivizuar

Nr.	NIPT	Subjekti
1	L.	L.
2	L.	M.

Burimi: DSHT/DTM

Të gjithë subjektet janë njoftuar në mënyrë shkresore për ndryshimin e statusit të tyre në përputhje me Ligjin Nr. 9920 datë 19.5.2008, i ndryshuar.

Auditimi me zgjedhje i aplikimit të kërkesave për vërtetime, lëshuar nga DSHT.

Viti 2018

Subjekti	Data e Aplikimit	Lloji vërtetimit	Afali i lëhimit
ñU. NY,	12.09.2018	vërtetitim për shlyerje detyrimesh	**14.09.2018**
T.	12.07.2018	-Për pagimin e detyrimeve tatimore (Format Nr.4) -për nr.e të siguruarve (Form. E-Sig 03/A)	13.07. 2018
H. S.	03.7. 2018	Për pagimin e detyrimeve tatimore (Format Nr.4)	04.07. 2018
D.	30.04.2018	-Për pagimin e detyrimeve tatimore (Format Nr.4,) -për të ardhurat e realizuara 3 vitet	02.05.2018

		e fundit (Format Nr.6)	
Z. SHA	06.08.2018	Për pagimin e detyrimeve tatimore (Format Nr.4)	07.08.2018

Burimi: Zyra e Protokollit/DTM,

Viti 2019

Subjekti	Data e Aplikimit	Lloji vërtetimit	Afali i lëhimit
E. T.	02.05.2019	-për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	06.05.2019
V. I.	02.04.2019	-Për pagimin e detyrimeve tatimore (Format Nr.4)	03.04. 2019
A.-S.R	03.7. 2018	Për pagimin e kontributeve	04.12. 2019
S.& S.	Pa datë	-për tatimin mbi vlerën e shtuar -për kontributet	02.12.2019
Sh.-T.	23.08.2019	-për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	26.08.2019

Burimi: Zyra e Protokollit/DTM

Viti 2020

Subjekti	Data e Aplikimit	Lloji vërtetimit	Afali i lëhimit
C. F. SHPK	25.09.2020	-për pagimin e detyrimeve tatimore (Format Nr.4)	25.09.2020
M.	30.06.2020	-për pagimin e detyrimeve tatimore (Format Nr.4)	03.07.2020
G.-G.	17.04.2020	-për pagimin e kontributeve -për pagimin e detyrimeve tatimore (Format Nr.4)	**22.04.2020**
A. G.	21.07.2020	-për pagimin e detyrimeve tatimore (Format Nr.4)	22.07.2020
G-I.	27.02.2020	-për pagimin e detyrimeve tatimore (Format Nr.4)	28.07.2020

Burimi: Zyra e Protokollit/DTM

Nga auditimi i praktikave të sipërme konstatohet se:
Aplikimi për lëshimin e vërtetimeve për periudhën 2018-2020, në 3(tre) raste ka parregullsi në pranimin e dokumentacionit të kërkuar për aplikim si dhe vonesa me 1(një) ditë në lëshimin e vërtetimit konkretisht:

Për vitin **2018**, në 1(një) rast ka parregullsi në pranimin e dokumentacionit të kërkuar për aplikim dhe konkretisht:
Praktika e aplikimit e subjektit ñ**UNY**ò me NIPT-K. përmban:
-vërtetimin me datë të korigjuar jonë përputhje me Manualin e Shërbimit për tatimpaguesit dhe individët, pjesa II, pika 2.
-Për vitin **2019**, në 1(një) rast ka parregullsi në pranimin e dokumentacionit të kërkuar për aplikim dhe konkretisht:
Praktika e aplikimit të subjektit ñ**A.-S.**ò, NIPT-J.përmban:
-kërkesën e subjektit pa datë, jo në përputhje me Manualin, pjesa II, pika 2.
-Për vitin **2020**, në 1(një) rast ka vonesë në lëshimin e vërtetimit dhe konkretisht:
Praktika e aplikimit të subjektit ñ**G-G**ò, NIPT-J.përmban:
-vërtetimin nr.835 prot., datë 22.04.2020 lëshuar me vonesë nga DSHT, pasi afati për kryrjen e këtij shërbimi është 1 ditë (duhet 18.04.2020) pas aplikimit sipas Manualit, pjesa II, pika 2 ñHapat e procedurësò, aplikimi është bërë me datë 17.04.2020, jo në përputhje me Manualin e Shërbimit për tatimpaguesit dhe individët, pjesa II, pika 2.
